



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

**“Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe
rregullshmërisë ekonomiko-financiare
në
“Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës**

MAJ 2018



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-5
II.	HYRJA	5-6
	a. Objektivat dhe qëllimi.....	6
	b. Identifikimi i çështjes.....	6
	c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	6
	d. Përgjegjësitë e audituesve.....	6
	e. Kriteret e vlerësimit.....	6
	f. Standardet e auditimit.....	6
III.	PËRSHRIMI I AUDITIMIT.....	7
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	
	Pika 1 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm”.....	7-14
	Pika 2 Mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave drejtuese të shoqërisë (Këshillit Mbikëqyrës dhe Drejtorisë)”.....	14-16
	Pika 3 “Mbi hartimin, shqyrtimin, miratimin dhe zbatimin e programit ekonomiko-financiar. Ndjekja dhe realizimi i treguesve ekonomiko-financiar në qendër dhe në njësitë e vartësisë”.....	16-20
	Pika 4 “Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi”.....	20-27
	Pika 5 “Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dita brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, etj.)”.....	27-34
	Pika 6 “Mbajtja e evidencës kontabile në qendër dhe në njësitë e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit”.....	35-59
	Pika 7 “Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave”.....	60-88
	Pika 8 “Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit”.....	88-91
	Pika 9 “Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale”.....	91-97
	Pika 10 “Përdorimi i subvencioneve shtetërore”.....	97-101
	Pika 11 “Hartimi, miratimi i tarifave në transportin e mallrave dhe udhëtarëve, lidhja e kontratave dhe zbatimi i tyre”.....	101-107
V.	KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT	123-124



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë "Hekurudha Shqiptare" SHA Durrës

VI. ANEKSE

125

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Është audituar aktiviteti i shoqërisë për periudhën e auditimit, fokusuar kryesisht në operacione financiare, por jo vetëm. Janë audituar shpenzime për personelin dhe paga për një periudhë 3 vjeçare me vlerë rreth 254 milionë lekë, nga rreth 1,049 milionë të shpenzuara. Pagesat e realizuara për këshillin mbikëqyrës. Të ardhurat e realizuara, si dhe realizimi i shpenzimeve. Janë audituar 9 procedura prokurimi. Janë konstatuar mangësi në lidhje me largimet e paligjshme të punonjëve nga puna, si pasojë e proceseve gjyqësore, me pasoja financiare për shoqërinë. Janë konstatuar mangësi në lidhje me zbatimin e procedurave të prokurimit dhe zbatimin e kontratave përkatëse, realizim pagesa shërbim roje etj. Disa nga gjetjet më kryesore paraqiten më poshtë:

GJETJA NR.	PËRMBLEDHËSE E GJETJES	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	Shpenzime në kundërshtim me destinacionin	Përdorimi i subvencionimeve	I mesëm	<i>Shoqëria ka përdorur subvencionin e destinuar për investime, për paga dhe shpenzime për personelin me vlerë 1,230 milionë lekë.</i>
2.	Pagesa për largime të paligjshme nga puna	Mbi zbatimin e strukturës organizative	I Lartë	<i>Si pasojë e largimeve të paligjshme nga puna, shoqëria është penalizuar për periudhën objekt auditimi me vlerë 11,481 mijë lekë.</i>
3.	Pagesa pa dokumentacionin justifikues	Mbi realizimin e shpenzimeve me arkë e me bankë	I lartë	<i>Janë likuiduar shpenzimet për roje private pa dokumentacionin justifikues të realizimit të shërbimit me vlerë 14,092 mijë lekë.</i>
4.	Përlllogaritje fondi limit në mënyrë të gabuar.	Mbi realizimin e procedurave të prokurimit	I lartë	<i>Fondi limit në dy procedura prokurimi është përlllogaritur në kundërshtim me ligjin, duke shkaktuar dëm ekonomik me vlerë 7,738 mijë lekë.</i>
5.	Penalitete dhe punime të pa realizuara	Zbatimi i kontratave të punimeve civile	I mesëm	<i>Gjatë auditimit të kontratave të punimeve civile, mallra dhe shërbime, është konstatuar dëm ekonomik me vlerë 8,389 mijë lekë, që përfaqëson penalitete të pa mbajtura, punime të pa realizuara, etj.</i>

Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e veprimtarisë ekonomiko financiare të Hekurudha Shqiptare Sha në tërësi për periudhën 2015-2017, si dhe të pasqyrave financiare të cilat përbëhen nga pasqyra e



pozicionit financiar të institucionit, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të parasë, burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet, pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet në aktivet e qëndrueshme si dhe amortizimin e tyre, pasqyra e lëvizjes së fondeve dhe shënimet shpjeguese.

Opinionit i pakualifikuar i Grupit të Auditimit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Hekurudha Shqiptare Sha me kuadrin ligjor dhe rregullator.

Në opinionin tonë, përveç çështjeve të trajtuara në bazën për opinionin e pakualifikuar, pasqyrat financiare të audituara paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për periudhën e audituar në përputhje me standardet kombëtare të kontabilitetit të përmiruar në Shqipëri (SKK).

Baza për opinionin e pakualifikuar.

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik *ISSAI 4100 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta dhe ISSAI 4200 - Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet lidhur me auditimin e pasqyrave financiare.*

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Theksim të çështjes

Ne duam të tërheqim vëmendjen e përdoruesve për disa çështje të cilat ndikojnë në cilësinë e informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare duke përfshirë dobësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe anomalitë e identifikuara në raportimin e pasqyrave financiare. Konkretisht:

- Dëmet ekonomike të konstatuara janë në vlerën 30,435,762 lekë të cilat kanë ardhur si pasojë e keqmenaxhimit në procedurat e prokurimit si dhe në likuidimin e shërbimit të rojeve private
- Efekte negative financiare në vlerën 11,931,144 lekë të cilat kanë ardhur si pasojë largimeve të padrejta nga puna dhe mos lirimim në kohë i hapësirës private për vendosjen e instrumentave menaxhues dhe funksionues të sistemit hekurudhor
- Vlera e subvencionuar prej 1,230,000,000 lekë e destinuar për rimbursimin e shpenzimeve të biletave të udhëtarëve është përdorur për dhënie e pagave dhe sigurimeve shoqërore përbën shkelje të disiplinës buxhetore dhe shpenzime jo në përputhje me ligjin po në të njëjtën vlerë.
- Sistemet e kontrollit të brendshëm të implementuara nga institucioni nuk kanë rezultuar në përputhje me kërkesat e kritereve të përcaktuara për vlerësimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për shkak të mungesës së kuptimit të këtyre kritereve, mosplotësimit të kërkesave



për dorëzimin e deklaratave për cilësinë e kontrolleve të brendshme, mosplotësimin dhe mosdorëzimit pyetësorëve të vetëvlerësimit, regjistrin të risqeve, rregullores pa mbështetje në strukturën organizative, veprimeve rregulluese të kryera nga jashtë, mbajtjes së regjistrimit manual të transaksioneve në ditarë, raporteve të pa plota të audituesit të brendshëm, procedurave të pa implementuara për delegimin e detyrave dhe përgjegjësisve dhe mungesës së objektivave e planeve të punës për arritjen e tyre.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 1313/1, datë 03.01.2018, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 08.01.2018 deri me datë 23.03.2018, në subjektin “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës, për periudhën nga data 01.11.2014 deri me datë 31.12.2017, u krye auditimi “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” nga grupi i auditimit me përbërje:

1. A.T, përgjegjës grupi
2. S.H, auditues
3. H.K, auditues
4. B.Sh, auditues

a. Titulli: Raport mbi auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë së aktivitetit të “Hekurudha Shqiptare” SHA, Durrës.

b. Marrësi: “Hekurudha Shqiptare” SHA, Durrës, me Administrator z. A.D.

c. Objektivat dhe qëllimi: Objektivi kryesor i grupit të auditimit të KLSH është dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit, që “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës, u ka bërë fondeve në dispozicion, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke audituar rregullaritetin, ligjshmërinë e transaksioneve si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë shoqërisë. Auditimi ka për qëllim *promovimin e transparencës* duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar siç kërkohet në aktet ligjore si dhe nëse u është shërbyer udhëtarëve dhe transportuesve të mallrave sipas standardeve që kërkohen. Gjithashtu, projekti i auditimit ka për qëllim *promovimin e përgjegjshmërisë* ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre.

Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (sipas ISSAI 400, p 18).



d. Identifikimi i çështjes: Shoqëria duhet të ketë organizimin e duhur, duhet të funksionojë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për rriten e cilësisë së shërbimit, duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.

e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të auditur lidhur me çështjen nën auditim: Shoqëria ka si qëllim dhënien e shërbimeve për transportin e pasagjerëve dhe të mallrave, krijimin e kushteve për pasagjerët që lëvizin me tren, si dhe krijimin e kushteve dhe respektimin e kontratave me subjekte që përdorin transportin e mallrave me tren.

f. Përgjegjësitë e audituesve: Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit për auditimin. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI. Janë respektuar kërkesat etike, është planifikuar dhe kryer auditimin sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së kërkuar.

g. Kriteret e vlerësimit:

Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manuali e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH, Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar; Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”; Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 9317, datë 18.11.2004 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 8306, datë 14.03.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”; Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe ligje të tjera të fushës së ndërtimit; VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar; VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për funksionimin e Këshillave Mbikëqyrës”, i ndryshuar; Udhëzimin nr. 318, datë 08.04.2009 i Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në Shoqëritë Anonime Shtetërore”; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”; Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”; Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë; etj. Akte të tjera ligjore apo nënligjore që do të jenë të nevojshme gjatë auditimit.

h. Standardet e auditimit:

- ISSAI 100 – (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik)
- ISSAI 400 (Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë).
- Kodi etik i KLSH.



III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës, funksionon si Shoqëri me kapital 100% shtetëror. Aksionari i vetëm i kësaj shoqërie Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Shoqëria është krijuar dhe funksionon bazuar në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Shoqëria drejtohet me dy nivele. Këshilli Mbikëqyrës funksionon sipas përcaktimeve në ligjin e mësipërm, statutin e shoqërisë, VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive anonime shtetërore”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 318, datë 08.04.2009 të METE, “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në Shoqëritë Anonime Shtetërore”. Administrator i Shoqërisë është z. A.D, ndërsa Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 6 anëtarë dhe konkretisht znj. T.B, z. A.Sh, z. P.Sh, z. F.M, znj. M.N, z. K.M.

Shoqëria ka si qëllim krijimin e kushteve dhe sigurisë për lëvizjen e pasagjerëve dhe mallrave.

Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit është rregullshmëria e operacioneve financiare të subjektit për periudhën nga data 01.11.2014 deri me datë 31.12.2017. Cilësia e shërbimeve dhe siguria ndaj përdoruesve të shërbimeve hekurudhore si për pasagjerë ashtu dhe për transport mallrash.

Qëllimi i auditimit është hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimit të gjetjeve, si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e aktivitetit të shoqërisë.

Është audituar aktiviteti i shoqërisë për periudhën e auditimit, fokusuar kryesisht në operacione financiare, por jo vetëm. Janë audituar shpenzime për personelin dhe paga. Vendimet e marra nga këshilli mbikëqyrës. Të ardhurat e realizuara, si dhe realizimi i shpenzimeve. Janë audituar procedurat e prokurimit dhe zbatimi i kontratave përkatëse si dhe procedura me blerje të vogël etj. Është audituar hartimi i pasqyrave financiare, programi i zhvillimit, dhënia me qira e ambienteve në disponim të shoqërisë etj.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

IV. 1. Mbi realizimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet që:

Nga ana e KLSH-së është ushtruar auditim në “Hekurudha Shqiptare SHA” Durrës me objekt: “Auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë si dhe vlerësimi i veprimtarisë ekonomiko-financiare”, për periudhën nëntor 2011 deri nëntor 2014. Raporti Përfundimtar i Auditimit i është dërguar subjektit me shkresën nr. 1051/11, datë 30.04.2015, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të lëna nga ky audit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 1051/11 prot, datë 30.04.2015 në zbatim të autorizimit nr. 1073/6 datë 20.11.2015 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit ka verifikuar zbatimin e të rekomandimeve të lëna nga ky audit.

Nga ana e Administratorit, janë marrë masa dhe ka dalë urdhri nr. 1309/31, datë 22.05.2015, mbi zbatimin e detyrave të lëna në Raportin Përfundimtar të KLSH-së, i cili i drejtohet Njësisë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

Ekonomike, njësisë Biznesit Mallrave, Njësisë Shërbimeve të Brendshme, Njësisë Biznesit Udhëtarëve, Njësisë Menaxhimit të Infrastrukturës dhe Njësisë Shërbimit të Mjeteve. Është hartuar plani i masave në zbatim të detyrues për ndjekjen e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 1051/11 prot, datë 30.04.2015, janë njoftuar subjektet përkatëse. Realizimi i rekomandimeve në mënyrë të detajuar pasqyrohet si më poshtë vijon:

MASAT

Nga auditimi i kryer janë dhënë 63 (gjashtëdhjetë e tre) rekomandime për masa organizative, shpërblim dëmi dhe disiplinore.

Nga 25 masa organizative të rekomanduara gjithsej, janë zbatuar plotësisht 20 dhe nuk janë zbatuar 5 masa.

Nga 10 masa për shpërblim dëmi të rekomanduara gjithsej janë zbatuar plotësisht 4, janë zbatuar pjesërisht 5 dhe nuk është zbatuar 1 masë.

Nga 28 masa disiplinore të rekomanduara gjithsej janë zbatuar plotësisht 23 dhe nuk janë zbatuar 5 masa.

Masat të cilat janë lënë nga kontrolli i mëparshëm pasqyrohen si më poshtë:

A -MASA ORGANIZATIVE

Nga dokumentacioni i vene në dispozicion u konstatua se:

1-Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës, të marrë masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, të cilat nga auditimi rezultuan të pazbatuara, si dhe të ndjekë me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore

Nuk është zbatuar.

2-Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” Sh.a Durrës, të zbatojë procedurat ligjore për të përshtatur Statutin e Shoqërisë konform Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, neni 230, pika 2.

Është zbatuar.

3-Këshilli Mbikëqyrës, të miratoj çdo vit programin vjetor të auditimit të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, si dhe të ushtrij kontroll për zbatimin e tij çdo tremujor, në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Ekonomisë nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, Kreu IV, pika 6.

Është zbatuar. Me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr .5, datë 02.06.2015 dhe Vendim 11, datë 13.10.2015

4-Këshilli Mbikëqyrës të marrë masa për hartimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe të funksionimit të veprimtarisë së Tij.

Është zbatuar. Vendim të Administratorit nr. 11, datë 20.11.2015 është miratuar në parim Projekt-rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e shoqërisë Hekurudha Shqiptare”

5-Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Përgjithshëm, të hartohet rregullorja e përcaktimit të kriterëve të punësimit, sipas pozicionit të vendeve të punës dhe të merren masa për zbatimin korrekt në rekrutimin apo lëvizjen e punonjësve.

Është zbatuar. Vendim të Administratorit nr. 8, datë 09.10.2015 është miratuar në parim Projekt-rregullorja



6-Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Përgjithshëm, të miratojnë programin ekonomik-financiar (buxhetin vjetor) dhe ndryshimet e tij gjatë vitit.

Është zbatuar me shkresën nr. 1400, datë 27.10.2015,

7-Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Përgjithshëm, të analizojnë gjendjen debitore dhe kreditore më datë 31.12.2014, si dhe të marrë masat e nevojshme për reduktimin e tyre.

Është zbatuar Vendim nr. 8, datë 22.07.2015 dhe shkresën nr. 982, datë 24.07.2015

8-Të rishqyrtohet nga Këshilli Mbikëqyrës vendimi nr. 9, datë 09.10.2013, për caktimin e pagës së Administratorit të Shoqërisë.

Është zbatuar Vendim i Këshillit Mbikëqyrës nr. 6, datë 02.06.2015

9-Nga Këshilli Mbikëqyrës, të merren masa për shfuqizimin e vendimit të Administratorit nr. 466 prot, datë 26.06.2012 “Për miratimin e udhëzuesit për përpunimin dhe hartimin e pasqyrave financiare”, vendim i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 92.

Është zbatuar. Vendim të administratorit nr. 901, datë 07.07.2015

10-Nga Administratori i Përgjithshëm dhe Drejtoria Ekonomike, të merren masa për hartimin e udhëzuesit për përpunimin dhe hartimin e pasqyrave financiare, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, të miratohet në Këshillin Mbikëqyrës dhe nga Aksionari i vetëm, “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”.

Është zbatuar.

11-Nga Administratori i Përgjithshëm dhe Drejtoria Ekonomike, të merren masa për hartimin, miratimin dhe dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore në organet tatimore, brenda afateve ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat

Është zbatuar.

12-Nga Administratori i Përgjithshëm dhe Drejtoria Ekonomike, të merren masa që transaksionet e brendshme të njëjësive vartëse, të kryhen me fatura të rregullta tatimore dhe këto transaksione të kalojnë nëpërmjet sistemit bankar, në përputhje me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Nuk është zbatuar.

13-Nga Administratori i Përgjithshëm dhe Drejtoria Ekonomike, të merren masa për hartimin e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Është zbatuar.

14-Administratori i Përgjithshëm dhe Drejtoria Ekonomike, të marrin masa për paraqitjen e saktë të shpenzimeve të kryera për subvencion, si dhe kontabilizimi i urdhër-shpenzimeve, të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Është zbatuar. Me vendimin nr. 9 datë 22.07.2015 të Këshillit Mbikëqyrës.

15-Nga Administratori i Përgjithshëm i Shoqërisë të merren masa që investimet për ndërtimet dhe rikonstruksionet të kryhen me leje zhvillimi, në zbatim të ligjit nr. 10.119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”.

Nuk është zbatuar.

16-Për një përdorim me efikasitet të fondeve publike të argumentohet domosdoshmëria e kryerjes së prokurimit me leverdinë ekonomike dhe volumet efektive të punëve që do të kryhen;

Është zbatuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

17-Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” SHA të marrë masat e nevojshme për përfundimin e procesit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zbatim të VKM nr. 120, datë 04.03.2004, për pronat që janë në proces regjistrimi dhe fillimin e procedurave për pjesën tjetër të pronave.

Është zbatuar.

18-Grupi i punës sipas zonave të kryej monitorimin e kontratave në mënyrë kronologjike dhe raportimin e tyre pranë sektorit përkatës, për arkëtimin në kohë të ardhurave sipas kontratave përkatëse, sipas kapitullit VI pikat 1, 2 3 të VKM nr. 54 datë 5.2.2014.

Është zbatuar. Ka dalë urdhër i drejtuesit të njësisë së Menaxhimit të Infrastrukturës nr. 927/1 datë 09.07.2015.

19-Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Përgjithshëm, të merren masa për përcaktuar strukturën e shpenzimeve që do të mbulohen nga subvencioni i akorduar për transportin e udhëtarëve, të miratohet nga organet kompetente, si dhe të lidhet kontrata përkatëse me Ministrinë e Transporti dhe Infrastrukturës.

Është zbatuar. Miratuar sipas vendimit nr. 9 datë 22.07.2015 të Këshillit Mbikëqyrës.

20-Nga Administratori i Përgjithshëm dhe Drejtoria Ekonomike, të merren masa për hartimin një plani afatgjatë, lidhur me shlyerjen e detyrimeve ndaj hekurudhave të huaja në vlerën **1,370,057 euro, vënien nën kontroll të shpenzimeve, si dhe uljen e tyre për orë qëndrimet e vagonëve të hekurudhave të huaja.**

Nuk është zbatuar.

21-Të merren masa nga Administratori i Përgjithshëm dhe Sektori i Marketingut, për kompletimin e dokumentacionit të transportit ndërkombëtar të mallrave, me aktet e rregullores RIV dhe kodet UIC të përkthyer në gjuhën shqipe.

Është zbatuar.

22-Nga Administratori i Përgjithshëm, Drejtoria Ekonomike dhe Sektori i Marketingut, të merren masa për të bërë evidentimin dhe regjistrimin e penaliteteve të shkaktuara nga mos likuidimi i kamatëvonesave për orë qëndrimet e vagonëve të Hekurudhave të Huaja, konform udhëzimeve të kodeve UIC 304 dhe 311, duke bërë në këtë mënyrë raportim të saktë dhe të besueshëm të detyrimeve financiare, si dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare.

Nuk është zbatuar.

23-Të merren masa nga Sektori i Marketingut dhe Dega e Financës të Njësisë së Biznesit të mallit, për të bërë akt-rakordime javore dhe mujore të dokumentuara të hyrje-daljeve të vagonëve të huaj, duke shënuar kështu numrin e vagonit, datën dhe orën e hyrjes së vagonit, llojin e mallit, sasinë e mallit, destinacionin, datën dhe orën e daljes.

Është zbatuar.

24-Të merren masa nga dega e financës e Njësisë së Biznesit të Mallit dhe ekonomistët komercial, për shënimin e referencave të faturave të mëparshme për zbritjet e parapagesave, të evidentohet qartë në faturë aplikimi i uljeve komerciale dhe metoda e përlllogaritjes së tyre.

Është zbatuar.

25-Nga Administratori i Përgjithshëm të merren masa për lidhjen e kontratave me të gjithë klientët për transportin kombëtar dhe ndërkombëtar të mallrave, si dhe të parashikohen garanci për mosrealizim të kontratës në sasi, ose për likuidim jo në kohë të detyrimeve për transportin.

Është zbatuar.

B -MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga dokumentacioni i vene ne dispozicion u konstatua se:



1-Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës, të shqyrtojë përdorimin e subvencionit për vitin 2014 në vlerën **269,625,817.88 lekë, jashtë destinacionit të përcaktuar, të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse në zbatim të Ligjit nr. 9374, datë 21.02.2005 “Për ndihmën shtetërore”, Ligjin nr. 185/2013, datë 02.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, Ligjin nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005 “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, Vendimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 8, datë 02.02.2007 i ndryshuar me Vendimin nr. 15, datë 15.03.2007, **vlerë e cila për Buxhetin e Shtetit përbën dëm ekonomik.****

Është zbatuar. Është shqyrtuar me mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës datë 02.06.2015.

2-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 24,280,462 lekë, nga shoqëria “K-Sh. GmBH” Gjermani dhe “S. S.” shpk Durrës, për shkeljet e konstatuara për transportin i mineralit të hekur-nikelit nga stacioni hekurudhor të Gurit të Kuq-Elbasan me destinacion Kinë.**

Është zbatuar. Çështja është pushuar nga prokuroria e rrethit gjyqësor Durrës.

3-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 7,391,400 lekë, nga shoqëria “Shoqëria “C.” shpk & shoqëria “N.”, për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt “Riaktivizimi i stacionit Kashar faza III”, viti 2014**

Është zbatuar pjesërisht. Është njoftuar subjekti me shkresën nr. 1311/1 prot datë 09.10.2015. Me procesverbal të datës 29.12.2014 janë marrë në dorëzim punimet e përfunduara nga ana e Hekurudha Shqiptare SHA.

4-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 822,892 lekë, nga shoqëria “B.” shpk Ballsh, për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt “Riaftësimi i trasesë hekurudhore Milot-Lezhë”, viti 2014.**

Është zbatuar pjesërisht . Është njoftuar subjekti me shkresën nr. 1260/2 prot., datë 23.09.2015. Me procesverbal të datës 19.12.2014 janë marrë në dorëzim punimet e përfunduara nga ana e Hekurudha Shqiptare SHA.

5-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 430,000 lekë, nga L.B, M.J, E.J, Z.D dhe F.V, për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt “Shërbim rinovim agregatesh për lokomotiva hekurudhore”, viti 2014.**

Është zbatuar pjesërisht Është njoftuar subjekti me shkresën nr. 1260 prot., datë 23.09.2015

6-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 775,320 lekë, nga shoqëria “K.”, për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt “Rikonstruksioni i godinës Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhës”, viti 2014.**

Është zbatuar pjesërisht. Është njoftuar subjekti me shkresën nr. 1260/6 prot datë 15.10.2015.

7-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 6,997,656 lekë, nga shoqëria “G.”, për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt “Riaktivizimi i Stacionit Kashar”.**

Është zbatuar pjesërisht. Është njoftuar subjekti me shkresën nr. 1801/2 prot., datë 10.10.2015. Me procesverbal të datës 22.01.2015 janë marrë në dorëzim punimet e përfunduara nga ana e Hekurudha Shqiptare SHA.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë "Hekurudha Shqiptare" SHA Durrës

8-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi ***në vlerën 60,628 euro***; nga shoqëria "P." në vlerën 59,790 euro, shoqëria "16 Februar" në vlerën 499 euro dhe shoqëria "I.A.M" Shpk në vlerën 339 euro, për mos aplikim dhe likuidim të drejtë të tarifave të transporti ndërkombëtar hekurudhor të mallrave.

Është zbatuar. Nga pasqyrat financiare të vitit 2017 këto shoqëri nuk rezultojnë debitore.

9-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi në vlerën ***40,392 lekë*** nga kompania "K.I" sh.a për shfrytëzimin e trasesë së Hekurudhës, pa likuiduar qiranë për sipërfaqen 56.1 m² që shfrytëzohet nga shoqëria "K.I" SHA.

Nuk është zbatuar.

10-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi në 14 raste në ***vlerën 4,272,682 lekë***, rezultuar nga mos-likuidimi i detyrimeve kontraktuale të subjekteve qiramarrëse.

Është zbatuar. Janë hartuar dhe dërguar shkresat për njoftimin e subjekteve debitore për shlyerjen e detyrimeve me shkresën nr. 931/1-18 prot., datë 16.17.11.2015.

C -MASA DISIPLINORE

Nga dokumentacioni i vene ne dispozicion u konstatua se:

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, date 12.7.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar, kontratës kolektive të punës të nivelit të parë neni 52, kontratave të punës të nivelit të dytë neni 44, si dhe kontratave individuale të punës, i kërkojmë Administratorit të Shoqërisë, që në varësi të kompetencave të tij ligjore, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

C/b. "Vërejte me paralajmërim për zgjidhje kontrate"

Ose

"Zgjidhje të kontratës së punësimit", për:

- 1. L.G,** me detyrë drejtor ekonomik i Drejtorisë së Përgjithshme; **Zbatuar**
- 2. A.H,** me detyrë shef i sektorit të financës DPH; **Nuk është zbatuar**
- 3. E.D,** me detyrë drejtuesi i njësisë së infrastrukturës; **Zbatuar** ulur në detyrë
- 4. A.K,** me detyrë drejtuesi i njësisë së shërbimit të mjeteve lëvizëse; **Zbatuar**
- 5. S.Sh,** me detyrë drejtuesi i njësisë së mallrave; **Zbatuar**
- 6. P.T,** me detyrë drejtuesi i njësisë së biznesit të udhëtarit ; **Nuk është zbatuar**
- 7. M.S,** me detyrë shef i sektorit të financës infrastrukturës; **Nuk është zbatuar**
- 8. A.M,** me detyrë shef i sektorit ekonomik mjeteve; **Nuk është zbatuar**
- 9. M.K,** me detyrë shef i sektorit ekonomik mallrave; **Zbatuar** ulur në detyrë
- 10. A.T (B.),** me detyrë shef i sektorit ekonomik udhëtarit. **Nuk është Zbatuar,**

Administratori me vendim nr. 10 prot datë 20.11.2015 në pikën 2 të këtij vendim është shprehur; 'Të mos marrë në konsideratë rekomandimet për masat disiplinore nga pika 1 deri në 10, kjo referuar rekomandimit të KLSH i cili citon në menyr eksplicite:

'Për personat e përmendur më sipër, Administratori i Përgjithshëm i Shoqërisë, sipas shkelleve ligjore dhe përgjegjësive respektive të cituar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, por dhe të performancës së punës së tyre, mund të aplikoj një nga dy masat e rekomanduara''.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

11. M.K, me detyrë specialiste për sigurinë pranë sektorit teknik të NJBMIH, në cilësinë e kolaudatores të punimeve të ndërtimit në objektin “Riaktivizimi i stacionit Kashar faza III” dhe “Riaktivizimi i stacionit Kashar faza e II”.

–Është zbatuar është dhënë masa *‘Vërejte me paralajmërim për zgjidhje kontrate’ konkretisht me shkresën nr. 1483 prot datë 24.11.2015.*

12. L.B, me detyrë kryemekanik i oficinës së riparim mjeteve në NJSHML.

Është zbatuar është dhënë masa *‘Vërejte me paralajmërim për zgjidhje kontrate’ konkretisht me shkresën nr. 1483 prot datë 24.11.2015.*

13. M.J, me detyrë elektrikist lokomotivash në NJSHML.

Është zbatuar është dhënë masa *‘Vërejte me paralajmërim për zgjidhje kontrate’ konkretisht me shkresën nr. 1483 prot datë 24.11.2015.*

14. E.J, me detyrë motorist lokomotivash në NJSHML.

Është zbatuar është dhënë masa *‘Vërejte me paralajmërim për zgjidhje kontrate’ konkretisht me shkresën nr. 1483 prot datë 24.11.2015.*

15. Z.Y, me detyrë shef i sektorit të kontrollit teknik pranë NJSHML.

Është zbatuar është dhënë masa *‘Vërejte me paralajmërim për zgjidhje kontrate’ konkretisht me shkresën nr. 1483 prot datë 24.11.2015.*

16. K.Sh, me detyrë nëndrejtor ekonomik pranë NJSHML, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.

Është zbatuar është ezauruar pasi punonjesi eshte larguar nga ky pozicion.

17. D.R, me detyrë kryemekanik i parkut të mjeteve hekurudhore në NJSHML, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.

Është zbatuar është dhënë masa *‘Vërejte me paralajmërim për zgjidhje kontrate’ konkretisht me shkresën nr. 1483 prot datë 24.11.2015.*

18. L.L, me detyrë kryeinxhinier në NJSHML, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.

Është zbatuar - është dhene masa *‘Vërejte me paralajmërim për zgjidhje kontrate’ konkretisht me shkresën nr. 1483 prot datë 24.11.2015.*

19. G.S, me detyrë përgjegjës i repartit te shërbimit lokomotivave pranë NJSHML, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.

Është zbatuar është dhënë masa *‘Vërejte me paralajmërim për zgjidhje kontrate’ konkretisht me shkresën nr. 1483 prot datë 24.11.2015.*

20. A.D, me detyrë jurist në sektorin juridik Njësia e Shërbimeve të Brendshme (NJSHMB) në HSH, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.

Është zbatuar është ezauruar pasi ky punonjesi ka mbushur moshen e pensionit.

C/c. "Vërejte", për:

21. P.P, nëndrejtor i kapaciteteve në Njesisë së Biznesit dhe Menaxhimit Infrastrukturës Hekurudhore.

22. D.O, me detyrë shefe e sektorit të pasurive.

23. S.P, me detyrë shefe e sektorit të shfrytëzimit të kapaciteteve për periudhën 23.03.2014 dhe në vazhdim.

24. L.S, me detyrë specialist në sektorin e shfrytëzimit të kapaciteteve në NJBMIH

25. J.V, specialiste në sektorin e drejtimit të trafikut pranë NJBMIH.

26. F.V me detyrë magazinier.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë "Hekurudha Shqiptare" SHA Durrës

Është zbatuar Per personat e mësipërm është dhënë masa "**Vërejte**", sipas rekomandimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën e Administratorit nr. 1483 prot datë 24.11.2015 -Per **P.T**, shefi nën njësisë së rajonit Jug Lindje pranë NJBMIH masa "**Vërejte**", ; **Zbatuar**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

z. I.D, në cilësinë e Ish-Administratori i Shoqërisë.

z.E.D, në cilësinë e Ish-Drejtori Njësisë Biznes Menaxhimit Infrastukturës Hekurudhore.

z. A.P, në cilësinë e Drejtorit Ekonomik të Shoqërisë.

IV. 2. Mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave drejtuese të shoqërisë (Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtorisë).

Titulli i gjetjes: Nuk janë marrë masa për implementimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Situata: Nga ana e Shoqërisë nuk janë marrë masa për implementimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin duke ulur funksionimin e kontrollit të brendshëm, rezultuar edhe nga gjetjet e auditimit. Nga ana e Këshillit Mbikëqyrës nuk janë ushtruar detyrat që kanë të bëjnë me monitorimin dhe kontrollin e aktivitetit të shoqërisë, me synim përmirësimin e gjendjes së shoqërisë dhe realizimin e shpenzimeve me ekonomicitet.

Kriteri: Në mos zbatim të Ligjit nr. 10296, të datës 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

Ndikimi/efekti: Nuk garantohet ekonomiciteti, efienca dhe efektiviteti i shpenzimit të fondeve, në administrim të shoqërisë.

Shkaku: Mos përmbushja e detyrimeve në zbatim të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Rëndësia: I mesëm.

Rekomandime: Shoqëria duhet të marrë masa për implementimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Nga ana e drejtorisë nuk janë marrë masa për implementimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, të datës 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, të Ministrisë të Financave, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Këshilli Mbikëqyrës i "Hekurudha Shqiptare" SHA, përbëhet nga 6 anëtarë. Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se për periudhën objekt auditimi këshilli mbikëqyrës ka zhvilluar mbi 4 mbledhje në vit. Janë plotësuar periodikisht deklaratat mbi pjesëmarrjen në këshilla të tjera mbikëqyrës apo borde. Për zhvillimin e mbledhjeve janë bërë njoftimet në kohën e duhur si dhe materialet që do shqyrtohen. Janë mbajtur raporte të rregullta të mbledhjeve si dhe disponohet një protokoll për praktikatat që kanë lidhje me këshillin mbikëqyrës.

Për vitin 2015, janë zhvilluar mbledhje me datë 16.04, 08.05, 02.06, 14.07, 22.07, 13.10, dhe 26.11.2015. Në këto mbledhje janë marrë vendime në lidhje me miratimin e tarifave të transportit të mallrave, ndryshime në strukturën organizative, miratim i raportit të veprimtarisë së shoqërisë, mbi veprimtarinë e auditit të brendshëm, realizimin e rekomandimeve të KLSH,



miratimin e pasqyrave financiare, shqyrtimin e situatës së detyrimeve debitore e kreditore. Në tetor 2015, është larguar nga anëtar i këshillit mbikëqyrës znj. L.M dhe është emëruar znj. O.M.

Për vitin 2016, janë zhvilluar 7 mbledhje dhe janë marrë 12 vendime. Vendimet kanë të bëjnë me miratimin e programit ekonomik, ndryshime në strukturë, ndërprerje e shërbimit të ruajtjes objekteve me SHRSF. Është marrë vendimi për hapje ankand për shitje skrapi, miratim i pasqyrave financiare. Në mbledhjen e datës 28.10.2016, është marrë Vendimi nr. 11, për pranimin e dorëheqjes nga detyra e administratorit të shoqërisë z. G.A dhe emërimin e z. I.D. Është larguar nga anëtare e këshillit mbikëqyrës znj. T.E dhe U.H dhe janë emëruar z. Th.Xh dhe znj. M.S.

Për vitin 2017, janë zhvilluar 8 mbledhje në të cilat janë marrë 12 vendime. Vendimet kanë të bëjnë me zgjedhjen e znj. O.Z në funksionin e Kryetares së Këshillit Mbikëqyrës. Është marrë vendim për nxjerrjen jashtë përdorimi të 124 vagonë malli dhe 8 vagonë udhëtarësh. Janë marrë vendime për financimin e projektit me BERZH, mbi miratimin e projektprogramit ekonomik, ndryshime në strukturën organizative.

Janë larguar nga anëtar të këshillit mbikëqyrës znj. O.M dhe znj. O.F dhe janë emëruar z. F.M dhe znj. M.N. Është marrë vendimi për zgjedhjen e z. G.K në cilësinë e Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës. Janë emëruar z. A.Sh, dhe z. P.Sh.

Në mbledhjen e datës 04.12.2017, është larguar nga detyra z. I.D dhe është emëruar z. A.D.

Asambleja e aksionarëve ka marrë vendimin nr. 44, datë 21.03.2018, për lirimin nga detyra të z. G.K dhe është emëruar znj. T.B.

Anëtarët e këshillit mbikëqyrës aktualë janë znj. T.B, z. A.Sh, z. P.Sh, z. F.M, znj. M.N, z. K.M. Nga ana e drejtorisë rezulton se janë nxjerrë urdhra të ndryshëm që kanë të bëjnë me ndryshime për ecurinë e aktivitetit të shoqërisë.

Nga ana e drejtorisë nuk janë marrë masa për implementimin në Rregulloren e Brendshme të ligjit nr. 10296, të datës 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Për mangësitë e konstatuara mban përgjegjësi z. G.K në cilësinë e Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës dhe Ish-Administratori z. I.D.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Nga ana e drejtorisë nuk janë marrë hapa për implementimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Gjithashtu, nga ana e Këshillit Mbikëqyrës nuk janë ushtrua kompetencat, në përputhje me udhëzimet përkatëse.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Ligji nr. 10296, të datës 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:

1. z. G.K, në cilësinë e Ish-Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë.
2. z. I.D, në cilësinë e Ish-Drejtorit të shoqërisë.

IV. 3. Mbi hartimin, shqyrtimin, miratimin dhe zbatimin e programit ekonomik-financiar. Ndjekja dhe realizimi i treguesve ekonomik-financiar në qendër dhe njësitë e vartësisë, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:



- Planet e biznesit
- Plan programi ekonomik
- Dokumente të brendshme (rregullore, vendime, procesverbale, raporte etj)
- Pasqyrat financiare vjetore

Titulli i Gjetjes: Programim ekonomik i pa studiuar

Situata: Programi ekonomik dhe financiar për vitet 2015-2017, nuk është përgatitur bazuar në rezultatet e arritura në vitin paraardhës si edhe në nivelin ekonomik financiar të shoqërisë për të realizuar investimet e parashikuara,

Nuk kryhet bashkërendimi i punës së degëve e specialistëve brenda stafit të shoqërisë

Programi ekonomik dhe financiar i shoqërisë, megjithëse ka ndjekur procedurat dhe afatet përcaktuar në udhëzimin përkatës, nuk ka pasqyruar tregues të mirë harmonizuar midis tyre.

Në disa zëra të llogarive për shpenzimet operative dhe të ardhurat për mallra dhe shërbime konstatohet angazhim më i madh gjatë vitit në krahasim me planifikimin fillestar. Në disa zëra të llogarive konstatohet angazhim më i ulët gjatë vitit në krahasim me planifikimin fillestar si pasojë e tjetërsimit të destinacionit të fondit buxhetor. Në të dyja rastet, situata tregon një planifikim jo të saktë në fillim të vitit dhe shpenzimin më të madh për disa llogari në krahasim me llogari të tjera pavarësisht ruajtjes në total të limitit për angazhim fondi.

Kriteri: Ndryshimet në programin ekonomik financiar nuk janë miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 08.04.2009, Kreu IV, “Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës”, pika 5 citon:

Pika IV “Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës:

5. Këshilli Mbikëqyrës i propozon Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës lidhur me këto çështje:

a) Përcaktimin dhe ndryshimin e programit të veprimtarisë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë të shoqërisë.

Ndikimi: Menaxhim i dobët financiar pasi kjo situatë jo vetëm që shfaq mangësitë e programimit nga strukturat drejtuese përgjegjëse, por në të njëjtën kohë shfaq prirjen për sigurimin e të ardhurave jashtë aktivitetit kryesor të shoqërisë, duke shkaktuar paqëndrueshmëri financiare afatgjatë.

Shkaku: Mungesa e përcaktimit të qartë të detyrave dhe përgjegjësive specifike si dhe mungesa e kontroleve mbi aplikimin e limiteve të fondeve sipas programit.

Rëndësia: E mesme.


Rekomandime: Shoqëria duhet të marrë masa për rakordimin dhe unifikimin e vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare me vlerat e paraqitura në raportet e monitorimit të programit ekonomik-financiar

Pasqyrimi në mënyrë grafike i situatës ekonomik financiarë në 5 vjeçarin e fundit të kësaj shoqëria paraqitet si më poshtë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës



- Përkundër angazhimit të kësaj shoqërie, për uljen e shpenzimeve dhe rritjes së të ardhurave, performanca e treguesve ekonomiko-financiar, nuk është aspak e kënaqshme dhe ka vend të përmirësohet.

Për Hekurudhën Shqiptare për çdo lekë të shpenzuar për vitin 2015, është përfituar një e ardhur 0,52 lekë, për çdo lekë të shpenzuar për vitin 2016, është përfituar një e ardhur 0,51 lekë dhe për çdo lekë të shpenzuar për vitin 2017, është përfituar një e ardhur 0,54 lekë. Pra siç tregohet për vitin 2016 ka një rënie me 0.1 lekë nga viti 2015, ndërsa viti 2017 ka një rritje me 0.3 lekë nga viti 2016.

Shtuar këtyre treguesve dhe shlyerjen;

-e kredisë me shoqërinë Mediocredita Centrales Itali, kredi e miratuar me VKM nr. 178, datë 18.04 1995, e cila deri në 31.12.2017, është **në vlerën 384,122,512 lekë**.

-e kredisë me Bankën Botërore e cila deri në 31.10.2017, është **në vlerën 128,170,000 lekë**.

-grantin japonez i cili deri në 31.10.2017, është **në vlerën 224,154,171 lekë**.

-detyrimin ndaj hekurudhave të huaja, të cilat deri më datën 31.12.2017 është **në vlerën 217,539,509 lekë**.

-detyrimeve të tjera më datë 31.12.2017, **në vlerën 89,899,228 lekë** (kryesisht rojet private).

Si konkluzion kjo performancë mund të rrezikojë vijimësinë e kësaj shoqërie në të ardhmen.

-Për vitin 2015, programi ekonomiko-financiar është hartuar nga Shoqëria Hekurudha shqiptare dhe miratuar nga ish-Administratori i saj me shkresën nr. 1038/2 prot. Datë 18.11.2014 dërguar për miratim në Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë i cili me vendimin e nr. 14 datë 21.11.2014 ka miratuar programin ekonomiko-financiarë. Programi ekonomiko-financiarë së bashku me mendimin e Ministrisë së Transportit përcjellë me shkresën nr. 1203, datë 23.02.2015 për konfirmimi në MZHETTS, e cila e ka miratuar programin ekonomik të shoqërisë me shkresën nr. 1757/1 datë 03.04.2015 si Aksionari i vetëm “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”.

-Për vitin 2016, programi ekonomiko-financiar është hartuar nga Shoqëria Hekurudha Shqiptare dhe miratuar nga ish-Administratori i saj me shkresën nr. 137 prot., Datë 04.02.2016 dërguar për miratim në Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë i cili me vendimin e nr. 1 datë 18.02.2016 ka miratuar programin ekonomiko-financiarë. Programi ekonomiko-financiarë së bashku me mendimin e Ministrisë së Transportit përcjellë me shkresën nr. 3742/1, datë 29.07.2016 për konfirmimi në MZHETTS, e cila e ka miratuar programin ekonomik të shoqërisë me shkresën nr. 6319/1 datë 22.08.2016 si Aksionari i vetëm “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”.

Hartimi dhe miratimi i programit ekonomik nga Shoqëria Hekurudha Shqiptare dhe Këshilli mbikëqyrës janë bërë 3 muaj vonesë në kundërshtim me:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

Udhëzimin Nr. 394, datë 21.8.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror” kreu III pika 2 I cili citon: *Drejtoritë e shoqërive, ku shteti ka mbi 50% të aksioneve, hartojnë projektprogramet dhe dërgojnë kopje të tyre, me relacion shpjegues pranë këshillave mbikëqyrës, brenda datës 1 nëntor të çdo viti. Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi ish Administratorin e shoqërisë.*

Gjithashtu nga anlizimi i shkresës nr. 3742/1 datë 29.07.2016 të Ministrisë së Transporteve dhe Infrastrukturës është cituar se: janë evidentuar mangësi nga pikëpamja e zhvillimit të tregut në transportin e mallit si edhe problem të tjera të cilat nuk janë reflektuar plotësisht në këtë program.

- Studimit të tregut dhe rrugëve për rritjen e volumit të transportit të mallrave,
- Rishikimi të numrit të punonjësve dhe pagave të nevojshme për ta, edhe nën fokusin e mbulimit prej tyre të shërbimeve që deri vitin e kaluar i kanë bërë të tretët,
- Lehtësimin të problematikës së karburantit
- Realizim të ankandit të skrapit
- Ndërprerjes së shërbimit të rojeve private
- Heqje të akcizës dhe taksës së qarkullimit të karburantit që përdor hekurudha
- shitje të mundshme të vagonëve apo mjeteve të tjera lëvizëse jashtë përdorimi
- Shitje të aseteve të tjera të pa nevojshme

Problematika të mbartura dhe në vijimësi nga shoqëria hekurudha Shqiptare edhe pse në disa prej tyre është reflektuar siç është heqja e shërbimit të rojeve private etj.

-Gjithashtu për vitin 2016, programi ekonomik-financiar është hartuar nga Shoqëria Hekurudha Shqiptare dhe miratuar nga ish-Administratori i saj I.D me shkresën nr. 852 prot. Datë 07.11.2016 dërguar për miratim në Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë i cili me vendimin e nr. 12 datë 22.11.2016 ka miratuar ndryshimet në programin ekonomik-financiarë. Dërguar për miratim pranë MTI me shkresën nr. 06 prot., datë 06.01.2017.

-Për vitin 2017, programi ekonomik-financiar është hartuar nga Shoqëria Hekurudha Shqiptare dhe miratuar nga ish-Administratori i saj me shkresën nr. 932 prot., datë 14.12.2016 dërguar për miratim në Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë i cili me vendimin e nr. 14 datë 16.12.2016 ka miratuar programin ekonomik-financiarë. Programi ekonomik-financiarë së bashku me mendimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës përcjellë me shkresën nr. 1502, datë 16.03.2017 për konfirmimi në MZHETTS, e cila e ka miratuar programin ekonomik të shoqërisë me shkresën nr. 2635/1 datë 18.04.2017 si Aksionari i vetëm “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”.

Hartimi dhe miratimi i programit ekonomik nga Shoqëria Hekurudha Shqiptare dhe Këshilli Mbikëqyrës janë bërë 1 muaj vonesë në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 394, datë 21.8.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror” kreu III pika 2 i cili citon: *Drejtoritë e shoqërive, ku shteti ka mbi 50 % të aksioneve, hartojnë projektprogramet dhe dërgojnë kopje të tyre, me relacion shpjegues pranë këshillave mbikëqyrës, brenda datës 1 nëntor të çdo viti. Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi ish Administratorin e shoqërisë I.D.*

Hekurudha Shqiptare	2015 Plan	2015 Fakt	2016 Plan	2016 Fakt	2017 Plan	2017 Fakt
Të ardhura	989,600,000	775,355,440	848,400,000	566,778,348	773,000,000	666,705,000
Shpenzime	1,734,600,000	1,488,052,052	1,329,400,000	1,105,691,841	1,266,320,000	1,226,901,000
Raporti	0.57	0.52	0.64	0.51	0.61	0.54



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

Nësia e B. Mallit						
Të ardhura	193,698,899.00	185,873,370	150,548,965.80	71,741,004	246,846,415.00	203,813,570
Shpenzime	228,207,123.07	194,881,113	222,773,313.17	121,029,730	260,950,960.00	289,751,948
Raporti	0.85	0.95	0.68	0.68	0.55	0.55
Njësia e B. Udhëtarëve						
Të ardhura	25,711,284.00	451,335,384	15,057,367.00	395,533,130	10,425,095.00	409,738,345
Shpenzime	239,105,735.34	186,223,976	460,110,902.00	114,315,488	413,216,191.00	126,668,607
Raporti	0.11	0.11	0.03	0.03	0.03	0.03
Njësia e B. të Menaxhimit të Infstrukturës						
Të ardhura	5,832,843.00	34,136,894	266,906,132.00	27,661,566	199,779,136.00	104,532,363
Shpenzime	530,004,238.00	802,618,372	564,148,296.00	719,011,888	466,700,547.00	744,185,463
Raporti	0.01	0.01	0.47	0.47	0.43	0.43
Njësia e B. të mirëmbajtjes të Mje. Lëviz.						
Të ardhura	102,547,604.00	29,520,480	133,318,310.00	10,931,483	99,968,022.00	2,551,912
Shpenzime	137,634,308.00	158,873,088	110,406,010.00	86,311,587	106,374,235.00	67,873,402
Raporti	0.75	0.75	1.21	1.21	0.94	0.94

Burimi i të dhënave; Hekurudha Shqiptare, drejtoria ekonomike

Përkundër angazhimit të kësaj shoqërie, për uljen e shpenzimeve dhe rritjes së të ardhurave, performanca e treguesve ekonomiko-financiar, nuk është aspak e kënaqshme dhe ka vend të përmirësohet.

Siç pasqyrohet dhe në tabelën e mësipërme në total për Hekurudhën Shqiptare për çdo lekë të shpenzuar për vitin 2015, është përfituar një e ardhur 0,52 lekë, për çdo lekë të shpenzuar për vitin 2016, është përfituar një e ardhur 0,51 lekë dhe për çdo lekë të shpenzuar për vitin 2017, është përfituar një e ardhur 0,54 lekë. Pra siç tregohet për vitin 2016 ka një ulje me 0.1 lekë nga viti 2015, ndërsa viti 2017 ka një zvogëlim me 0.3 lekë nga viti 2016.

-Në hartimin e programit ekonomiko financiarë nga ana e shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sha Durrës vlera e përllogarit si shpenzim amortizimi nuk paraqet vlerën reale të amortizimit të aseteve, duke sjellë një shtrembërim të programit ekonomik.

Shtuar këtyre treguesve dhe shlyerjen;

-e kredisë me shoqërinë M. C. Itali, kredi e miratuar me VKM nr. 178, datë 18.04 1995, e cila deri në 31.12.2017, është **në vlerën 384,122,512 lekë**.

-e kredisë me Bankën Botërore e cila deri në 31.10.2017, është në **vlerën 128,170,000 lekë**.

-grantin japonez i cili deri në 31.10.2017, është në **vlerën 224,154,171 lekë**.

-detyrimin ndaj hekurudhave të huaja, të cilat deri më datën 31.12.2017 është **në vlerën 217,539,509 lekë**.

-detyrimeve të tjera më datë 31.12.2017, **në vlerën 89,899,228 lekë** (kryesisht rojet private).

Si konkluzion kjo performancë mund të rrezikojë vijimësinë e kësaj shoqërie në të ardhmen.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

z. A.P, në cilësinë e ish-Drejtorit Ekonomik

z. I.D me detyrë ish-Administrator i Shoqërisë

z. A.V me detyrë përgjegjës i sektorit të financës



IV.4. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Ligji mbi të cilin rregullohen marrëdhëniet e punës dhe struktura e shoqërisë është Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Statuti i Shoqërisë si dhe Rregullorja e Organizimit dhe Funksionimit të Shoqërisë.

Gjithashtu, marrëdhëniet e punës rregullohen nga Kodi i Punës i republikës së Shqipërisë dhe Kontrata Kolektive e Punës e Nivelit të Parë për vitet 2016-2019, është lidhur në datë 22.02.2016 mes ish-Administratorit Të Hekurudhës Shqiptare Sh.a Durrës Z. G.A dhe administratorit të Sindikatës së Pavarur të Transportit Hekurudhor (S.P.T.H) Z. Osman Meta.

Struktura dhe skema organizative e Hekurudha Shqiptare SHA është miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 02 datë 16.04.2015 me Kryetar E.S dhe anëtarë T.E, A.K, O.I dhe L.M pas miratimit të kryer me Vendimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 462 datë 09.04.2015 protokolluar në institucion me nr. 03 prot., në datë 09.04.2015.

Bashkangjitur vendimit është dhe relacioni i pagave i cili sqaron më detaje strukturën e shoqërisë.

Shoqëria është e ndarë në 5 njësi dhe secila prej njësive në sektorë dhe degë.

-Njësia Drejtuese përbëhet nga 33 punonjës dhe në krahasim me 1 vit më parë është shtuar 1 punonjës pas ndarjes së sektorit të Investimeve me atë të prokurimeve

-Njësia e Biznesit Udhëtarëve ka 188 persona në strukturë, 2 më pak se 1 vit më parë pasi 2 pozicionet e shkurtuara kanë kaluar për plotësim strukture në Njësinë e Biznesit Mallit.

-Njësia e Biznesit të Mallit ka 117 persona në strukturë, një vit më parë kishte 108, 2 pozicione që iu hoqën Njesisë së Biznesit të Udhëtarëve iu shtuan Njesisë së Biznesit të Mallit. Është shtuar posti N/Drejtuesit i cili është plotësuar nga shkurtimi i një vendi nga Njësia e Shërbimit të Mjeteve Lëvizëse ndërkohë për 6 pozicionet e tjera në strukturë, atë të Juristit të Njesisë 5 punonjësit e tjerë të shtuar për arsye pune si fuqi punëtore nuk ka shpjegim të detajuar se pse nevojiten këto shtesa

-Njësia e Biznesit Menaxhimit të Infrastrukturës ka 669 persona në strukturë dhe është shkurtuar me 6 pozicione në krahasim me një vit më parë.

-Njësia e Shërbimit Mjeteve Lëvizëse ka 123 persona në strukturë dhe 2 më pak se një vit më parë

Në relacionin e strukturës së pagave citohet se propozimet për ndryshimet e strukturës janë bazuar në:

1. Periudhën 1 vjeçare në drejtim të Hekurudhës

Në krahasim me 1 vit më parë numri total është ruajtur me 1130 punonjës dhe është numri që nevojitet sipas drejtuesve për funksionimin dhe mbarëvajtjen e punës

2. Mendimin e specialistëve më të mirë që kanë drejtuar Hekurudhën Shqiptare.

Këto mendime nuk janë të shprehura në relacion si për shkurtime edhe për shtimet e pozicioneve të punës.

Në vitin 2016 është ruajtur e njëjta strukturë, nuk ka tejkalim të strukturës në listëpagesat e kontrolluara.

Në vitin 2017, me Vendim nr. 02 datë 09.01.2017 të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës lejohet shkurtimi i 46 pozicioneve të punës, përkatësisht 10 pozicione në Njësinë e Biznesit të Udhëtarëve dhe 36 pozicione në Njësinë e Biznesit dhe Menaxhimit të Infrastrukturës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

Gjatë periudhës objekt auditimi në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” Sha janë konstatuar lëvizje të shumta të punonjësve në pozicione të ndryshme pune si në largimet nga puna ashtu dhe në marrjen në punë. Këto lëvizje të shumta nuk reflektohen në procese gjyqësore pasi një pjesë e largimeve vijnë si rezultat i daljeve në pension, një pjesë nga mos paraqitja në punë etj.

Lëvizjet e punonjësve në këtë shoqëri për periudhën objekt auditimi paraqitet si më poshtë:

Vitet	2015	2016	2017
Punësime	93	81	204
Largime	125	112	241

Numri i pranimeve në punë ka qenë gjithmonë më i vogël si rezultat edhe i ristrukturimit të vazhdueshëm të kësaj shoqërie në uljen e fuqisë punëtore.

Për vitin 2017 që mbas marrjes me koncesion të segmentit Ballsh-Fier-Vlorë nga një operatorë private në këtë shoqëri u larguan nga puna 40 punonjës që mbulonin këtë nën Njësi.

Për periudhën objekt auditimi, punonjësit e larguar padrejtësisht nga puna kanë hapur procese gjyqësore ligjore për të cilat një pjesë kanë përfunduar proceset, një pjesë janë në shqyrtim. Nga largimet nga Puna të pajustificuara nga punonjësit e larguar janë kanë ngritur 35 padi ndaj shoqërisë “Hekurudha Shiptare” SHA, gjatë viteve 2015, 2016 dhe 2017.

Nga këto procese gjyqësore 7 procese janë fituar nga hekurudha Shqiptare 1 proces është në gjykim dhe 27 janë humbur nga kjo shoqëri.

Titulli i Gjetjes: Largime nga puna pjesërisht/plotësisht të pajustificuara.

Situata: Për periudhën objekt auditimi, punonjësit janë larguar nga puna si pasojë e suprimimit të vendit të punës, në momentin e daljes në pension, në momentin e përfundimit të kontratës së punës ose si pasojë e largimit me dëshirën e tyre. 35 Punonjës të larguar nga puna kanë hapur procese gjyqësore ligjore për të cilat janë marrë 18 vendime të formës së prerë në vitet 2015-2017 me vlerë të **efektit negativ financiar në shumën 11,481,144 lekë**, 12 nga këto vendimi janë në proces gjë që do e rendojë akoma më shumë situatën financiare në këtë shoqëri.

Kriteri: Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës”, Nenin 27 i cili citon:

Neni 27 - Përgjegjësia e punëmarrësit

1. Punëmarrësi përgjigjet ndaj punëdhënësit për dëmin që i shkakton kur shkel detyrimet kontraktuale me dashje ose nga pakujdesia.

2. Shkalla e kujdesit, që duhet të tregojë punëmarrësi në punë, varet nga njohuritë teknike, të nevojshme për të kryer punën e caktuar, duke pasur parasysh aftësitë dhe cilësitë e punëmarrësit, që punëdhënësi i njihte ose duhet t'i kishte njohur. Dëmi, që lidhet në mënyrë të qenësishme me kryerjen e punës, përballohet nga punëdhënësi.

3. Dëmi përfshin dëmin real dhe fitimin e munguar.

4. Gjykata mund të shkarkojë plotësisht ose pjesërisht punëmarrësin nga detyrimi për shpërblimin e dëmit kur:

-punëmarrësi ka vepruar me pakujdesi të lehtë;

-punëdhënësi, në organizimin dhe kontrollin e punës, bën të njëjtin gabim që lidhet me shkaktimin e dëmit;

-detyrimi për të zhdëmtuar plotësisht dëmin s'është i përballueshëm duke pasur parasysh



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë "Hekurudha Shqiptare" SHA Durrës

burimet e të ardhurave të punëmarrësit.

Ndikimi: Largimet e pajustificuara nga puna ndikojnë në rritjen e kostove operative të shoqërisë
Shkaku: Largime nga puna duke shkelur klauzolat e Kodit të Punës dhe kontratave individuale të punës.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandime: Shoqëria duhet të marrë masa për shqyrtimin e efektit financiar në vlerën totale 11,481,144 lekë, të ardhur si pasojë e mos-ndjekjes së procedurave ligjore në largimin e punonjësve nga puna, për evidentimin e përgjegjësive, si dhe nga Sektori Juridik të merren masa për ndjekjen e të gjitha çështjeve gjyqësore, në të gjitha shkallët e gjykimit për shmangien e kostove shtese nga proceset gjyqësore në proces të cilat mbartin risk të lartë për efekt negative financiar në të ardhmen.

Shoqëria duhet të marrë masa të analizojë në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara përmbarrimore, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

Të dhënat plan-fakt janë si më poshtë vijon:

Nr	Emërtimi	Njësia e Matjes	Viti 2015				
			Plan	Fakti nga listëpagesat e dorëzuara	Fakti nga Realizimi i Programit Ekonomik	Realizimi në %	Diferenca në raportim
1	Numri mesatar i punonjësve	Numri mesatar/muaj	1130	1,135		100.44%	
2	Fondi i pagave	Lekë	362,000,000	355,481,725	355,501,900	98.20%	20,175
3	Sigurime Shoqërore	Lekë	60,400,000	53,666,980	59,699,933	88.85%	6,032,953
4	Sigurime Shëndetësore			12,191,448			
5	TAP-i	Lekë	5,400,000	3,368,582		62.38%	
6	Paga mesatare	Lekë	26,696	26,104		97.78%	
7	Shpërblimet	Lekë		0			

Siç shihet në tabelën më sipër numri mesatar i punonjësve është realizuar dhe tejkalar në masën 100.44 %.

Por edhe pse kemi një tejkallim të numrit të punonjësve të planifikuar dhe realizuar fondi i pagave është me një realizim prej 98.2% çka do të thotë që planifikimi i fondit të pagave nga ana e Hekurudha Shqiptare sh.a nuk është bërë konform ligjeve në fuqi.

Janë kontrolluar listëpagesat e vitit 2015 dhe ka tejkallim në strukturë sipas tabelës më poshtë:

Nr	Muaj	Nr faktik	Nr strukturës	Tejkallimi
1	Janar	1,150	1130	20
2	Shkurt	1,145	1130	15
3	Maj	1,132	1130	2



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

4	Qershor	1,143	1130	13
5	Korrik	1,143	1130	13
6	Gusht	1,137	1130	7
7	Shtator	1,133	1130	3

Gjithashtu janë vënë re diferenca dhe pasaktësi midis fondit të pagave të cilat janë llogaritur nga grupi i auditimit të KLSH në bazë të listëpagesave të dorëzuara nga subjekti dhe fondit të pagave të raportuara si shpenzime vjetore në realizimin e programit ekonomik, ndërkohë nuk ka parashikim në programin ekonomik për sigurimet shëndetësore.

Është përlllogaritur, ndalur dhe derdhur në organet tatimore kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore mbi bazën e pagës minimale dhe maksimale si dhe përqindjeve përkatëse punëdhënës e punëmarrës sipas VKM nr. 1114, datë 30.7.2008 i ndryshuar “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 26, datë 16.4.2009 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” i ndryshuar. Afatet e deklarimit dhe pagesës së kontributeve janë në varësi të statusit të personit që detyrohet të paguajë kontributet dhe përcaktohen në nenet 10 dhe 11 të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i përcaktuar jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës. Pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale nga punësimi, si dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Nga verifikimi i sistemit tatimor, nuk kanë gjoha dhe kamatëvonesa të aplikuar.

Nr	Emërtimi	Njësia e Matjes	Viti 2016				
			Plan	Fakti nga Listëpagesat e dorëzuara	Fakti nga Realizimi i Programit Ekonomik	Realizimi në %	Diferenca në raportim
1	Numri mesatar i punonjësve	Numri mesatar/muaj	1,100	1,107		101%	
2	Fondi i pagave	Lekë	346,600,000	342,544,944	342,533,795	99%	-11,149
3	Sigurime Shoqërore	Lekë	57,900,000	51,681,700	57,499,249	89%	5,817,549
4	Sigurime Shëndetësore			11,738,614			
5	TAP-i	Lekë	5,400,000	3,209,942		59%	
6	Paga mesatare	Lekë	26,257	25,792		98%	
7	Shpërblimet	Lekë		0			



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

E njëjta problematikë pasaktësie është vënë re edhe në vitin 2016 dhe gjithashtu në këtë vit nuk ka parashikim të vlerës së sigurimeve shoqërore.

Ka tejkalim të strukturës së pagave si më poshtë:

	Nr real	struktura e miratuar	Tejkalimi
Janar	1,114	1100	14
Shkurt	1,113	1100	13
Mars	1,118	1100	18
Prill	1,119	1100	19
Maj	1,121	1100	21
Qershor	1,114	1100	14
Korrik	1,112	1100	12
Gusht	1,109	1100	9

Tejkalimi vërtetohet edhe nga tabela e më poshtme:

	Numri i të punësuarve Viti 2016	Numri i të punësuarve Viti 2015
Të punësuar mesatarisht		
Me pagë deri në 22.000 lekë		
Me pagë nga 22.001 deri në 30.000 lekë	974	1,008
Me pagë nga 30.001 deri në 66.500 lekë	102	102
Me pagë nga 66.501 deri në 97.030 lekë	7	7
Me pagë më të lartë se 97.030 lekë	9	9
Totali	1,092	1,126

Për vitin 2017, realizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shëndetësore janë brenda kufirit të parashikuar

Nr	Emërtimi	Njësia e Matjes	Viti 2017		
			Plan	Fakti nga Realizimi i Programit Ekonomik	Përqindja
1	Numri mesatar i punonjësve	Numri mesatar/muaj	1,100		
2	Fondi i pagave	Lekë	364,600,000	354,699,625	97%
3	Sigurime Shoqërore	Lekë	60,900,000	60,051,001	99%
4	Sigurime Shëndetësore				
5	TAP-i	Lekë	5,200,000		
6	Paga mesatare	Lekë	27,621		
7	Shpërblimet	Lekë	0		

Janë audituar procedurat e largimit nga puna në muajin qershor 2017 në të cilin figurojnë 51 persona të larguar dhe për secilin prej tyre në datë 29.06.2017 dhe 30.06.2017 figurojnë urdhrat



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

përkatës ku këta persona janë pushuar si pasojë e mos-paraqitjes në punë. Këta persona nuk kanë paraqitur raport mjekësor apo ndonjë arsye tjetër të justifikueshme. Gjatë largimit të këtyre punonjësve paralelisht janë marrë në punë punonjës të tjerë.

Për këtë është hapur dhe një proces penal nr. 1305 të vitit 2017 regjistruar për veprat penale të “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 K Penal.

Për vitin 2017 nga ana e “Hekurudha Shqiptare” sha Administratorit të saj z. I.D janë kryer pushime kolektive nga puna në 3 grupe të ndryshme brenda vitit 2017 në kundërshtim me nenin 148 të ligjit 7961 datë 12.07.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar duke mos respektuar pikën 1 të këtij neni i cili citon: *Punëdhënësi, që nuk respekton procedurën e pushimit kolektiv nga puna, të parashikuar në pikat 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni, detyrohet t’i japë punëmarrësit një dëmshpërblim deri në gjashtë muaj page, dëmshpërblim i cili i shtohet pagës gjatë afatit të njoftimit ose dëmshpërblimit që merret në rast mosrespektimi të këtij afati, të parashikuar në nenin 143.*

Duke i ndarë në 3 grupime largimesh brenda 90 ditëve nga ana e administratorit të shoqërisë janë larguar 211 punonjës duke filluar nga 1 prill 2017 deri më 15 dhjetor 2017. Referuar nenit 148 të ligjit 7961 datë 12.07.1995 Kodi i Punës i republikës së Shqipërisë i ndryshuar pika 6 detyrohet t’i japë punëmarrësit një dëmshpërblim deri në gjashtë muaj page, dëmshpërblim i cili i shtohet pagës gjatë afatit të njoftimit ose dëmshpërblimit që merret në rast mosrespektimi të këtij afati, të parashikuar në nenin 143, referuar pagës mesatare vjetore 27,621 lekë x 6 muaj = 165,726 lekë x 211 punonjës = 34,968,186 lekë vlerë e cila mund të rëndonte situatën financiare të shoqërisë.

Nga analiza e 51 rasteve të largimeve nga puna rezulton se kjo situatë nuk ka ndodhur pasi këto punonjës nuk kanë respektuar kontratën kolektive datë 22.02.2016.

Procedura që zbatohet në largimet nga puna është ajo që përfshin informimin, konsultimin e organizatës së punëmarrësve, dhe në mungesë të saj të vetë punëmarrësve, si kolektiv, por edhe si tërësi individësh të mëvetësishëm, si dhe besimin e ndërmjetësimit të autoriteti publik qendror (Ministria e linjës).

Hapi i parë. Njoftimi paraprak drejtuar organizatës së punëmarrësve (dhe në rast mos-organizimi, njoftimi publik për punëmarrësit) shënon fillimin e procedurës ligjore në rast pushimesh kolektive. Njoftimi nuk duhet të jetë sipërfaqësor, por duhet të trajtojë posaçërisht katër aspekte të kërkuar nga paragrafi i dytë i dispozitës së nenit 148:

- arsyet e pushimit nga puna;
- numrin e punëmarrësve që do të pushohen;
- numrin e punëmarrësve të punësuar normalisht; si dhe
- kohën gjatë së cilës është parashikuar të kryhen këto pushime.

Një kopje e njoftimit i dërgohet edhe Ministrisë së linjës.

Hapi i dytë. Për një periudhë jo më pak se 30 ditë nga njoftimi i sipërpërmendur, mbahen këshillime midis punëdhënësit dhe organizatës së punëmarrësve, dhe në mungesë të saj, punëmarrësve drejtpërdrejt. Synimi i tyre është arritja e një marrëveshjeje, duke parapëlqyer masat për shmangien ose pakësimin e pushimeve kolektive nga puna, dhe në pamundësi për të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

zbutur pasojat e tyre. Një procedurë e rregullt kërkon që këshillimet jo vetëm të fillojnë, por edhe të zhvillohen intensivisht brenda afatit 30 ditor.

Hapi i tretë. Përfundimi i këshillimeve i njoftohet Ministrisë së linjës, si edhe palës me të cilën është kryer këshillimi (organizatës së punëmarrësve, dhe në mungesë, shpallet ose u njoftohet punëmarrësve të prekur). Në rast mosarritjeje të marrëveshjes midis palëve, Ministria e linjës ndërmjetëson midis tyre për të arritur një marrëveshje. Në këtë rast afati i ndërmjetësimit rregullohet në mënyrë të njëjtë si afati i këshillimit brenda ndërmarrjes, treguar në hapin e dytë të sipërpërmendur. Me gjithë aktivizimin e saj të dobishëm, nuk është në tagrin e Ministrisë së linjës të ushtrojë autoritet për të ndaluar pushimet kolektive.

Hapi i katërt. Në rast se ndërmjetësimi nuk sjell shmangien e pushimeve kolektive, punëdhënësi u njofton punëmarrësve që do të pushohen, zgjidhjen e kontratës. Në këtë rast mbeten të zbatueshme dispozitat ligjore që parashikojnë kriteret dhe afatet (duke përfshirë afatin e njoftimit) për zgjidhjen individuale të kontratës së punës, me përjashtim të nenit 144 (procedura e zgjidhjes).

Sanksioni ligjor. Sanksioni ligjor procedural për punëdhënësin që nuk përmbush në një masë minimale të caktuar nga gjykata, procedurën e treguar në katër hapat e sipërpërmendur, është dëmshpërblim për punëmarrësin deri në gjashtë muaj pagë, i cili i shtohet pagës gjatë afatit të njoftimit ose dëmshpërblimit që merret në rast mosrespektimi të këtij afati, sipas nenit 143.

Përparësia në ripunësim. Pas zbatimit të pushimeve kolektive, në rast se punëdhënësi do të synojë marrjen në punë të personelit të ri, detyrohet nga ligji t’u japë përparësi në punësim ish-punëmarrësve të pushuar më parë në mënyrë kolektive, me kusht që për vendet e reja të punës të kërkohet kualifikim i krahasueshëm dhe që pushimet të kenë qenë mirëfilli kolektive (pra të mos kenë qenë kryer për arsye të lidhura me punëmarrësit).

-Në lidhje me celjen e fondit për ish të përndjekurit politik.

“Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës nuk ka zbatuar shkronjën “b” të nenit 1 të ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë” dhe VKM nr. 392, datë 12.08.1999 “Për administrimin e fondit të veçantë monetar, të krijuar sipas ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë” derdhur në Institutin e Integritit të ish-të Përndjekurve Politikë për të arkëtuar për llogari të Institutit të Integritit të ish-të Përndjekurve Politikë shumën 1 % të fondit të pagave për vitin 2015-2017 në **shumën totale 10,732,000 lekë.**

Fondi i pagave	Vlera	Fondi për të përndjekurit
2015	362,000,000	3,620,000
2016	346,600,000	3,466,000
2017	364,600,000	3,646,000
Totali		10,732,000 lekë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

z. A.P, në cilësinë e Drejtori Ekonomik

znj. K.I, në cilësinë e drejtores së personeli

z. I.D me detyrë ish-Administrator i Shoqërisë



IV.5. Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dita brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, etj.).

5. “Mbi auditimin e ushtruar mbi auditimin me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj)” u auditua dokumentacioni si më poshtë:

Dokumentacioni i pagesave të bankës.

Dokumentacioni i pagesave të arkës.

Dokumentacioni hyrjeve dhe daljeve të magazinës.

Dokumentacioni i mbajtur mbi marrjen në dorëzim të furnizimeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Titulli i Gjetjes: Pagesa me bankë për shërbime jo të shoqëruara me dokumentacion justifikues.

Situata: Në pagesat e kryera nga shoqëria gjatë viteve 2015, 2016, 2017 u konstatuan likuidime kryer për faturat e shërbimit të ruajtjes së stacionit hekurudhor Përrenjas nga shoqëria “M.” sh.r.s.f. ***Në zërin shërbime ruajtje objektesh në vitin 2015 janë kontabilizuar faturat nr. 11,18,23,24,25 me vlerë totale 5,349,564 lekë,*** të cilat i përkasin shërbimeve të kryera në vitet 2013 e 2014. Në faturat e mësipërme nuk është përshkruar data në të cilën furnizimi i shërbimit është kryer dhe se ku është kryer. Në lidhje me kontratat e lidhura me shoqërinë për kryerjen e shërbimit u konstatua se është proceduar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi nga viti 2008 janë lidhur kontrata shtesë furnizimi për shërbimin e “Ruajtjes me Sh.r.s.f. të stacionit hekurudhor, Përrenjas.

Kriteri: Këto veprime janë bërë në kundërshtim me ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” Nr.9920, datë 19.5.2008 neni 51

“Lëshimi i faturës tatimore, 1. Shitësi lëshon faturë tatimore dhe blerësi duhet ta kërkojë atë në kohën e realizimit të shitjes apo të kryerjes së punimit ose shërbimit. Fatura tatimore përgatitet nga shitësi në jo më pak se dy kopje, nga të cilat njërën e merr dhe e ruan blerësi, kurse tjetrën e mban dhe e ruan shitësi. Faturat përgatiten me numër rendor progresiv si dhe në kundërshtim me nenin 101, përmbajtja e faturës i cili citon “Fatura e lëshuar përpilohet në formën e caktuar nga Ministri i Financave dhe përmban informacionin e mëposhtëm: a) datën e lëshimit të faturës; e) sasinë dhe përshkrimin e mallrave të shitura dhe përshkrimin e shërbimeve të kryera; ë) datën, në të cilën furnizimi i mallrave ose shërbimeve është kryer ose datën, në të cilën pagesa është kryer, në përputhje me shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 97, të këtij ligji, në qoftë se kjo datë është e ndryshme nga data e lëshimit të faturës;”

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 36.

“Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë "Hekurudha Shqiptare" SHA Durrës

vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative."

Ligji Nr. 10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Neni 4, përkufizime, pika 26. *"Dokument financiar" është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative.*

Ndikimi: Vlera **5,349,564 lekë përbën dëm ekonomik** për shoqërinë.

Shkaku: Mungesa e mos ndjekjes së ligjeve dhe udhëzimeve përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandime: *Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimin, arkëtimi i vlerës 5,349,564 lekë, nga M. SH.R.S.F.*

Titulli i Gjetjes: Pagesa me bankë për shërbime jo të shoqëruara me dokumentacion justifikues.

Situata: Me urdhrin nr. 46/30, datë 05.05.2015, ish-administratori i shoqërisë z. G.A, ka urdhëruar kalimin e fondit prej 5,000,000 lekë për likuidimet ndaj shoqërisë "Th." sh.r.s.f., për faturën nr. 36, datë 28.12.2012 me vlerë 806,900 lekë, faturën nr. 45, datë 31.01.2013 me vlerë 806,880 lekë, faturën nr. 14, datë 28.02.2013 me vlerë 806,880 lekë, faturën nr. 19, datë 31.03.2013 me vlerë 806,880 lekë, faturën nr. 26, datë 30.04.2013 me vlerë 806,880 lekë, faturën nr. 32, datë 31.05.2013 me vlerë 806,800 lekë. Në faturat e mësipërme mungonte firma e blerësit, proces verbalet e kryerjes së shërbimit, dy nga faturat ishin kopje, si dhe nuk është përshkruar vendi ku është kryer shërbimi.

Likuidimi është kryer në kushtet kur faturat tatimore nuk janë firmosur nga asnjë përfaqësues i HSH, si dhe nuk ka proces verbal nga përgjegjësit e stacioneve për kryerjen e shërbimit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 36.

"Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative."

Ligji Nr.10 296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Neni 4, përkufizime, pika 26. *"Dokument financiar" është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative.*

Ndikimi: Vlera **4,841,220 lekë përbën dëm ekonomik**

Shkaku: Mungesa e mos ndjekjes së ligjeve dhe udhëzimeve përkatëse.

Rëndësia: E lartë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë "Hekurudha Shqiptare" SHA Durrës

Rekomandime: Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **5,000,000 lekë**, nga Th. (H.) SH.R.S.F.

Titulli i Gjetjes: Pagesa me bankë për shërbime jo të shoqëruara me dokumentacion justifikues.

Situata: Me urdhrin nr. 36/20, datë 22.09.2017, dhe duke firmosur urdhër transfertën në llogarinë e Bankës Amerikane të Investimeve, ish-administratori i shoqërisë z. I.D, ka urdhëruar kalimin e fondit prej 3,873,570 lekë për likuidimet ndaj shoqërisë "H. (Th.)" sh.r.s.f., për faturën nr. 34 datë 29.09.2015 me vlerë 557,484 lekë, faturën nr. 32, datë 31.08.2015 me vlerë 557,484, faturën nr. 31, datë 31.07.2015 me vlerë 557,484 lekë, faturën nr. 30, datë 30.06.2015 me vlerë 557,484 lekë, faturën nr. 29, datë 29.05.2015 me vlerë 557,484 lekë, faturën nr. 28, datë 30.04.2015 me vlerë 557,484 lekë dhe faturën nr. 26, datë 31.03.2015 me vlerë 557,484 lekë.

Në faturat e mësipërme mungonte firma e blerësit, proces verbalet e kryerjes së shërbimit, si dhe nuk është përshkruar vendi ku është kryer shërbimi.

Likuidimi është kryer në kushtet kur faturat tatimore nuk janë firmosur nga asnjë përfaqësues i HSH, si dhe nuk ka proces verbal nga përgjegjësit e stacioneve për kryerjen e shërbimit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 36.

"Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative."

Ligji Nr.10 296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Neni 4, përkufizime, pika 26. *"Dokument financiar" është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative.*

Ndikimi: **Vlera 3,873,570 lekë përbën dëm ekonomik**

Shkaku: Mungesa e mos ndjekjes së ligjeve dhe udhëzimeve përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandime: Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **3,873,570 lekë**, nga Th. (H.) SH.R.S.F.

Titulli i Gjetjes: Dëm ekonomik i shkaktuar shoqërisë nga veprimet ose mosveprimet e administratorëve

Situata: Shoqëria ka urdhër për vënien e sekuestros konservative për vlerën 2,086,183 lekë, për llogari të kreditorit z. B.H, Librazhd. Detyrimi ka ardhur nga kontrata e lidhur mes palëve më datë 05.01.2011 për dhënien me qira të një sipërfaqe tokë prej 200 m², në Librazhd, Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudhave për montimin e pajisjeve të radiondërlidhjes që i shërbejnë hekurudhës shqiptare të përfituara si grant nga kompania GE H. H. Për 3 muajt e parë qiraja prej 40,000 lekë është paguar nga HSH dhe më pas nuk është paguar më. Pas kërkesave të shumta



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

nga z. B.H, çështja është gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila ka vendosur më 02.06.2016 pagesën e prapambetur deri me 01.02.2016 si dhe shumën prej 25,000 lekë në muaj deri në lirimin e tokës nga HSH. Më datë 02.08.2012, me urdhrin nr. 917, të drejtorit të Njesisë së Biznesit të Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore, z. E.D ka filluar çmontimi i disa pajisjeve, por duke lënë pjesën më të madhe në objektin kryesor dhe duke e mbajtur të zënë pronën e sipërpërmendur.

Dëmi i shkaktuar shoqërisë nga veprimet ose mosveprimet e administratorëve të shoqërisë deri më 31.12.2017 është në vlerën 450,000 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10,296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 5

Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, të cilat vendosen, ruhen dhe përditësohen rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihen në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

1. Veprimtarive efektive, efçente dhe me ekonomi.
2. Pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat.
3. Informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota.

Ndikimi: Vlera 450,000 lekë përbën dëm ekonomik.

Shkaku: Mungesa e mos marrjes së veprimeve nga drejtuesit e shoqërisë.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandime: Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë të shqyrtojë vlerën 450,000 lekë, dëm ekonomik nga mosveprimet e drejtimit të shoqërisë dhe të nxjerrë përgjegjësit lidhur me këtë vlerë.

Nga auditimi i veprimeve të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës, konstatojmë se ato janë evidentuar e kontabilizuar në ditarët përkatës rregullisht dhe në mënyrë kronologjike, dhe sipas kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Dokumentacioni i veprimeve të hyrjes dhe daljes së vlerave monetare nga arka, shoqërohej me dokumentacion justifikues për çdo veprim të kryer. Veprimet ruanin renditjen e kronologjinë, si dhe janë kryer kontrollet periodike mujore për gjendjen e arkës. Veprimet nëpërmjet arkës në këtë shoqëri janë të kufizuara.

Për veprimet e kryera në lekë dhe në valutë nëpërmjet bankës, gjendja e aktiveve është paraqitur me vlerë të drejtë. Kontabilizimet janë kryer rregullisht dhe të regjistruara kronologjikisht në ditarët përkatës. Nëpërmjet llogarive bankare në lekë, janë kryer shumica e transaksioneve financiare si për detyrimet ndaj shtetit, si për tatim fitimin, tatim page, tvsh, detyrimet për sigurimet shoqërore, për shpenzime të ndryshme, etj.

Pjesa më e madhe e llogarive është e bllokuar nga vendimet e përmbauesve për detyrime të palikujduara nga ana e shoqërisë.

Me urdhrin nr. 91/14, datë 23.02.2015, ish-administratori z. G.A ka ngritur komisionin për prokurimin e blerjeve me vlerë të vogël me anëtarë znj. L.D, znj. N.P dhe znj. E.K. Me urdhërin nr. 65/1, datë 19.01.2016, ish-administratori z. G.A ka ngritur komisionin për prokurimin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

blerjeve me vlerë të vogël me anëtarë znj. L.D, znj. N.P dhe znj. E.K. Me urdhërin nr. 49/2, datë 24.01.2017, ish-administratori z. I.D ka ngritur komisionin për prokurimin e blerjeve me vlerë të vogël me anëtarë znj. L.D, znj. N.P dhe znj. E.K.

Pagesat me bankë

Në pagesat e kryera nga shoqëria gjatë viteve 2015, 2016, 2017 u konstatuan likuidime kryer për faturat e shërbimit të ruajtjes së stacionit hekurudhor Prrenjës nga shoqëria “M.” sh.r.s.f.

Në zërin shërbime ruajtje objektësh në vitin 2015 janë kontabilizuar faturat nr. 11,18,23,24,25 me vlerë totale 5,349,564 lekë, të cilat i përkasin shërbimeve të kryera në vitet 2013 e 2014, në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 1 i cili jep kuadrin e përgjithshëm të përgatitjes së pasqyrave financiare, pika 28 e cila citon *“Shpenzimet njihen në të njëjtën periudhë kontabël, si dhe të ardhurat e lidhura me to. Shpenzimet që lidhen me përfitime ekonomike, të cilat gjenerohen gjatë periudhës kontabël aktuale ose ato që nuk gjenerojnë përfitime ekonomike (të tilla si kostoja e shitjes së një investimi afatgjatë) njihen si shpenzim në periudhën kur ato ndodhin.”*

Gjithashtu këto regjistrime janë bërë në kundërshtim me ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” Nr. 9920, datë 19.5.2008 neni 51

“Lëshimi i faturës tatimore, 1. Shitësi lëshon faturë tatimore dhe blerësi duhet ta kërkojë atë në kohën e realizimit të shitjes apo të kryerjes së punimit ose shërbimit. Fatura tatimore përgatitet nga shitësi në jo më pak se dy kopje, nga të cilat një të merr dhe e ruan blerësi, kurse tjetrën e mban dhe e ruan shitësi. Faturat përgatiten me numër rendor progresiv si dhe në kundërshtim me nenin 101, përmbajtja e faturës i cili citon “Fatura e lëshuar përpilohet në formën e caktuar nga Ministri i Financave dhe përmban informacionin e mëposhtëm: a) datën e lëshimit të faturës; e) sasinë dhe përshkrimin e mallrave të shitura dhe përshkrimin e shërbimeve të kryera; ë) datën, në të cilën furnizimi i mallrave ose shërbimeve është kryer ose datën, në të cilën pagesa është kryer, në përputhje me shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 97, të këtij ligji, në qoftë se kjo datë është e ndryshme nga data e lëshimit të faturës;”

Në faturat e mësipërme nuk është përshkruar data në të cilën furnizimi i shërbimit është kryer dhe se ku është kryer.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 36.

“Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative.”

Ligji Nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 4, përkufizime, pika 26. *“Dokument financiar” është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë "Hekurudha Shqiptare" SHA Durrës

të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative.

Në lidhje me kontratat e lidhura me shoqërinë për kryerjen e shërbimit u konstatua se është proceduar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, pasi nga viti 2008 janë lidhur kontrata shtesë furnizimi për shërbimin e "Ruajtjes me Sh.r.s.f. të stacionit hekurudhor, Përrenjas. Më 29.08.2008 për arsye se procedura e tenderit është zgjatur tej afateve të parashikuar u krye procedura me negociim pa shpallje me fitues me ofertën më të ulët shoqërinë "M." sh.r.s.f. Më 01.12.2008 kryetari i autoritetit kontraktor B.D ka lidhur një kontratë shtesë furnizimi me afat 3 mujor me vlerë jo më të madhe se 20% të kontratës fillestare. Shoqëria "Hekurudha Shqiptare" SHA, ka vazhduar me shtesa kontratash duke tejkalluar 20 % të kontratës fillestare, deri në vitin 2015, në kryerjen e procedurave të prokurimit për kryerjen e shërbimit të ruajtjes.

Shtesat e kontratave për periudhën 2014, 2015 janë firmosur nga drejtuesi i njësisë së biznesit, menaxhimit të infrastrukturës hekurudhore, z. E.D.

Vlera **5,349,564 lekë përbën dëm ekonomik** për shoqërinë Hekurudha Shqiptare SHA.

Për sa më sipër mban përgjegjësi ish drejtuesi z. E.D dhe shefja e financës znj. M.S.

Në pagesat e kryera nga shoqëria në periudhën 2015 u konstatuan likuidime kryer për faturat e shërbimit të ruajtjes shoqëria "Th." sh.r.s.f., në vlerën 5,000,000 lekë.

Marëdhënia me shoqërinë "Th." sh.r.s.f., është vazhduar me kontratën e lidhur më datë 04.09.2009 e cila ka pasur si kohë përfundimi deri në momentin e nënshkrimit të kontratës së fituesit që do të zgjidhej nga procedura pasardhëse e prokurimit. Nga Njësia e Biznesit Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore, janë bërë kërkesa ndaj sektorit të prokurimeve për fillimin e procedurave të prokurimit por që nuk janë realizuar për mungesë fondesh nga ky sektor.

Me urdhrin nr. 46/30, datë 05.05.2015, ish-administratori i shoqërisë z. G.A, ka urdhëruar kalimin e fondit prej 5,000,000 lekë për likuidimet ndaj shoqërisë "Th." sh.r.s.f., për faturën nr. 36, datë 28.12.2012 me vlerë 806,900 lekë, faturën nr. 45, datë 31.01.2013 me vlerë 806,880 lekë, faturën nr. 14, datë 28.02.2013 me vlerë 806,880 lekë, faturën nr. 19, datë 31.03.2013 me vlerë 806,880 lekë, faturën nr. 26, datë 30.04.2013 me vlerë 806,880 lekë, faturën nr. 32, datë 31.05.2013 me vlerë 806,800 lekë. Në faturat e mësipërme mungonte firma e blerësit, proces verbalet e kryerjes së shërbimit, dy nga faturat ishin kopje, si dhe nuk është përshkruar vendi ku është kryer shërbimi.

Likuidimi është kryer në kushtet kur faturat tatimore nuk janë firmosur nga asnjë përfaqësues i HSH, si dhe nuk ka proces verbal nga përgjegjësit e stacioneve për kryerjen e shërbimit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 36.

"Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative."

Ligji Nr.10 296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Neni 4, përkufizime, pika 26. "Dokument financiar" është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative.

Vlera 5,000,000 lekë përbën dëm ekonomik pasi pagesa nuk është e shoqëruar me dokumentacionin justifikues përkatës.

Veprimet janë kryer nga ish-administratori z. G.A. Përgjegjësi mban shefi i financës znj. M.S, që nuk kanë verifikuar dokumentet mbështetëse.

Me urdhrin nr. 36/20, datë 22.09.2017, dhe duke firmosur urdhër transfertën në llogarinë e Bankës Amerikane të Investimeve, ish-administratori i shoqërisë z. I.D, ka urdhëruar kalimin e fondit prej 3,873,570 lekë për likuidimet ndaj shoqërisë “H., (Th.)” sh.r.s.f., për faturën nr. 34 datë 29.09.2015 me vlerë 557,484 lekë, faturën nr. 32, datë 31.08.2015 me vlerë 557,484, faturën nr. 31, datë 31.07.2015 me vlerë 557,484 lekë, faturën nr. 30, datë 30.06.2015 me vlerë 557,484 lekë, faturën nr. 29, datë 29.05.2015 me vlerë 557,484 lekë, faturën nr. 28, datë 30.04.2015 me vlerë 557,484 lekë dhe faturën nr. 26, datë 31.03.2015 me vlerë 557,484 lekë.

Në faturat e mësipërme mungonte firma e blerësit, proces verbalet e kryerjes së shërbimit, si dhe nuk është përshkruar vendi ku është kryer shërbimi.

Likuidimi është kryer në kushtet kur faturat tatimore nuk janë firmosur nga asnjë përfaqësues i HSH, si dhe nuk ka proces verbal nga përgjegjësit e stacioneve për kryerjen e shërbimit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10,296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 36.

“Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative.”

Ligji Nr.10 296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Neni 4, përkufizime, pika 26. *“Dokument financiar” është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative.*

Vlera 3,873,570 lekë përbën dëm ekonomik pasi pagesa nuk është e shoqëruar me dokumentacionin justifikues përkatës.

Përgjegjësi mbajnë ish-administratori z. I.D dhe shefi i financës znj. M.S, që nuk kanë verifikuar dokumentet mbështetëse.

Drejtuuesi i njësisë z. E.D ka njoftuar ish administratoren e shoqërisë z. G.A në lidhje me problematika për moszbatimin me rigorozitet të kontratës me kompaninë “Th.” sh.r.s.f, me shpresën me datë 17.02.2015.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

Shoqëria ka urdhër për vënien e sekuestros konservative për vlerën 2,086,183 lekë, për llogari të kreditorit z. B.H, Librazhd. Detyrimi ka ardhur nga kontrata e lidhur mes palëve më datë 05.01.2011 për dhënien me qera të një sipërfaqe tokë prej 200 m², në Librazhd, Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudhave për montimin e pajisjeve të radiondërlidhjes që i shërbejnë hekurudhës shqiptare të përfituara si grant nga kompania GE Harris Harmon. Për 3 muajt e parë qiraja prej 40,000 lekë është paguar nga HSH dhe më pas nuk është paguar më. Pas kërkesave të shumta nga z. B.H, çështja është gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila ka vendosur më 02.06.2016 pagesën e prapambetur deri me 01.02.2016 si dhe shumën prej 25,000 lekë në muaj deri në lirim të tokës nga HSH. Më datë 02.08.2012, me urdhërin nr. 917, të drejtorit të Njesisë së Biznesit të Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore, z. E.D ka filluar çmontimi i disa pajisjeve, por duke lënë pjesën më të madhe në objektin kryesor dhe duke e mbajtur të zënë pronën e sipërpërmendur.

Pretendimet nga ish administratori i shoqërisë z. G.A, në lidhje me mospagesën e qerasë ishin se meqenëse kontrata mbaronte më 31.12.2011 dhe ishte pa të drejtë rinovimi duke mos njohur detyrimet jashtë kontraktore si dhe HSH megjithëse e pranon se e ka zënë truallin pronarit z. B.H nuk e përdorur sipas objektit të kontratës.

Situata nuk ka ndryshuar dhe me emërimin e administratorit z. I.D, i cili nuk ka marrë asnjë veprim për zgjidhjen e situatës.

Dëmi i shkaktuar shoqërisë nga veprimet ose mosveprimet e administratorëve të shoqërisë deri më 31.12.2017 është në vlerën 450,000 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 5:

Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, të cilat vendosen, ruhen dhe përditësohen rregullisht nga titullari i njesisë publike dhe vihen në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njesisë publike do të arrihen nëpërmjet:

1. Veprimtarive efektive, eficiente dhe me ekonomi.
2. Pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme të kontratat.
3. Informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota.

IV. 6. Mbajtja e evidencës kontabile në qendër dhe në njësitë e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit.

U auditua dokumentacioni si më poshtë:

Dokumentacioni i pasqyrave financiare.

Dokumentacioni i regjistrimit të llogarive kontabël.

Dokumentacioni mbi hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare.

Dokumentacioni i mbajtur mbi përlllogaritjen, njohjen, pagesën dhe regjistrimin e detyrimeve fiskale.

Dokumentacioni i mbajtur mbi debitorët dhe kreditorët.



Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Titulli i Gjetjes: Mos plotësimi i regjistrit të aktiveve që ka në pronësi apo posedim.

Situata: Hekurudha Shqiptare ShA, Durrës nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim, me kërkesat minimale që duhet të përmbajë ky regjistër.

Kriteri: Këto veprime janë bërë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 30, ku përcaktohet:

“Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjate apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbaje regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia”.

Ndikimi: Rritje e rrishtit për shpërdorime materiale të pasurisë së shoqërisë, si humbje, vjedhje, shkatërrime.

Shkaku: Mungesa e menaxhimit të riskut lidhur me aktivitetet.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandime: Shoqëria duhet të marrë masa për plotësimin e regjistrit të aktiveve, si një pjesë e rëndësishme e menaxhimit të aktiveve.

Titulli i Gjetjes: Mos përdorimi i programeve kompjuterike për mbajtjen e kontabilitetit dhe pasqyrave financiare.

Situata: Hekurudha Shqiptare SHA, Durrës nuk përdor programe kompjuterike për mbajtjen e kontabilitetit por mbështetet në formën shkresore.

Kriteri: Mbajtja në mënyrë elektronike e kontabilitetit përmirëson efikasitetin në përgatitjen e pasqyrave financiare të shoqërisë si dhe forcon kontrollin e brendshëm.

Ndikimi: Rritje e rrishtit për gabime materiale në mbajtjen e kontabilitetit si dhe vështirëson kontrollin e brendshëm.

Shkaku: Mungesa e menaxhimit të riskut lidhur me mbajtjen e kontabilitetit.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandime: Shoqëria duhet të marrë masa për mbajtjen e kontabilitetit me programet përkatëse kompjuterike.

Titulli i Gjetjes: Mos kryerja e testit të zhvlerësimit për inventarët.

Situata: Hekurudha Shqiptare SHA, Durrës ka në llogarinë e inventarit vlerën totale prej 251,716,383 lekë, që përbëhet nga lëndët e para me vlerë 196,051,555 lekë, inventari i imët në vlerën 6,471,892 lekë, prodhim në proces në vlerën 7,252,678 lekë, e produkte të gatshme në vlerën 41,940,258 lekë. Shoqëria nuk ka kryer ndonjë vlerësim për të evidentuar ndonjë diferencë të mundshme në vlerën e inventarit.

Kriteri: Këto veprime janë bërë në kundërshtim Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 4, "inventarët", ku përcaktohet:

“...inventarët duhet të nënshtrohen testit të zhvlerësimit në datën e mbylljes së bilancit për përcaktimin e vlerës më të ulët mes kostos dhe vlerës neto të realizueshme”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

Ndikimi: Rritje e riskut për mbajtje vlerash në inventarët, të pasakta dhe jo reale.

Shkaku: Mungesa e mos kryerjes së procedurave të zhvlerësimit.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandime: Shoqëria duhet të marrë masa për kryerjen e zhvlerësimit të inventarit.

Titulli i Gjetjes: Mos njohja e tatimeve të shtyra për aktivet materiale të rivlerësuara

Situata: Shoqëria ka kryer rivlerësimin e aktiveve afatgjata materiale me gjendjen e datës 31.12.2013, e miratuar nga MZHETS me shkresë nr.8504/3 dt.17.02.2015, në zbatim të së cilës janë kryer veprimet në kontabilitet në periudhën e vitit 2014 me urdhër të administratorit të shoqërisë me nr. 220/1 dt.24.03.2015. Shoqëria nuk ka njohur tatime të shtyra për këto aktive materiale të rivlerësuara.

Kriteri: Këto veprime janë bërë në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 11, pika, 19, diferencat e përkohshme ku përcaktohet:

“Diferencat e përkohshme lindin: (b) aktivet rivlerësohen ndërkohë që baza tatimore e tyre nuk ndryshon ”.

Ndikimi: Rritje e riskut për mosparaqitjen e saktë të pasqyrave financiare.

Shkaku: Mungesa e aplikimit të standardit.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandime: Shoqëria duhet të marrë masa për njohjen e tatimeve të shtyra për aktivet afatgjata materiale të rivlerësuara.

Titulli i Gjetjes: Mos llogaritja e provizioneve për interesa të detyrimeve ndaj hekurudhave të huaja

Situata: Detyrimi ndaj Hekurudhave të huaja (të vjetra “deri në vitin 1990-92”) është në vlerën 841,179,000 lekë. Nga ana e ketyre hekurudhave “sidomos ato ish Jugosllave” janë kërkuar disa herë likuidimi i detyrimeve, duke përfshirë dhe interesa. Nga ana e shoqërisë nuk janë llogaritur interesa ndër vite për këto detyrime afatgjata.

Kriteri: Këto veprime janë bërë në kundërshtim me Standardin kombëtar të kontabilitetit nr. 3, të përmirësuar, Instrumentat financiare, pika 14, ku përcaktohet:

“1. Për një hua të marrë nga një bankë, njihet një llogari e pagueshme fillimisht me vlerën aktuale të mjeteve monetare të pagueshme ndaj bankës (psh duke përfshirë pagesat e interesit dhe të principalit)”.

Ndikimi: Rritje e riskut për mosparaqitjen e sakte të pasqyrave financiare.

Shkaku: Mungesa e aplikimit të standardit.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandime: Shoqëria duhet të marrë masa për llogaritjen e interesave për detyrimet afatgjata ndaj hekurudhave të tjera dhe ti paraqesë në llogaritë përkatëse në pasqyrat financiare.

Titulli i Gjetjes: Mos klasifikime të sakta për inventarët e shoqërisë.

Situata: Në zërin e inventarëve shoqëria ka klasifikuar lëndë e parë dhe materjale të konsumueshme në vlerën 215,545,720 lekë, prodhime në proces dhe gjysmë produkte 5,599,507 lekë dhe 5,850,012 lekë si dhe produkte të gatshme në vlerën 52,478,637 lekë. Pjesa e produkteve të gatshëm janë pjesë këmbimi që prodhohen për mjetet lokomotiva e vagonë por jo për tu shitur tek të tretët. Ky klasifikim është në kundërshtim me SKK nr. 4, pika 7, ku citohet:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

“ Inventarët e njësive prodhuese përbëhen nga lëndët e para dhe materialet për konsum, puna në proces dhe produktet e përfunduara gati për shitje, mallrat e blera dhe të mbajtura për rishitje me pak ose aspak nevojë për ndryshim, që janë inventarë tipike për njësitë tregtare. Pronat e paluajtshme të blera për rishitje duhet të njihen si inventar, ndërsa ato të blera për përdorim në procesin e prodhimit ose për qëllime administrative, duhet të njihen si aktive afatgjata materiale”.

Ndikimi: Rritje e riskut për mosparaqitjen e saktë të pasqyrave financiare.

Shkaku: Mungesa e aplikimit të standardit.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandime: Shoqëria duhet të marrë masa për paraqitjen në llogaritë përkatëse të pasqyrave financiare të inventarit të saj.

Titulli i Gjetjes: Mos kryerja e zhvlerësimit të llogarive të arkëtueshme.

Situata: Detyrimet e kontabilizuara me vlerë 92,473,000 lekë përfaqësojnë debitorë me konflikt prej disa vitesh, ku mundësia e arketimit të kësaj vlere, me përbërje 47 subjekte është e ulët. Vlera prej 21,836,000 lekë e vlerësuar nga Njësia e Mjeteve dhe e Infrastrukturës përbëhet nga vlerat e dëmtimeve të ndryshme në objektet e shoqërisë nga viti 2006-2015, për të cilat janë kryer denoncimet në organet përkatëse, por që janë kontabilizuar si detyrime të arkëtueshme. Nga shoqëria nuk janë analizuar llogaria e kërkesave të arkëtueshme.

Në zërin e kërkesave për arkëtim përfshihen kërkesa për TVSH të zbritshme në shumën 174,748,000 lekë. Në këtë shumë përfshihet TVSH e konsideruar si e pa zbritshme nga ana e kontroleve tatimore për shumën 63,083,000 lekë e cila i përket periudhave 2014 dhe 2015. Nga kontrollat tatimore të ushtruara nga dega tatimeve në vitet 2010, 2012 dhe 2015 shoqërisë i janë ngarkuar penalitete në vlerën 81,955,000 lekë për të paguar. Këto penalitete janë apeluar nga shoqëria dhe pasi e ka humbur çështjen në gjykatë e ka fituar në Drejtorinë e Apelitit Tatimor duke shfuqizuar plotësisht aktin administrativ të Njoftim Vlerësimit nr. 21104/4 dt. 12.01.2016 me shkresën 3964/4 dt. 16.05.2016. Shoqëria është në proces gjyqësor për çështjet e mësipërme dhe është në pritje të zhvillimit të gjykimit.

Për sa më sipër shoqëria nuk ka krijuar ndonjë zhvlerësim për shumën e TVSh-së së zbritshme të panjohur për rimbursim për vlerën 63,083,000 lekë si dhe nuk ka krijuar provizione për shpenzimet për gjoba të vendosura nga aktet e kontrollit 2010, 2012, e 2015 në shumën 81,955,000 lekë.

Kriteri: Këto veprime janë bërë në kundërshtim me standardin kombëtar të kontabilitetit nr. 3, Instrumentet financiare, pika 22, ku përcaktohet:

“Në fund të çdo periudhe raportimi, një njësi duhet të vlerësojë nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktivi financiar që matet me kosto ose me kosto të amortizuara. Nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit, njësi duhet të njohë menjëherë një humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje”.

Ndikimi: Rritje e riskut për mosparaqitjen e saktë të pasqyrave financiare.

Shkaku: Mungesa e aplikimit të standardit.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandime: Shoqëria duhet të marrë masa për kryerjen e procesit të zhvlerësimit të llogarive të arkëtueshme duke kryer veprimet e dhura kontabël.



Titulli i Gjetjes: Mos paraqitja e saktë e granteve.

Situata: Shoqëria ka paraqitur në klasën grante dhe të ardhura të shtyra afatshkurtra në vlerën 567,375,000 lekë, të cilat lidhen me grante të marra për aktive afatgjata.

Kriteri: Këto veprime janë bërë në kundërshtim me standardin kombëtar të kontabilitetit nr.10, Grantet dhe format e tjera të ndihmës.

Ndikimi: Rritje e riskut për mosparaqitjen e saktë të pasqyrave financiare.

Shkaku: Mungesa e aplikimit të standardit.

Rëndësia: E ulët

Rekomandime: Shoqëria duhet të marrë masa për pasqyrimin e granteve sipas standardeve në fuqi.

Titulli i Gjetjes: Mos llogaritja e provizioneve për interesa dhe principale të huave të shoqërisë

Situata: Në lidhje me kredinë italiane shoqëria dispononte planin e amortizimit të kredisë si dhe ka marrë njoftime periodike nga BKT që funksionon si bankë ndërmjetëse në lidhje me detyrimet, por megjithëse nuk ka paguar këstet e principalit dhe interesat duhet të krijonte një llogari provizionit për këto këste dhe interesa të cilat janë paguar nga llogaria e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Vlera e cila llogaritet deri në fund të periudhës ushtrimore 2017 është 1,746,915 Euro ose në vlerën 232,252,349 lekë.

Situata e vështirë ekonomike e shoqërisë është thelluar akoma më shumë në vitet e fundit duke e bërë të pamundur kthimin e detyrimit duke lënë këtë barrë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Kriteri: Këto veprime janë bërë në kundërshtim me standardin kombëtar të kontabilitetit nr.3, të përmirësuar, Instrumentat financiare, pika 14, ku përcaktohet:

“1. Për një hua të marrë nga një bankë, njihet një llogari e pagueshme fillimisht me vlerën aktuale të mjeteve monetare të pagueshme ndaj bankës (psh duke përfshirë pagesat e interesit dhe të principalit)”.

Ndikimi: Rritje e riskut për mosparaqitjen e saktë të pasqyrave financiare dhe **vlera 1,746,915 Euro është efekt negativ për Buxhetin e Shtetit.**

Shkaku: Mungesa e aplikimit të standardit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandime: Shoqëria duhet të marrë masa për llogaritjen e interesave dhe principaleve për detyrimet afatgjata dhe ti paraqesë në llogaritë përkatëse në pasqyrat financiare si dhe të marrë masat për pagesën e tyre.

Titulli i Gjetjes: Mos llogaritja e të ardhurave nga grantet jo konform SKK nr.10

Situata: Në llogaritjen e të ardhurave nga grantet është bërë jo konform me SKK nr. 10 “Grantet dhe format e tjera të ndihmës”. Zëri kontabël i granteve për rimarrjen e të ardhurave është amortizuar me 10% jo duke i specifikuar amortizimin dhe konsumin respektiv të aktiveve të cilat i përkasin këto grante.

Kriteri: Këto veprime janë bërë në kundërshtim me standardin kombëtar të kontabilitetit nr.10, Grantet dhe format e tjera të ndihmës.

Ndikimi: Rritje e riskut për mosparaqitjen e saktë të pasqyrave financiare.

Shkaku: Mungesa e aplikimit të standardit.



Rëndësia: E mesme

Rekomandime: Shoqëria duhet të marrë masa për pasqyrimin e të ardhurave nga grantet sipas standardeve në fuqi.

Shoqëria “Hekurudha Shqiptare SHA, Durrës” është krijuar si shoqëri aksionare me urdhër të Ministrit të Ekonomisë dhe Privatizimit nr 15, date 15.11.2000 (MZHETS) , dhe regjistruar si person juridik në regjistrin tregtar me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr. 24830 datë 18.12.2000. Themelues i shoqërisë është aksionari i vetëm Ministria e Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Është regjistruar ne organin tatimor dhe mban NIPT-in J61811547D. Hekurudha Shqiptare SHA, ka organizuar kontabilitetin në zbatim të ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) të miratuara nga Ministri i Financave me Urdhrin nr. 4292, datë 15.06.2006, hyrë në fuqi me datën 1 janar 2008 dhe mbahet pjesërisht në formë shkresore dhe pjesërisht në mënyrë të informatizuar duke përdorur programin excel të Office.

Regjistrimet kontabël janë të bazuara në dokumentacionin bazë, i cili është i autorizuar dhe i aprovuar nga personat e ngarkuar, me autoritetin që kanë në përputhje me rregullin e brendshëm. Çdo departament përgatit pasqyrat përkatëse të cilat konsolidohen nga departamenti qendror.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Aktivet monetare përfaqësojnë parane në bankë dhe në arkë, të cilat janë vlerësuar dhe mbahen me vlerën e drejtë.

Regjistrimet e transaksioneve në monedhë të huaj, janë regjistruar në kontabilitet me kursin e datës së kryerjes së transaksionit.

Hekurudha Shqiptare SHA, Durrës operon me bankat: Raiffeisen Bank, Banka Credins, Banka Kombëtare Tregtare. Nga auditimi i kryer u konstatua se, për vitin 2014, të dhënat kontabël dhe pasqyrat financiare janë mbyllur në afat. Në datë 14.07.2015 me vendimin nr.7, Këshilli Mbikëqyrës pasi i shqyrtoi i miratoi pasqyrat financiare të vitit dhe me shkresën nr. 15, datë 14.07.2015, ka dërguar për miratim në MZHETTS pasqyrat financiare të vitit 2014. Me vendimin nr. 5776/1, datë 30.07.2015, ortaku i vetëm i përfaqësuar nga ministri z. Arben Ahmetaj, miratoi pasqyrat financiare dhe rezultatin e vitit 2015, humbjen në vlerën 644,194,850 lekë, për tu mbartur në rezultatin e vitit.

Ekspertët kontabël të autorizuar znj. I.H, z. T.Gj, z. B.O, z. S.T dhe z. H.C, të emëruar me vendimin nr. 637, datë 22.01.2015 nga asambleja e aksionerëve, për një periudhë 1-vjeçare.

Ekspertët kanë përgatitur dhe paraqitur para drejtimit të shoqërisë raportin mbi pasqyrat financiare.

Nga auditimi i kryer u konstatua se, për vitin 2015, të dhënat kontabël dhe pasqyrat financiare nuk janë përpiluar dhe dorëzuar në afatet ligjore në lidhje me vendim marrjen nga ana e ortakut të shoqërisë brenda 6 mujorit të parë.

Pasqyrat financiare janë dorëzuar në organet tatimore brenda afatit ligjor.

Më datë 05.09.2016, administratori i shoqërisë i ka dërguar Këshillit Mbikëqyrës për miratim pasqyrat financiare të periudhës ushtrimore si dhe raportin e ekspertëve kontabël të autorizuar.

Vonesa ka ardhur nga mos dorëzimi i raportit të ekspertëve kontabël të autorizuar.

Me datë 05.10.2016, me vendimin nr. 9, Këshilli Mbikëqyrës pasi i shqyrtoi i miratoi pasqyrat financiare të vitit dhe me shkresën nr.19/2, datë 07.10.2016, ka dërguar për miratim në MZHETTS pasqyrat financiare të vitit 2015.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë "Hekurudha Shqiptare" SHA Durrës

Me vendimin nr. 8051/1, datë 28.10.2016, ortaku i vetëm i përfaqësuar nga ministri znj. Milva Ekonomi, miratoi pasqyrat financiare dhe rezultatin e vitit 2015, humbjen në vlerën 712,696,612 lekë, për tu mbartur në rezultatin e vitit.

Për vonesat në deklarime në QKB nga shoqëria janë paguar 15,000 lekë penalitet.

Ky penalitet është mbajtur nga pagesat e kryera ndaj eksperteve kontabël.

Ekspertët kontabël të autorizuar znj. I.H, z. T.Gj, z. K.H, z. S.T, z. R.S dhe z. H.C, kanë përgatitur dhe paraqitur para drejtimit të shoqërisë raportin mbi pasqyrat financiare.

Nga auditimi i kryer u konstatua se, për vitin 2016, të dhënat kontabël dhe pasqyrat financiare janë përpiluar dhe dorëzuar në afatet ligjore.

Pasqyrat financiare janë dorëzuar në organet tatimore brenda afatit ligjor.

Më datë 14.07.2017, administratori i shoqërisë i ka dërguar Këshillit Mbikëqyrës për miratim pasqyrat financiare të periudhës ushtrimore si dhe raportin e ekspertëve kontabël të autorizuar.

Në datë 18.07.2017 me vendimin nr.9, Këshilli Mbikëqyrës pasi i shqyrtoi i miratoi pasqyrat financiare të vitit dhe me shkresën nr.13, datë 18.07.2017, ka dërguar për miratim në MZHETTS pasqyrat financiare të vitit 2016.

Me vendimin nr.6300/1, datë 26.07.2017, ortaku i vetëm i përfaqësuar nga ministri znj.Milva Ekonomi, miratoi pasqyrat financiare dhe rezultatin e vitit 2016, humbjen në vlerën 538,913,493 lekë, për tu mbartur në rezultatin e vitit.

Për vonesat në deklarime në QKB nga shoqëria janë paguar 15,000 lekë penalitet.

Ky penalitet është mbajtur nga pagesat e kryera ndaj eksperteve kontabël.

Ekspertët kontabël të autorizuar znj. S.T, z. I.C, z. L.F, z. S.T, znj. M.F dhe z. H.C, kanë përgatitur dhe paraqitur para drejtimit të shoqërisë raportin mbi pasqyrat financiare.

Për vitin 2014, Aktivet Monetare janë në shumën 18,153,024 lekë, të cilat përfaqësojnë në totalin e tyre vlerat e bankave dhe të arkës. Aktive të tjera afatshkurtëra janë në vlerën 258,882,248 lekë dhe përbëhen nga klientë në vlerën 21,625,917 lekë, kërkesa të tjera të arkëtueshme në vlerën 2,351,567 lekë, TVSH e rimbursueshme në vlerën 142,859,234 lekë, debitorë të tjerë në vlerën 92,045,530 lekë.

Vlera klientë 21,625,917 lekë përbëhet nga kërkesa të krijuara gjatë periudhës 2014 si shoqëria 16 February sh.p.k. 3,398,556 lekë, Pansped 80,952 lekë, ESSen shpk 5,225,682 lekë, K. shpk, Elbasan, 12,991,549 lekë.

Vlera 92,045,530 lekë përfaqëson debitorë me të cilët HSH është në marrëdhënie gjyqësore, por me mundësi arkëtimi të ulët.

Vlera 142,859,234 lekë tvsh kreditore ka ardhur në rritje nga periudha e mëparshme me shumën 23,987,431 lekë.

Në pasqyrat financiare është dhe vlera 735,794,683 lekë e cila përfaqëson detyrime të arkëtueshme që janë provizionuar dhe që shoqërohen dhe me vlerën negative të tyre. Dhe këto detyrime janë pa shpresë arkëtimi.

Llogaria e inventarit në vlerën totale prej 251,716,383 lekë përbëhet nga lëndët e para me vlerë 196,051,555 lekë, inventari i imët në vlerën 6,471,892 lekë, prodhim në proces në vlerën 7,252,678 lekë, e produkte të gatshme në vlerën 41,940,258 lekë.

-Standardi Kombëtar i Kontabilitetit nr. 4, "Inventarët" kërkon që inventarët duhet ti nënshtrohen testit të zhvlerësimit në datën e mbylljes së bilancit për përcaktimin e vlerës më të ulët mes kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Shoqëria nuk ka kryer ndonjë vlerësim për të evidentuar ndonjë diferencë të mundshme në vlerën e inventarit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

Në 000/lekë

	Toka (Trualli)	Ndërtesa dhe instalime	Makineri	Mjete Transporti	Pajisje dhe informatikë	TOTAL
AAM Vlera Bruto						
Gjendje 01.01.2014	43.620.810	87.960.537	878.540	4.612.529	38.326	137.110.742
Shtesa		35,971	0	0	1,949	37,920
Shtesa (rivlersimi)		448	24,114	38,674		63,236
Pakësime		-0	-243	-0	-1217	-1460
Pakësime(rivlersimi)		-34,278,305	-0	-0	-35	-34,278,340
Gjendje 31.12.2014	43.620.810	53.718.651	902.411	4.651.203	39.023	102.932.098
Zhvlersimi akumuluar						
Gjendje 01.01.2014	0	26.508.790	496.765	3.349.184	20.949	30.375.688
Shtesa (amort.2014)		446,281	18,307	83,398	1,277	549,263
Shtesa (tjera)		13,893	0	421	911	15,225
Pakësime		-0	-0	-0	-603	-603
Pakësime(rivlersimi)		-14,376,116	-72,508	-766,553	-358	-15,215,535
Gjendje 31.12.2014	0	12.592.848	442.564	2.666.450	22.176	15.724.038
Gjendje 01.01.2014	43,620,810	61,451,746	381,775	1,263,345	17,378	106,735,054
Gjendje 31.12.2014	43,620,810	41,125,803	459,847	1,984,753	16,847	87,208,060

AAM janë njohur në kontabilitet me koston e blerjes së tyre dhe shoqëria ka zgjedhur si politike të saj kontabile modelin e koston ku çdo element i AAM paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar, si dhe nuk janë llogaritur humbje nga zhvlerësimi. Normat e amortizimit të zbatuara janë ato të përcaktuara në vendimin e Drejtorisë së Shoqërisë (nr.24 dt.18.12.2006) dhe jo normat fiskale të përcaktuara në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat".

Shoqëria ka kryer rivlerësimin e aktiveve afatgjata materiale me gjendjen e datës 31.12.2013, i cili është miratuar nga ana e MZHETS me shkresë nr. 8504/3 dt.17.02.2015, në zbatim të së cilës janë kryer veprimet në kontabilitet në periudhën e vitit 2014 me urdhër të administratorit të shoqërisë me nr.220/1 datë 24.03.2015.

-Standardi Kombëtar i Kontabilitetit “Tatimi mbi fitimin”, kërkon që shoqëria të njohë tatime të shtyra për diferencat midis vlerës kontabël neto të aktiveve afatgjata materiale të rivlerësuar dhe bazës tatimore. Shoqëria nuk i ka kryer këto veprime.

Lëvizjet në vlerë të AAM përbëhen:

Zëri kontabël 211, nuk ka lëvizje për vitin ushtrimor 2014. Zëri kontabël 212, ka shtesa në vlerën 36,419 mijë lekë, e cila përbëhet nga: blerje të reja me fondet e investimeve 35,728 mijë lekë (riaktivizimi i Stacionit Kashar me 19,871 mijë lekë, riaktivizim traseje 5,195 mijë leke,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

rikonstruksioni i godinës HSH qender në vlerën 3,065 mijë lekë, riaktivizimi i stacionit hekurudhor Vidhas me 1,858 mijë lekë, rikonstruksioni i stacionit hekurudhor Bajzë me 2,703 mijë lekë ”Nj.BMIH”, dhe ndërtim reparti vagona me 3,036 mijë lekë “Nj.SHML”).

Vlera për 448 mijë lekë përfaqëson shtesë nga rivlersimi i aseteve (Nj.SHML), dhe 243 mijë lekë është sistemim i bërë nga Nj.BMIH me llogarinë 213.

Pakësimet në këtë llogari janë me vlerë 34,278,305 mijë lekë, e cila përfaqëson pakësim nga rivlersimi i aseteve (HSH qendër 952 mijë lekë, Nj.SHML me 111,091 mijë lekë, Nj.BMIH me 34,166,262 mijë lekë).

Zëri kontabël 213, ka shtesë me vlerë 24,114 mijë lekë e cila përbëhet vetëm nga shtesa e rivlersimit të aseteve (Nj.SHML me 2,480 mijë lekë dhe Nj.BMIH me 21,634 mijë lekë).

Pakësimi me vlerë 243 mijë lekë përfaqëson sistemim i bërë nga Nj.BMIH (me llogarinë 212). Llog. 215, për vitin ushtrimore 2014 ka vetëm shtesë me vlerë 38,674 mijë lekë e cila ka ardhur nga rivlersimi i aseteve (Nj.BU me 6,090 mijë lekë dhe Nj.BM me 32,584 mijë lekë).

Zëri kontabël 218, shtesa me vlerë 605 mijë lekë, përbëhet nga: blerje të reja 560 mijë lekë blerje dhe 45 mijë lekë dhuratë HSH qendër 552 mijë lekë.

Furnitorët

Më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 gjendja e furnitorëve të Shoqërisë (HSH) paraqitet si më poshtë :

	Në 000/lekë	
	31/12/2014	31/12/2013
Furnitorë	396,217	349,105
Furnitorë ndaj Hekurudhave të shteteve të tjera	841,179	743,578
Total	1,237,396	1,092,683

Furnitorët paraqiten në mënyrë analitike dhe kapin vlerën 396,217 mijë lekë si detyrime për blerje dhe shërbime (roje private) që shoqëria ka bërë për ushtrimin e aktivitetit të saj.

Detyrimet ndaj hekurudhave të huaja për orë-qëndrimet e vagonëve të mallit në territorin shqiptar janë në vlerën 192,000 mijë lekë (1,370,058 Euro) nga 175,592 mijë lekë (1,252,436 Euro) që kanë qenë në vitin 2013, detyrimet për rojet private janë 134,745 mijë lekë nga 109,266 mijë lekë që ishin në vitin 2013, detyrimi për gazoilin e blerë është 33,490 mijë lekë nga 27,200 mijë lekë që ishte në vitin 2013, materiale për aktivitetin e HSH-së 35,982 mijë lekë nga 54,698 mijë lekë që kanë qenë në vitin ushtrimore 2013. Detyrimet ndaj hekurudhave të huaja për orë qëndrimet e vagonëve i përkasin periudhave, viti 2009 me 210.1 mijë euro, viti 2010 me 371.3 mijë euro, viti 2011 me 301.4 mijë euro, viti 2012 me 204.2 mijë euro, viti 2013 me 165.3 mijë euro dhe për vitin 2014 me 117,622 euro. Detyrimet për roje private i përkasin periudhës 2013-2014, ndërsa detyrimet për gazoilin e blerë dhe të tjera detyrime i përkasin periudhës së vitit 2014.

Detyrimi ndaj Hekurudhave të huaja (të vjetra “deri në vitin 1990-92”) në vlerën 841,179 mijë lekë e cila është e analizuar si më poshtë, në USD dhe në Lekë

Emri i furnitorit

Valuta Usd

Kursi 31.12.2014

në (000/lekë)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

Hekurudha Jugosllave.....	6,866,478	115.23	791,224
Hekurudha Ceke.....	51,341	115.23	5,916
Hekurudha Rumune.....	81,653	115.23	9,409
Riparim Vagona.....	300,528	115.23	34,630
Totali.....	7.300.000.....		841,179

Këto detyrime paraqiten si huamarrje të tjera afatgjata dhe janë të rivlersuara me kursin e datës 31.12.2014 dhe diferencat kanë kaluar në diferenca konvertimi, duke rrespektuar kërkesat e standarteve për këto veprime. Nga ana e ketyre hekurudhave “sidomos ato ish Jugosllave” janë kërkuar disa herë likuidimi i detyrimeve, duke përfshire dhe interesa.

Hekurudha Shqiptare sha Durrës nuk disponon dokumenta ligjorë, për ndarjen e detyrimeve të ish hekurudhës Jugosllave sipas shteteve që ajo është ndarë.

Nga ana e shoqërisë nuk janë llogaritur interesa ndër vite për këto detyrime afatgjata.

Grantë dhe të ardhura të shtyra

Më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 gjendja e granteve dhe të ardhurave të shtyra është si më poshtë :

	Në 000/lekë	
	31/12/2014	31/12/2013
Grante	590,720	614,597
Interesa pasive të llogaritura	0	0
Të ardhura të periudhave të ardhme	0	0
Total	590,720	614,597

Të Ardhura dhe Shpenzime

Më 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 të ardhurat dhe shpenzimet e Shoqërisë paraqiten si më poshtë:

Shitjet

	01/01/2014 - 31/12/2014	01/01/2013 - 31/12/2013
Shitje produktesh (703)	23	74,324
Shitje e punimeve dhe shërbimeve	280,131	167,734
Totali i shitjeve	280,154	242,058

Shpenzime të tjera

Në 000/lekë

	01/01/2014 - 31/12/2014	01/01/2013 - 31/12/2013
Energji, avull, ujë	7,007	6,531
Blerje të pastokueshme, materiale, furnitura	1	12
Trajtime të pergjithshme	54,693	68,001
Qera repetitor		
Mirembajtje dhe riparime	518	418
Sigurime	993	1,201
Përsoneel nga jashtë	23.005	14.635



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

Publicitet, reklame	6	6
Transferime, udhëtime, dieta	8,325	8,253
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	1,154	1,267
Shpenzime transporti	24,965	23,725
Shpenzime për shërbimet bankare	165	122
Subvencione të dhena*		
Shpenzime për pritje dhe përfaqsimi **	0	0
Gjoha dhe dëmshperbilime	33,048	1,664
Shpenzime të tjera	391	219,275
Total i Shpenzime të tjera	154,270	345,110

Kosto e Punës

	Në 000/lekë	
	01/01/2014 - 31/12/2014	01/01/2013 - 31/12/2013
Paga bruto dhe rrogë (ëages)	361,899	389,561
Kontribut sigurime shoqërore për punëtorët	60,373	64,927
Total	422,272	454,488
Kosto stafi të tjera	3,105	1,185
Total i Kostos e Punës	425,377	455,673

Amortizimet dhe zhvlerësimet

Normat e amortizimit të zbatuara janë ato të përcaktuara në vendimin e Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë (nr.24 dt.18.12.2006) dhe jo normat fiskale të përcaktuara në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat". Shoqëria në vitin 2006 ka bërë rivlerësimin e AAM të shoqërisë, ku diferencat e rivlerësimit janë përfshirë në kontabilitet “PF te vitit 2007”, gjatë këtij viti shoqëria nuk ka marrë asnjë rivlerësim të aktiveve ose përkeqësim të tyre.

	Në 000/lekë	
	01/01/2014 - 31/12/2014	01/01/2013 - 31/12/2013
Amortizimi i aktiveve afatgjata (681)	549,262	228,811
Total i Amortizimeve dhe zhvlerësimet	549,262	228,811

Nga llogaritja e diferencave të këmbimit të fund vitit shoqëria ka pasur humbje në vlerën 131.053.140 lekë.

Të ardhura dhe shpenzimet

Në lekë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë "Hekurudha Shqiptare" SHA Durrës

PËRSHKRIMI	2014	2013	DIFERENCA
TË ARDHURAT NË TOTAL	846.220.276	842.734.129	3.486.147
SHPENZIME NË TOTAL	1.490.415.126	1.036.416.001	453.999.125
REZUTTATI "HUMBJE"	(644.194.850)	(193.681.872)	(450.512.978)
A-Të ardhurat rezultojnë nga ;			-
Llog.7041 "Transporti Mallrave"	269.424.071	153.155.854	116.268.217
Llog.7042 "Transporti Udhëtarëve"	10.707.390	14.534.916	(3.827.526)
Llog.7043 "Ngarkim-shkarim"	-	-	-
Llog.705 "Shitje skrapit hekurudhor"	-	74.323.916	(74.323.916)
Llog.705-1 "Shitje mallra dhe produkte"	22.704	42.860	(20.156)
Llog.705-2 "Shitje mall.e produkte"	-	-	-
Llog.731 "Subvencioni"	440.000.000	440.000.000	-
Llog.751 "Kuot pjes inves.dhe grante" (Nga kjo 61,226 mije lekë kuotë pjesë dhe 47,783 mijë lekë materjale nga investimet).	109.008.691	115.531.901	(6.523.210)
Llog.7081..."Ardhura nga ambjentet e dhëna me qera"	7.075.683	6.253.508	822.175
Llog.7088"Ardhura të tjera"	4.916.175	2.434.482	2.481.693
Llog.713 "Ndryshimi gjend.prodimit proces"	-	-	-
Llog.767 "Interesa bankare"	8.547	92.054	(83.507)
Llog.766 "Fitim nga këmbimi valutorë"	3.755.180	41.050.797	(37.295.617)
Llog.757 "Penalitetet e gjoba"	-	138.604	(138.604)
Llog.777 "Të ardhura nga viti i kaluar"	-	(5.834.000)	5.834.000
Llog.768 "Shitje dokumenta tendëri"	15.000	30.900	(15.900)
Llog.781 "Rimar.shuma amortiz.AQ"	-	-	-
Llog.758 +70888"Të ndryshme"	1.286.835	978.337	308.498
TOTALI I TE ARDHURAVE	846.220.276	842.734.129	3.486.147
B. Shpenzimet rezultojnë nga ;			
Llog.601,602 "materiale"	71.086.577	76.344.963	(5.258.386)
Llog.606 "materiale të pastokueshme"	1.000	12.200	(11.200)
Llog.6011 "Lënd djegëse"	154.873.496	132.347.844	22.525.652
Llog.641 "Pagat e punonjesve"	361.898.568	389.561.123	(27.662.555)
Llog.644 "Kont.Sig.Shoq.e Shëndetësore"	60.373.367	64.927.056	(4.553.689)
Llog.681 "Amortizimi i AAGJ"	549.262.388	228.810.894	320.451.494
Llog.618 "Rojet private"	54.693.170	68.000.878	(13.307.708)
Llog.625 "Udhëtim e djeta"	8.325.523	8.252.894	72.629
Llog.626 "Shpenz. Telefonike"	1.154.303	1.266.708	(112.405)
Llog.604 "605)Energji elektrike+Ujë"	7.006.966	6.531.445	475.521
Llog.627 " Shpenz.Transporti me jashtë"	23.975.892	23.220.971	754.921



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë "Hekurudha Shqiptare" SHA Durrës

Llog.627-1 "Shpenz.Transporti brendshëm"	988.857	503.700	485.157
Llog.608 "Kosto bileta udhëtarë"	337.139	476.621	(139.482)
Llog.657 "Penalitete e gjoba"	33.047.583	1.664.118	31.383.465
Llog.623 + 634,635"Siguracione mjete lëvizëse"	866.793	883.752	(16.959)
Llog.681-3-6 "Konsumi veshmbath.dhe invent.imet"	746.964	865.887	(118.923)
Llog.605 "Kosto skrapit hekurudhor"	-	5.277.550	(5.277.550)
Llog.652 "Vlera kontabile e AAM J-Përdorimi"	54.305	-	54.305
Llog.615 "Shpenz.riparime"	517.544	417.818	99.726
Llog.621 "Shpenz.pagesa jasht ndërmarrje"	23.005.200	14.634.650	8.370.550
Llog.648 "Të tjera personeli"	3.105.356	1.185.460	1.919.896
Llog.624 "Shpenz.reklama e publicitete"	6.000	6.000	-
Llog.661 "Shpenz.për interesa"	2.843.443	3.086.596	(243.153)
Llog.666 "Shpenz.nga shkëmbimi valutor,humbje"	131.053.140	5.955.505	125.097.635
Llog.654 "Shpenzime për pritje e përcjellje"	181.224	73.632	107.592
Llog.658-2,616 "Shpenz.sigurim auto.+asete"	845.000	1.470.193	(625.193)
Llog.628 "Shpenz.komisione bankare"	165.328	122.223	43.105
Llog.677 "Humbje nga viti i kaluar"	-	91.950	(91.950)
Llog.658.3 "Të tjera shpenz.financiare"	-	3.370	(3.370)
Llog.të tjera (605 shërbi.,631.8 ,634 ,623 taksa të ndrysh.)	-	420.000	(420.000)
TOTALI I SHPENZIMEVE	1.490.415.126	1.036.416.001	453.999.125

Vlerë e humbjes që rezulton në vitin ushtrimor 2014, 644,194,850 lekë, krahasuar me vitin ushtrimor 2013, me vlerë 193,681,872 lekë, duke pasur rritje të humbjes me 450,512,978 lekë, në këtë rritje ka ndikuar zëri i amortizimit të aseteve me një vlerë për 414,419,188 lekë, vlerë kjo e cila ka rënduar shpenzimet e vitit ushtrimor 2014. Gjithashtu ndikim në rritjen e humbjes ka dhënë edhe zëri i shpenzimit të korigjimit të huave afatgjat me kursin valutor të fundvitit, me vlerën 131,053 mijë lekë, ndërsa në vitin 2013 ishte 5,955 mijë lekë, duke u rritur me 125,097,635 lekë. Konvertimi i monedhës (Usd), në fund të vitit 2014 pati rritje në vlerën 115.23 lekë nga 101.86 lekë që ishte në fund të vitit 2013. Shpenzimet e karburantit kanë një rritje me vlerë 22,526 mijë lekë në krahasim me vitin 2013 (viti 2014 është 154,873 mijë lekë ndërsa viti 2013 ishte 132,348 mijë lekë), kjo ka ardhur si rezultat i rritjes së të ardhurave të volumeve të punës, ku në vitin 2014 janë realizuar 269,424 mijë lekë ndërsa në vitin 2013 ishte 153,156 mijë lekë. Shpenzimet e penaliteteve kanë pësuar rritje në krahasim me vitin 2013, me vlerë plus 31,383 mijë lekë (në vitin 2014 këto shpenzime janë 33,048 mijë lekë, ndërsa në vitin 2013 ishin 1,664 mijë lekë), si rezultat i vendimeve gjyqësore që HSH ka humbur ndaj ish punonjësve të HSH që kanë fituar proceset gjyqësore dhe të tjera vendime gjyqësore të humbura. Zërat e tjera të shpenzimeve sipas pasqyrës së sipër shënuar duke i krahasuar me vitin 2013 në përgjithësi janë në ulje por me efekte më të vogla.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

Periudha ushtrimore 2015

Për vitin 2015 zëri kontabël i bankës është në vlerën 4,534,469 lekë me një diferencë prej 13,622,923 lekë më pak se në vitin 2014, ndërsa arka në vlerën 27,684 lekë.

Llogaria e të drejtave të arkëtueshme është në vlerën 5,817,128 lekë duke rezultuar me një ulje prej 15,808,789 lekë.

Aktivët Afatgjatë Materiale.

Më 31 Dhjetor 2015 Aktivët Afatgjatë Materiale paraqiten si më poshtë:

Ne 000/lekë

	Toka (Trualli)	Ndërtesa dhe instalime	Makineri	Mjete Transporti	Pajisje dhe informatikë	TOTAL
AAM Vlera Bruto						
Gjendje 01.01.2015	43.620.810	53.718.651	902.411	4.651.203	39.023	102.932.098
Shtesa		27,990	7,409	17,602	1,657	54,658
Shtesa (rivlersimi)						
Pakësime			-39,377	-557,415	-2,095	-598,887
Pakësime(rivlersimi)						
Riklasifikime nga CIP						
Tjetër						
Gjendje 31.12.2015	43.620.810	53.746.641	870.443	4.111.390	38.585	102.387.869
Cvlersimi akumuluar						
Gjendje 01.01.2015	0	12.592.848	442.564	2.666.450	22.176	15.724.038
Shtesa (amort.2015)		441,001	16,788	77,322	1,567	536,678
Shtesa (tjera)		457,533				457,533
Pakësime			-28,000	-453,234	-742	-481,976
Pakësime(rivlersimi)						
Riklasifikime nga CIP						
Tjetër						
Gjendje 31.12.2015	0	13.491.382	431.352	2.290.538	23.001	16.236.273
Vlera mbetur neto						
Gjendje 01.01.2015	43,620,810	41,125,803	459,847	1,984,753	16,847	87,208,060
Gjendje 31.12.2015	43,620,810	40,255,259	439,091	1,820,852	15,584	86,121,596

AAM janë njohur në kontabilitet me koston e blerjes së tyre dhe shoqëria ka zgjedhur si politike të saj kontabile modelin e koston ku çdo element i AAM paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar. Ajo nuk ka akumuluar as një humbje nga zhvlersimi. Normat e amortizimit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

zbatuara siç theksuam më lartë janë ato të percaktuara në vendimin e Drejtorisë së Shoqërisë (nr.24 dt.18.12.2006) dhe jo normat fiskale të percaktuara në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat".

Shoqëria ka kryer dy here rivleresimin e aktiveve afatgjata materiale (rivlersimi i kryer me gjendjen e datës 31.12.2006 dhe të datës 31.12.2013), i cili ky i fundit është miratuar nga ana e MZHETTS me shkresë nr.8504/3 dt.17.02.2015 „në zbatim të secilës janë kryer veprimet në kontabilitet (PF) të vitit 2014 me urdhër të administratorit të shoqërisë me nr.220/1 dt.24.03.2015. Gjatë këtij viti shoqëria nuk ka marrë asnjë rivleresim të aktiveve ose përkeqësim.

Aktivitet Afatgjata Materiale

Lëvizjet në vlerë të Aktivitet Afatgjat Materiale përbëhen:

Llog.211, nuk ka pasur lëvizje për vitin ushtrimor 2015. Llog.212, ka shtesa në vlerën 27,990 mijë lekë, që përbëhet nga blerje të reja me fondet buxhetore, 24,699 mijë lekë në Nj.BMIH me vlerë 21,520 mijë lekë, për riaftësimin e traseve Vorë-Budull me vlerë 1,666 mijë lekë, riaftësimi i linjës hekurudhore Lezhë me 7,728 mijë lekë, punime të kryera nga vetë hekurudha në linjën Novosel me 2,047 mijë lekë, mbrojtje lumore Mirak -Librazhd me 1,844 mijë lekë, rikonstruksioni i Stacionit Rrogoshinë me vlerë 1,764 mijë lekë, punime ndërtimi Stacioni Vidhas me 1,208 mijë lekë, rikonstruksioni i Stacioni Kavajë me 783 mijë lekë, punime ndriçimi në Stacioni e Mallrave me 1,635 mijë lekë, rikonstruksioni i Stacionit Vorë me 2,789 mijë lekë, blerje çakull me ngarkimin për linjën Novosel në vlerën, 56 mijë lekë.”Nj.BMIH”, dhe rikonstruksioni i repartit vagonave me shumën 3,179 mijë lekë “Nj.SHML”.

Me fondet e HSH-së, në vlerën 1,225 mijë lekë, nga Nj.BMIH, rikonstruksioni i linjës Milot-Lezhë me 774 mijë lekë dhe logo e HSH me 451 mijë lekë. Ndërsa shtesa me vlerë 2,066 mijë lekë përfaqëson sistemim veprimi nga llog.213 tek llog.212 (Nj.BMIH). Paksime në këtë llogari për vitin 2015 nuk ka patur.

Llog.213, ka shtesë me vlerë 7,409 mijë lekë, që i përket Nj.BMIH, e cila përbëhet nga vlera 6,999 mijë lekë, blerje paisje me fonde buxhetore, dhe 410 mijë lekë, blerje paisje me fondet e veta të HSH. Zvogëlimi me vlerë 39,377 mijë lekë përfaqësohet: 36,939 mijë lekë janë dalje jashte përdorimi të aseteve (Nj.SHML me 26,974 mijë lekë, Nj.BMIH me 9,965 mijë lekë) 349 mijë lekë ka të bëjë me levizje mes njësive (Nj.BMIH dalje për Nj.SHML), 2,089 mijë lekë sistemim nga llog. 213 tek llog.212 (Nj.BMIH me Nj.SHML) 2,066 mijë lekë dhe 23 mijë lekë difference çmimi për tu sistemuar. Llog.215, për vitin ushtrimor 2015 ka shtesë me vlerë 17,602 mijë lekë e cila ka ardhur nga: 1.695 mijë lekë hyrje mes njësive (HSH qender me Nj.BMIH), 15,907 mijë lekë shtesë nga riparimi kapital i lokomotivave (Nj.BM). Zvogëlimet rezultojnë me vlerë 557,415 mijë lekë, që përbëhet nga: nxjerrje jashtë përdorimi të aseteve me vlerë 555,720 mijë lekë (Nj.SHML me 388.014 mijë lekë, Nj.BMIH me 2.455 mijë lekë, Nj.BU me 64.989 mijë lekë, Nj.BM me 100,262 mijë lekë). Dalje mes njësive me vlerë 1,695 mijë lekë (Nj.BMIH me HSH qendër).

Llog.218, shtesa me vlerë 1,657 mijë lekë, përbëhet nga: blerje të reja me fondet e HSH me vlerë 116 mijë lekë (Nj.BMIH me 10 mijë lekë, Nj.SHML me 106 mijë lekë), lëvizje mes njësive me 896 mijë lekë (HSH qendër me Nj.BMIH 86 mijë lekë, Nj.SHML 125 mijë lekë, me Nj.BMIH 72 mijë lekë dhe 53 mijë lekë me HSH qendër, Nj.BMIH me HSH qendër 53 mijë leke, Nj.BU me HSH qendër 53 mijë lekë, dhe me Nj.BM 579 mijë lekë me HSH qendër 520 mijë lekë, dhe 59 mijë lekë me Nj.SHML. Kalim nga depo në përdorim HSH qendër me 640 mijë lekë dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë "Hekurudha Shqiptare" SHA Durrës

vlera për 5 mijë lekë nga Nj.BM është marrje falas (dhuratë). Paksimet e ndodhura në këtë grup asetesh janë në vlerën 2,095 mijë lekë, vlerë kjo e cila ka ardhur nga; 614 mijë lekë dalje jashtë përdorimi të asetëve, (Nj.BU me 36 mijë lekë dhe Nj.BM me 578 mijë lekë). Lëvizje mes njësive nga HSH qendër tek Nj.BM me 413 mijë lekë, Nj.SHML me 131 mije leke, përkatësisht me Nj.BMIH 72 mijë lekë dhe me Nj.BM 59 mijë lekë, gjithashtu Nj.BMIH me Nj.SHML me 72 mijë lekë dhe HSH qender kalim i asetëve nga depo në përdorim me 865 mijë lekë.

Lëvizjet në vlerë të amortizimit të AAM,paraqitet:Lëvizja e Llog.281/2,shtesa me vlerë 898.534 mijë lekë përfaqëson; amortizimin e vitit 2015 441.001 mijë lekë ,shtesa me vlerë 456,756 mijë lekë përfaqëson sistemim veprimi nga llogaria 106 "diferenca nga rivlersimi i asetëve (e mbartur nga viti 2014)",dhe 777 mije leke kalim nga llog.281/3 tek llog.281/2 ,të dyja këto vlera i përkasin Nj.BMIH.

A K T I V E T	VITI 2016	VITI 2015
Aktivitet afatshkurtra		
> Aktivitet monetare	3,491,587	4,534,469
1 Banka (5121)	3,306,639	4,506,785
2 Arka (5311)	184,948	27,684
3 Arka të tjera "vl.kosto bileta" (532)		3,577,040
> Të drejta të arkëtueshme	273,168,212	265,939,250
1 Nga aktiviteti i shfrytëzimit (411)	5,336,499	5,817,128
2 Te tjera detyrime nga aktiviteti i shfrytëzimit (427+431)	609,905	1,340,970
3 Nga njesitë ekonomike brenda grupit		
4 Nga njesitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		
5 Të tjera "Debitor të provigjonuar" (416)	735,794,683	735,794,683
6 Të tjera "Provigjone për debitor pa shpresë arkëtimi" (496)	- 735,794,683	- 735,794,683
7 Të tjera (467)	92,473,400	92,053,528
8 Të tjera "tvsh me saldo debitore" (445)	174,748,408	166,727,624
9 Kapitali i nënshkruar i papaguar		
> Inventarët	282,881,504	265,530,484
1 Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme (311+3124+3128...)	215,545,720	205,456,777
2 Prodhime në proces dhe gjysmë produkte (327-3297)	5,599,507	5,512,530
3 Prodhime në proces dhe gjysmë produkte (342)	5,850,012	7,385,509
3 Produkte të gatshme (347)	52,478,637	47,175,668
4 Mallra		
5 Arka të tjera "vl.kosto bileta" (532)	3,402,529	
6 AAM të mbajtura për shitje		
7 Parapagime për inventar (481)	5,099	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë "Hekurudha Shqiptare" SHA Durrës

> Shpenzime të Shtyra	-	-
> Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara	-	-
TOTALI I AKTIVEVE AFATSHKURTRA	559,541,303	539,581,243
Aktivitet Afatgjata		
> Aktivitet materiale	85,640,117,941	86,151,595,731
1 Toka (211)	43,620,810,137	43,620,810,137
2 Ndërtesa (212)	39,837,137,377	40,255,258,535
3 Impiante dhe makineri (213)	419,906,038	439,090,534
4 Të tjera instalime dhe pajisje (215+218)	1,762,264,389	1,836,436,525
5 Parapagime për aktive materiale dhe në proces		
TOTALI I AKTIVEVE AFATGJATA	85,640,117,941	86,151,595,731
AKTIVE TOTALE (I+II)	86,199,659,244	86,691,176,974

Pasqyra e Pozicionit Financiar (Bilanci).			
NR	DETYRIMET DHE KAPITALI	VITI 2016	VITI 2015
	> Detyrime afatshkurtra	577,729,157	537,596,269
	1 Tituj e huamarrjes		
	2 Detyrime ndaj institucioneve të kredisë		
	3 Arkitime ne avance për porosi		
	4 Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit (401,403,404)	442,355,889	438,606,237
	5 Dëftesa të pagueshme		
	6 Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit		
	7 Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse		
	8 Të pagueshme ndaj punonjësve "për paga" (421)	25,790,079	27,599,074
	9 Të pagueshme ndaj punonjësve për sigurimet shoqërore/shëndetësore (431)	41,029,450	8,486,203
	10 Të pagueshme për detyrimet tatimore (442)	1,988,179	345,064
	11 Të pagueshme për detyrimet tatimore (tatim në burim) (447)	22,607,715	22,607,715
	12 Të tjera (418,419,424,437,467,2,443)	43,957,845	39,951,976
	> Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	-	-
	> Të ardhura të shtyra "grante" (137,137/1 ,dhe 138)	567,375,244	575,963,010



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë "Hekurudha Shqiptare" SHA Durrës

	> Provizione	-	-
I	TOTALI I DETYRIMEVE AFATSHKURTRA	1,145,104,401	1,113,559,279
	> Detyrime Afatgjata	1,672,087,683	1,656,237,042
	1 Tituj të huamarrjes (401/1)	935,641,000	918,267,000
	2 Detyrime ndaj institucioneve të kredisë (161)	736,446,683	737,970,042
	> Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	-	-
	> Të ardhura të shtyra	-	-
	> Provizione (151)	237,250,000	237,250,000
	1 Provizione për pensionet		
	2 Provizione të tjera		
	> Detyrime tatimore të shtyra	-	-
II	TOTALI I DETYRIMEVE AFATGJATA	1,909,337,683	1,893,487,042
	DETYRIME TOTALE (I+II)	3,054,442,084	3,007,046,321
	> Kapitali dhe rezervat		
	> Kapitali i nënshkruar (101)	52,378,473,000	52,378,473,000
	> Primi i lidhur me kapitalin		
	> Rezerva rivlerësimi	34,737,544,416	35,136,383,608
	> Rezerva të tjera	-	-
	1 Rezerva ligjore		
	2 Rezerva statutore		
	3 Rezerva të tjera		
	> Fitimi i pashpërndarë "të mbartura" (121)	820,738,975	414,419,188
	> Fitimi i pashpërndarë "e vitit" (121)	398,839,192	406,319,787
	> Fitimi i pashpërndarë "paraardhëse" (121)	- 4,651,464,930	- 3,938,768,318
	> Fitimi/humbja "e vitit" (121)	- 538,913,493	- 712,696,612
III	TOTALI I KAPITALIT	83,145,217,160	83,684,130,653
	TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT (I+II+III)	86,199,659,244	86,691,176,974

Më 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 gjendja e aktiveve monetare paraqitet si me poshte:
Ne 000/lekë

	31/12/2016	31/12/2015
Gjendje në arkë	185	27



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë "Hekurudha Shqiptare" SHA Durrës

Gjendje në Banka	3,307	4,507
Total	3,492	4,534

Vlera e koston së biletave të transportit udhetare ka kaluar në grupin e inventareve në depo. Kesh dhe ekuivalentet e tij të analizuar në monedhat që vijojnë rezultojnë:

	31/12/2016	31/12/2015
Monedha lokale (lekë)	2,701	4,314
EURO (5.755,91 EURO)	778	171
US DOLLAR (99,27 USD)	13	49
CHF (3.37 CHF)	0	0
Total (në 000/lekë)	3,492	4,534

Mjetet monetare në valute të huaja janë vlerësuar me kursin e datës 31.12.2016 të shpallur nga Banka e Shqipërisë dhe diferencat janë sistemuar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Është kryer rakordimi i gjendjes së llogarive të bankave dhe arkave në kontabilitet me gjendjen e ekstrakteve bankare për secilën llogari bankare dhe librave të arkave.

Kërkesa të arkëtueshme në vlerën 5,336,499 lekë përbëhen kryesisht nga K. shpk me vlerë 260,201 lekë, Gj. Shpk me vlerë 201,600 lekë, B. Shpk me vlerë 893,760 lekë, faturime këto të vitit 2016, si dhe Beton Plus me vlerë 3,442,455 lekë e vitit 2015, R. Caushaj me vlerë 838,114 lekë e vitit 2015.

Detyrimet e kontabilizuara vlerë 735,795,000 lekë përfaqëson vlerë e detyrimeve për të cilën nga ana e drejtimit të shoqërisë janë krijuar provigjone në vitin 2008.

Detyrimet e kontabilizuara me vlerë 92,473 mijë lekë nga 92,053 mijë lekë në vitin 2015 përfaqëson debitorë me konflikt prej disa vitesh, ku mundësia e arketimit të kësaj vlere, me përbërje 47 subjekte është e ulët. Vlera prej 21,836 mijë lekë e vlerësuar nga Nj.Mjeteve dhe e Infrastrukturës përbëhet nga vlerat e dëmtimeve të ndryshme në objektet e shoqërisë nga viti 2006-2015, për të cilat janë kryer denoncimet në organet përkatëse, por që janë kontabilizuar si detyrime të arkëtueshme.

Nga shoqëria të analizohen llogaria kërkesave të arkëtueshme dhe të kryhen provizionimet përkatëse.

Detyrimet e tjera për detyrimet e punonjësve me vlerë 284 mijë lekë dhe përfitimet e sigurimeve shoqërore për 326 mijë lekë janë të arkëtueshme.

Kërkesa të arkëtueshme tvsh kreditore në fund të vitit 2016 rezultojnë me vlerën 174,748 mijë lekë, nga 166,728 mijë lekë që ishte në vitin 2015.

-Në zërin e kërkesave për arkëtim përfshihen kërkesa për TVSH të zbritshme në shumën 174,748,000 lekë. Në këtë shumë përfshihet TVSH e konsideruar si e pa zbritshme nga ana e kontroleve tatimore për shumën 63,083,000 lekë e cila i përket periudhave 2014 dhe 2015. Nga kontrollet tatimore të ushtruara nga dega tatimore në vitet 2010, 2012 dhe 2015 shoqërisë i janë ngarkuar penalitete në vlerën 81,955,000 lekë për të paguar. Këto penalitete janë apeluar nga shoqëria dhe pasi e ka humbur çështjen në gjykatë e ka fituar në Drejtorinë e Apelit Tatimor duke shfuqizuar plotësisht aktin administrativ të Njoftim Vlerësimit nr. 21104/4 dt. 12.01.2016 me shkresën 3964/4 dt. 16.05.2016. Shoqëria është në proces gjyqësor për çështjet e mësipërme dhe është në pritje të zhvillimit të gjykimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë "Hekurudha Shqiptare" SHA Durrës

Për sa më sipër shoqëria nuk ka krijuar ndonjë zhvlerësim për shumën e TVSh-së së zbritshme të panjohur për rimburim për vlerën 63,083,000 lekë si dhe nuk ka krijuar provizione për shpenzimet për gjoba të vendosura nga aktet e kontrollit 2010, 2012, e 2015 në shumën 81,955,000 lekë.

Në zërin e inventarëve shoqëria ka klasifikuar lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme në vlerën 215,545,720 lekë, prodhime në proces dhe gjysme produkte 5,599,507 dhe 5,850,012 lekë si dhe produkte të gatshme në vlerën 52,478,637 lekë. Pjesa e produkteve të gatshëm janë pjesë këmbimi që prodhohen për mjetet lokomotiva e vagona por jo për tu shitur tek të tretët.

Ky klasifikim është në kundërshtim me SKK nr. 4, pika 7, ku citohet:

" Inventarët e njësisve prodhuese përbëhen nga lëndët e para dhe materialet për konsum, puna në proces dhe produktet e përfunduara gati për shitje, mallrat e blera dhe të mbajtura për rishitje me pak ose aspak nevojë për ndryshim, që janë inventarë tipike për njësitë tregtare. Pronat e paluajtshme të blera për rishitje duhet të njihen si inventar, ndërsa ato të blera për përdorim në procesin e prodhimit ose për qëllime administrative, duhet të njihen si aktive afatgjata materiale."

Aktivitet Afatgjata Materiale

Levizjet në vlerë të AAM përbëhen nga Llog.211 e cila nuk ka levizje për vitin ushtrimor 2016. Llog.212, ka shtesa në vlerën 18.545 mijë lekë, e cila përbëhet; blerje të reja me fondet buxhetore 14.202 mijë lekë (riaftesimi i trasesë Lezhë me vlerë 2.568 mijë lekë dhe rikonstruksioni i linjës Librazhd-Prenjas me 11.634 mijë lekë), blerje me fonde të brendshme 144 mijë lekë (47 mijë lekë bazamenti i Kjoskës St.Kashar dhe 96 mijë lekë Logo në St.Vorë), ndërsa vlera për 4.199 mijë lekë përfaqëson sistemim i brendshëm nga llog.213.Të gjitha këto veprime i përkasin Nj.BMIH. Paksimet në këtë llogari për vitin 2016 nuk ka patur. Llog.213 nuk ka patur shtesa për këtë periudhë. Paksimi rezulton me vlerë 5.021 mijë lekë që përfaqësohet; 4.199 mijë lekë përbën sistemim të brendshëm nga llog.212 ,vlera për 783 mijë lekë përfaqëson sistemim i brendshëm nga llog.215 ,dhe 39 mijë lekë është sistemim i brendshëm me llogarinë 327.Të gjitha keto veprime i përkasin Nj.BMIH. Llog.215,për vitin ushtrimor 2016 ka shtesë me vlerë 783 mijë lekë e cila ka ardhur nga sistemimi i brendshëm me llog.213, e cila i përket Nj.BMIH. Paksime në këtë llogari për vitin 2016 nuk ka patur. Llog.218, shtesa me vlerë 122 mijë lekë, përbëhet nga; blerje të reja me fonde të brendshme me vlerë 101 mijë lekë (Nj.BMIH me 90 mijë lekë dhe HSH qendër me 11 mijë lekë), 21 mijë lekë përfaqëson levizje të brendshme mes HSH qendër dhe Nj.BM. Paksimet e ndodhura në këtë grup asete janë në vlerën 1.914 mijë lekë, vlerë kjo e cila ka ardhur nga; 1.883 mijë lekë dalje jashtë përdorimi të aseteve, (Nj.SHML me 1,566 mije leke dhe HSH qendër me 316 mijë lekë), 11 mijë lekë është sistemim me llog.327 nga ana e HSH qendër dhe 21 mijë lekë levizje të brendshme mes HSH qendër dhe Nj.BM.HSH qendër dalja jashtë përdorimi e miratuar me vendim të Administratorit nr.04 dt.21.02.2017.

Pasivi

Detyrime afatshkurtra.

Kërkesat e arkëtueshme në vlerën 442,355,889 lekë përbëhen nga detyrimet ndaj hekurudhave të huaja për ore-qëndrimet e vagonëve të mallit në territorin vendas janë në vlerën 204,209 mijë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

lekë (1,510,084 Euro), nga 196,621 mijë lekë (1,432,260 Euro) që kanë qenë në vitin 2015, detyrimet për rojet private janë 166,693 mijë lekë, nga 167,518 mijë lekë që ishin në vitin 2015, detyrimi për gazoilin e blerë është 21,331 mijë lekë, nga 48,079 mijë lekë që ishte në vitin 2015, si dhe për blerje materiale të domosdoshme për aktivitetin e HSH-së 55,187 mijë lekë nga 30,349 mijë lekë që kanë qenë në vitin ushtrimor 2015.

Detyrimet për roje private i përkasin periudhës 2013-2016/06, ndërsa detyrimet për gazoil dhe të tjera detyrime i përkasin periudhës së vitit 2016.

Detyrimet ndaj hekurudhave të huaja për ore qëndrimet e vagonëve i përkasin periudhave;viti 2009 me 209.68 mijë euro,viti 2010 me 370.51 mijë euro,viti 2011 me 300.22 mijë euro,viti 2012 me 204.36 mijë euro,viti 2013 me 163.41 mijë euro,viti 2014 me 100,38 mijë euro, viti 2015 me 83,69 mijë euro dhe në vitin 2016 me 63,08 mijë euro.

Të tjera të pagueshme.

	Në 000/lekë	
	31/12/2016	31/12/2015
Parapagime të mara	0	0
Paga dhe shpërblime (421)	25,790	27,599
Detyrime për sigurimet shoqërore (431)	41,029	8,486
Shteti për tatim taksa (442+447 70% qerave)	24,596	22,953
Kreditorë të tjerë (424,437,4672,418,443)	38,893	39,952
Total	130,308	98,990

Grandet janë njohur në të ardhurat në mënyre sistematike gjatë periudhave kontabël për çdo vite ushtrimor. Këto grante në fund të vitit 2016 paraqiten;

Grante për investime..... 88,246,000 lekë
Kuote pjesë grante për investime..... 439,110,000 lekë
AAM të mara falas..... 40,019,000 lekë
Totali.....**567,375,000** lekë

-Shoqëria ka paraqitur në klasën grante dhe të ardhura të shtyra afatshkurtra në vlerën 567,375,000 lekë, të cilat lidhen me grante të marra për aktive afatgjata. Këto grante duhet të paraqiten në klasën e detyrimeve afatgjata.

> Detyrime Afatgjata	1,672,087,683
1 Tituj të huamarrjes (401/1)	935,641,000
2 Detyrime ndaj institucioneve të kredisë (161)	736,446,683
> Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	-
> Të ardhura të shtyra	-
> Provizione (151)	237,250,000
1 Provizione për pensionet	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

Në zërin e detyrimeve afatgjata vlera prej 935,641,000 lekë përbëhet nga detyrimet ndaj hekurudhave të huaja “te viteve deri 1990-92”, diference kjo në vlerë plus 17,374 mijë lekë në krahasim me vitin 2015, e cila ka ardhur si rezultat i konvertimit të monedhës (euro dhe usd), ku në fund të vitit 2016 nuk pati ndryshime të medha në krahasim me vitin 2015. Në fund të vitit 2016 usd rezulton të jetë 128.17 lekë dhe euro 135.23 lekë, ndërsa në vitin 2015 usd ishte 125.79 lekë dhe euro ishte 137.28 lekë.

Emri i furnitorit	Valuta Usd	Kursi 31.12.2016	Vlefata All (000/lekë)
Hekurudha Jugosllave.....	6,866,478	128.17	880,077
Hekurudha Ceke.....	51,341	128.17	6,580
Hekurudha Rumune.....	81,653	128.17	10,465
Riparim Vagona.....	300,528	128.17	38,519
Totali.....	7.300.000.....		935,641

Këto detyrime paraqiten si huamarrje të tjera afatgjata dhe janë të rivlersuara me kursin e datës 31.12.2016 dhe diferencat kanë kaluar në diferenca konvertimi. Nga ana e hekurudhave “sidomos ato ish Jugosllave” kanë kërkuar disa herë likuidimi i detyrimeve, duke përfshirë dhe interesat. Hekurudha Shqiptare sha Durrës nuk disponon dokumenta ligjor, për ndarjen e detyrimeve të ish hekurudhës Jugosllave sipas shteteve që ajo është ndarë (është aktualisht). Nga shoqëria nuk janë llogaritur interesat për këto detyrime.

Më 31 Dhjetor 2016 gjendja e huave afatgjata të shoqërisë është si me poshtë :

Kredia Italiane është marrë në vitin 1998 në vlerën 6,000,000,000 Lireta e cila është konvertuar në euro 3,098,741 për të cilën principali ka filluar të likuidohet në vitin 2008 duke paguar vlerën për 172.152 EURO. Më pas shoqëria nuk ka kryer asnjë veprim për likuidimin e principalit ose interesave. Në lidhje me kreditë e tjera në mungesë të informacionit nuk është kryer asnjë veprim.

Gjendja e kredive (huave) në monedhe të huaj dhe e konvertuar në lekë rezulton sa poshtë vijon:

	Vlera në Valute	Kursi	Vlera ALL(000/lekë)
Kredia Italiane.....	Euro 2,840,512.55	135.23	384,123
Banka Boterore.....	USD 1,000,000	128.17	128,170
Granti Japonez.....	USD 1,230,107.82	128.17	157,663
Granti Japonez.....	Euro 491,690	135.23	66,491
Totali			736,447

Huatë janë vlerësuar me kursin e fundit të vitit dhe diferencat nga konvertimi janë kontabilizuar në llogarinë e diferencave të konvertimit me kursin e fundvitit.

Nga verifikimi i kryer në regjistrin e borxhit publik të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë rezultoi për llogari të Hekurudhës Shqiptare Sh.a. vetëm kredia italiane. Shoqëria duhet të kryejë rakordimet e duhura me departamenti përkatës në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për sqarimin e situatës debitore.

Në lidhje me kredinë italiane shoqëria dispononte planin e amortizimit të kredisë si dhe ka marrë njoftime periodike nga BKT që funksionon si bankë ndërmjetëse në lidhje me detyrimet, por



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë "Hekurudha Shqiptare" SHA Durrës

megjithëse nuk ka paguar këstet e principalit dhe interesat duhet të krijonte një llogari provizioni për këto këste dhe interesa të cilat janë paguar nga llogaria e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Vlera e cila llogaritet deri në fund të periudhës ushtrimore 2017 është 1,746,915 Euro ose në vlerën 232,252,349 lekë.

Situata e vështirë ekonomike e shoqërisë është thelluar akoma më shumë në vitet e fundit duke e bërë të pamundur kthimin e detyrimit duke lënë këtë barrë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. **Vlera 1,746,915 Euro është efekt negativ për Buxhetin e Shtetit.**

Vlera 237,250 mijë lekë është krijuar në vitin 2000, me krijimin e shoqërisë si shoqëri aksionere. Kjo është mbajtur rezervë për të amortizuar në të ardhmen rritjet eventuale të kursit të monedhës së huaj për detyrimet që kishte dhe ka shoqëria (HSH) ndaj hekurudhave si ndërkombëtare në marrdhëniet e ndërsjellta.

Zëri i fitimit të pashpërndarë i mbartur është diferenca e amortizimit të llogaritur mbi aktivet afatgjata materiale të rivlerësuara me vlerën e parivlerësuar në përputhje me standartet kombëtare të kontabilitetit.

	2016	2015
> Fitimi i pashpërndarë "të mbartura" (121)	820,738,975	414,419,188
> Fitimi i pashpërndarë "e vitit" (121)	398,839,192	406,319,787
> Fitimi i pashpërndarë "paraardhëse" (121)	- 4,651,464,930	- 3,938,768,318
> Fitimi/humbja "e vitit" (121)	- 538,913,493	- 712,696,612

Humbja e mbartur e vitit 2016 është 4,651,464,930 lekë, ndërsa humbja e vitit është 538,913,493 lekë.

N r.	Përshkrimi i Elementëve	VITI 2016	VITI 2015
	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit (7041,7042,7043,705)	70,285,691	179,336,438
	Ndryshimi ne inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces		
	Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar		
	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit (7081,7088...)	6,803,483	8,116,385
	Lënda e parë dhe materiale të tjera të konsumueshme	89,940,470	181,503,844
	1 Lënda e parë dhe materjale të konsumueshme (601+6011,602,605,606)	89,940,470	181,503,844
	2 Të tjera shpenzime		
	Shpenzime të personelit	400,033,044	415,201,833
	1 Paga dhe shpërblime (641)	342,533,795	355,501,900
	2 Shpenzime të sigu.shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet)	57,499,249	59,699,933



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

	Zhvlërësimi i aktiveve afatgjata materiale (681)	525,637,665	536,062,519
	Shpenzime konsumi dhe amortizimi		
	Shpenzime të tjera shfrytëzimi (606,608,657,658,604,615,618,621,624,625,626,622,648,652,654,672,628...)	53,220,155	231,790,352
	Shpenzime të tjera shfrytëzimi "penalitetet" (657)	9,290,297	19,258,917
	Të ardhura të tjera	489,689,174	587,902,617
	1 Të ardhura nga njësia ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)		
	2 Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit) (751)	79,038,821	105,695,993
	3 interesa të arkëtueshme dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit) (766,767)	11,835,128	14,324,342
	4 Të ardhura të tjera të shfrytëzimit (713,757,758,768,777,778)	8,815,225	27,882,282
	5 Të ardhura të tjera të shfrytëzimit (731)	390,000,000	440,000,000
>	Zhvlërësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra		
>	Shpenzime financiare	27,570,210	104,234,587
	1 Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për tu paguar tek njësitë ekonomike brenda grupit) (661)	2,909,276	2,597,408
	2 Shpenzime të tjera financiare "kembimi valutor" (666)	24,660,934	101,637,179
>	Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet		
>	Fitimi/humbja para tatimit	- 538,913,493	- 712,696,612
>	Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	-	-
	1 Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin (15%)	-	-
	2 Shpenzimi i tatimit fitimit të shtyrë		
	3 Pjesa e tatimit fitimit të pjesëmarrjeve		
>	Fitimi/humbja e vitit	- 538,913,493	-712,696,612

Në llogaritje e të ardhurave nga grantet është bërë jo konform me SKK nr. 10 “Grantet dhe format e tjera të ndihmës”. Zëri kontabël i granteve për rimarrjen e të ardhurave është amortizuar me 10% jo duke i specifikuar amortizimin dhe konsumin respektiv të aktiveve të cilat i përkasin këto grante.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë "Hekurudha Shqiptare" SHA Durrës

Ish-administratori i shoqërisë z. G.A, pasi vlerësoi relacionet e komisioneve për vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve si vagona malli, vagona udhëtari, shina etj, vendosi me vendimin nr. 7, datë 30.06.2014 për miratimin në parim për nxjerrjen jashtë përdorimit për Njësinë e Biznesit të Mallit, 30 vagonë malli me peshë të përafërt 444,44 ton, dhe vlerë kontabël që kalon në humbje 19,869,345 lekë, për Njësinë e Biznesit të Udhëtarëve, 10 vagonë udhëtari me peshë të përafërt 216,26 ton me vlerë kontabël që kalon në humbje 18,381,475 lekë si dhe Njësinë e Biznesit e Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore aktive të ndryshme me peshë të përafërt 426,26 ton, me vlerë kontabël që kalon në humbje 17,045,027 lekë. Njësia e Shërbimit të Mjeteve Lëvizëse me aktive të ndryshme me peshë të përafërt 182,355 ton dhe me vlerë kontabël që kalon në humbje 9,822,934 lekë.

Me vendimin nr. 8, datë 18.07.2014 ish administratori miratoi në parim vlerësimin për nxjerrje jashtë përdorimit të 14 lokomotivave nga të cilat 6 të vogla dhe 8 lokomotiva të mëdha, me peshë të përafërt 934 ton dhe vlerë kontabël 58,368,996 lekë, si dhe aktive të ndryshme me peshë të përafërt 206.3 kg dhe vlerë kontabël në humbje 5,697,340 lekë.

Më datë 31.07.2014 Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë me vendimin nr 11, ka miratuar vendimet 7 dhe 8 të administratorit. Me shkresën nr. 910 prot., datë 05.08.2014 i është dërguar Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për miratim. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë pasi ka vërejtur disa gabime në dokumentacion ka kërkuar korrigjimin e tyre me shkresën nr. 5933/1 prot., datë 28.08.2014. Pas kthimit të përgjigjes nga Ministria është kërkuar përsëri plotësimi i praktikës me shkresën nr. 5933/3 prot, datë 03.11.2014. Me vendimin nr.7 prot., datë 12.11.2014 ish-administratori ka saktësuar vlerat e aktiveve që dalin jashtë përdorimit si dhe amortizimin përkatës duke pasur në total: vlera fillestare 605,811,658 lekë, amortizimi 493,683,894 lekë, vlera e mbetur 112,127,764 lekë, sasia në total 1,944 ton.

Me shkresën nr. 5933/5 prot., datë 13.02.2015, ministri ka aprovuar nxjerrjet jashtë përdorimit të aseteve të shoqërisë, hapjen e procedurave të ankandit publik si dhe caktimin e znj. V.C si eksperte vlerësuese për raportin e vlerësimit të aseteve dhe përcaktimin e çmimit të skrapit. Pas marrjes së raportit të ekspertës, ministri me shkresën nr 3690/1, datë 22.05.2015 ka caktuar çmimin fillestar të skrapit për fillimin e procedurave të ankandit, me vlerën 30 lek/kg pa Tvsh, me vlerë totale të skrapit 28,320,000 lekë.

Vendimi nr. 12, datë 21.11.2016, i ish-administratorit z. I.D, për nxjerrjen jashtë përdorimit të 124 vagonë malli me vlerë të mbetur kontabël 124,406,128 lekë dhe peshë 1,784.6 ton si dhe vendimi nr.3, datë 17.02.2017 për nxjerrjen jashtë përdorimit të 8 vagonave udhëtarësh me vlerë të mbetur kontabël 20,858,884 lekë me peshë 240 ton janë aprovuar nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr. 2, datë 22.02.2017.

Me shkresën nr. 1630/1 prot, datë 04.04.2017, ministri ka miratuar nxjerrjen jashtë përdorimit të aseteve me vlerë të mbetur kontabël 145,265,012 lekë si dhe caktimin e ekspertës vlerësuese znj. V.C dhe me shkresën nr. 5929/2 ka miratuar raportin e ekspertës si dhe hapjen e procedurave të ankandit.

Në lidhje me procedurën e dytë, materialet e dosjes janë sekuestruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Durrës, me urdhrin e procedimit penal nr. 844 të vitit 2017.

Mbi humbjen e bazës materiale në tunelin e Qafë thanës.

Në adresë të KLSH ka ardhur një informacion regjistruar me nr. 312, datë 09.03.2018, në lidhje me disa dëmtime të aseteve në administrim të Shoqërisë "Hekurudha Shqiptare" SH dhe konkretisht humbjen e një kabulli me gjatësi rreth 2000 m në tunelin e Qafë Thanës. Bazuar në



sa më sipër, grupi i auditimit mori kontakt me drejtues të shoqërisë nga ku konkludoi se, për këtë shqetësim shoqëria është vënë në dijeni nga një informacion i ngjashëm. Pas marrjes së informacionit, Drejtori i Njesisë së Biznesit, Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore (NjMIH) z. D.M, me urdhër të brendshëm nr. 402, datë 08.03.2018, ka ngritur komisionin për verifikimin e gjendjes së inventarit të materialeve e pajisjeve brenda në Tunelin Qafë Thanë, të përbërë nga z. R.D, z. M.S dhe z. A.S. Bazuar në procesverbalin e mbajtur nga komisioni i mësipërm me datë 15.03.2018, rezulton se informacioni është real dhe se nga verifikimi ka rezultuar se mungon kabulli me gjatësi rreth 2000 m, por ka dhe dëmtime të tjera si mungesa e një kabulli furnizimi me energji elektrike nga km 135.6 deri 135.8, si dhe nuk ka shina rezervë të depozituara në tunel.

NjMIH me shkresë nr. 402/1, datë 20.03.2018, i ka dërguar procesverbalin Degës Juridike, pranë hekurudhës Shqiptare.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit nga ana e Drejtorisë Juridike pranë HSH, është bërë kallëzim penal për humbjen e bazës materiale, i cili i është drejtuar Prokurorisë së rrethit Gjyqësor Pogradec me shkresë nr. 323, datë 21.03.2018. Në këtë kallëzim theksohet fakti se linja hekurudhore Librazhd-Guri i Kuq, ka kaluar në konservim prej 6 vjetësh dhe nuk ka kalim trenash as për pasagjerë, as për mallra. Një anë e tunelit (nga ana e Përrenjasit) është e mbyllur me portë, ndërsa pjesa tjetër në drejtim të Pogradecit ruhet me roje nga punonjës të vetë shoqërisë, pasi kontrata me Shoqërinë e ruajtjes fizike “S.” Sh.p.s.f, është mbyllur para dy viteve. Theksohet fakti se, duke qenë se materialet mund të kenë humbur në kohë të ndryshme gjatë kësaj periudhe, është vështirë përcaktimi i përgjegjësive nga ana e shoqërisë, për faktin se pas rojeve private punonjësit e shoqërisë të ngarkuar me ruajtjen kanë qenë të ndryshëm.

IV. 7. Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

Nga auditimi konstatohet që:

1. Mbi zbatimin e procedurës së prokurimit me objekt “Riaftësim linje km 64.5 deri 66.5, Lezhë, për vitin 2015”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet që:

Titulli i gjetjes: Skualifikim OE me ofertë më të ulët pa argumente si dhe kualifikim OE tjetër me mangësi në dokumentacion.

Situata: Nga ana e KVO është skualifikuar një operator ekonomik me vlerën më të ulët të paraqitur për argumente të cilët nuk qëndrojnë si dhe është kualifikuar një tjetër operator ekonomik me vlerë më të lartë të ofertës, i cili ka mangësi të theksuar në dokumentacionin e paraqitur.

Kriteri: Në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 46 pika 1.b, ku përcaktohet:

“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Ndikimi/efekti: Si pasojë e këtij veprimi, është shkaktuar dëm ekonomik me vlerë 1,340,536 lekë.

Shkaku: Mos korrektësi në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandime: Nga ana e KVO duhet të shqyrtohet me korrektësi çdo dokument i paraqitur nga operatorët ekonomikë, në mënyrë që skualifikimi apo kualifikimi i tyre të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore dhe në mbrojtje të interesave të shoqërisë.

Nga auditimi konstatohet që, materiali teknik për nevojën për ndërhyrje është përgatitur me datë 24.03.2015. Fondi limit është përlogaritur me vlerë 9,667,475 lekë., bazuar në manualet e çmimeve të ndërtimit.

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Riaftësim linje km 64.5 deri 66.5, Lezhë, për vitin 2015”.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 19, datë 11.05.2015	3. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
2. lloji i Procedurës së Prokurimit I hapur	T.P, juriste E.B L.D	Urdhër nr. 19/1, datë 11.05.2015 S.Sh P.N N.P
5. Fondi Limit (pa tvsh) 9,667,475 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 7,564,282 lekë	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 2,103,193 lekë
8. Data e hapjes së ofertave 05.06.2015	9. Burimi i Financimit Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender 5 OE 1.AL-A. Sh.p.k me ofertë 6,741,022 lekë 2.B. me ofertë 7,564,282 lekë 3.GJ. Sh.p.k me vlerë 7,716,032 lekë 4.K. Sh.p.k me vlerë 8,803,226 lekë. 5.SH. M Sh.p.k me vlerë 6,223,746 lekë b. Skualifikuar – 4 operator Kualifikuar B. Sh.p.k
11. Ankimime “Sh. M” Sh.p.k “AIA.” sh.p.k	12. Përgjigje e ankesës nga AK nr. 835/2, datë 01.07.2015 nr. 860/1, datë 02.07.2015	13. Përgjigje ankesës nga AKKP Shkresa nr.-
b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. lidhje e kontratës nr. ____, datë 03.08.2015	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 9,077,138 lekë.	16. Likuiduar deri datë 31.12.2017 9,077,138 lekë Pa likuiduar: - lekë
17. Situacioni përfundimtar Vlerë -9,077,138	18. afati i kontratës në ditë Parashikuar 90ditë	19. Zgjatja e kontratës me ditë -



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

	Realizuar 90 ditë			
20. mbikëqyrësi i punimeve - A.N	Licencë -MK 2617	Kontrata -27.07.2015	Likuiduar -lekë 136,156 lekë	Pa likuiduar -lekë
21. kolaudatori i punimeve - M.K	Licencë Nr. MK 1200/2	Kontrata -	Likuiduar -lekë	Pa likuiduar -lekë
22. Akt Kolaudimi Datë 16.12.2015	23. Akt i marrjes në dorëzim Datë. 22.12.2015		24. Fletë Hyrja nr. -	

Nga verifikimi i dokumentacionit në rrugë elektronike dhe dokumentacionin e dosjes së prokurimit rezulton se:

Janë skualifikuar 4 OE, nga të cilët edhe OE “Sh. M” sh.p.k me vlerë oferte 6,223,746 lekë. OE “SH. M” Sh.p.k është skualifikuar me argumentet si më poshtë:

-I mungon diploma e inxhinierit topograf.

- Mungojnë mandat pagesat për taksat vjetore të mjeteve kamion me targë AA 193 DO, kamion me targë AA 074 AH, kamion me targë Ko 5987 B, kamion me targë Ko 0598 B fadromë me targë AA 931 EF, ekskavator me targë ACI 808.

OE “SH. M” Sh.p.k me shkresë datë 26.06.2015 protokolluar në HSH me nr. 835, datë 29.06.2015, ka paraqitur ankesë në lidhje me skualifikimin nga gara. Argumenti i ankesës është që për marrjen e licencës së drejtuesit teknik pranë autoritetit përkatës dorëzohet kopja e diplomës që vërteton profesionin e drejtuesit teknik, kështu është vepruar edhe me drejtuesin teknik z. Sh.D dhe mbi këtë bazë ka dalë licenca personale dhe është bërë kategorizimi në licencën e shoqërisë.

Bazuar në ankesën e mësipërme Titullari i Autoritetit Kontraktor me shkresë nr. 19/3, datë 29.06.2015, ka urdhëruar pezullimin e procedurës. Në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka dokument mbi ngritjen e komisionit të shqyrtimit të ankesës, nuk ka procesverbal mbi shqyrtimin e ankesës. Me shkresë nr. 835/2, datë 01.07.2015 është njoftuar OE “SH. M” Sh.p.k, për mos pranimin e ankesës.

Sa më sipër, nga verifikimi në sistemin elektronik rezulton se z. Sh.D zotëron licencë profesionale nr. TZ 0658, lëshuar me datë 29.05.2007 me pikat: Rilevime topografike, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike dhe punime speciale gjeodezike, rrjeta mbështetëse, qëndrueshmëri terrenesh. Po ashtu në këtë licencë është përcaktuar se është diplomuar në vitin 1967 në degën inxhinieri maksheider.

Në lidhje me mandatpagesat nga ana e OE është sqaruar se në sistemin elektronik janë paraqitur certifikatat e kontrollit teknik, të cilat nuk mund të lëshohen pa likuiduar më parë detyrimet për taksat vjetore. Po ashtu polica e sigurimit e paraqitur në sistemin elektronik nuk mund të lëshohet pa bërë pagesën përkatëse. Nga ana e OE i është kërkuar autoritetit kontraktor të bëjë verifikime në rast dyshimi për dokumentet e paraqitura.

Skualifikimi i OE si më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 53 pika 4, ku përcaktohet:

“Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE shpallur fitues “B.” Sh.p.k rezulton se ka mangësi si më poshtë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

-Duke marrë në konsideratë se tenderi është hapur me datë 05.06.2015, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE fitues rezulton se dokumentacioni i paraqitur për automjetet ka skaduar.

Siguracioni për kamionin me targë AA 275 BR, ka skaduar me datë 26.05.2015.

Siguracioni për kamionin me targë AA 427 CF, ka skaduar me datë 07.05.2015.

Automjetit me targë AA 143 GV, i ka përfunduar kontrolli teknik me datë 27.05.2015.

- Për vitin 2014 OE “B.” Sh.p.k, ka të punësuar mesatarisht 9 punëtorë krahu (vetëm për një muaj ka 11 punëtorë krahu), në kundërshtim me dokumentet e tenderit “Kriteret e veçanta” pika 3, ku kërkohet që OE duhet të ketë të punësuar 12 punëtorë krahu, të cilësuar në listëpagesa.

Pavarësisht mangësive të mësipërme, ky OE është kualifikuar dhe është shpallur fitues.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 46 pika 1.b, ku përcaktohet:

“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Si pasojë e veprimeve të mësipërme, për arsye të skualifikimit të OE me ofertë më të vogël, për devijime të cilat nuk ndryshojnë në thelb ofertën, si dhe për shkak të kualifikimit të një OE i cili ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur, **është shkaktuar dëm ekonomik me vlerë 1,340,536 lekë [7,564,282 lekë (oferta fituese) – 6,223,746 lekë (oferta e OE Sh. M)].**

Në kushtet kur nuk ka dokumentacion për shqyrtimin e ankesës, ngarkohet më përgjegjësi KVO e përbërë nga z. S.Sh, znj. P.N dhe znj. N.P.

Formulari i njoftimit të fituesit është publikuar në Buletin e APP nr. 28, datë 20.07.2015.

Formulari i lidhjes së kontratës është botuar në Buletin e APP nr. 31, datë 10.08.2015. Kontrata është nënshkruar me datë 03.08.2015, me vlerë 9,077,138 lekë.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Nga ana e KVO është skualifikuar një operator ekonomik me vlerën me të ulët të paraqitur për argumente të cilët nuk qëndrojnë si dhe është kualifikuar një tjetër operator ekonomik me vlerë më të lartë të ofertës, i cili ka mangësi të theksuar në dokumentacionin e paraqitur, duke dëmtuar në këtë mënyrë interesat e autoritetit kontraktor dhe shkaktuar dëm ekonomik.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 46 pika 1.b.

-Vlera 1,340,536 lekë përbën dëm ekonomik për shoqërinë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

1. z. S.Sh
2. znj. P.N
3. znj. N.P, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave.

KVO, ka paraqitur pretendimet për rezultatet e auditimit protokolluar në KLSH me nr. 1313/7, datë 22.05.2018, si më poshtë:

Pretendohet se mos paraqitja e dokumentacionit nga OE “SH. M” Sh.p.k që ka lidhje me diplomën e inxhinierit mandat pagesën e taksës së qarkullimit për disa automjete nuk konsiderohet devijim i vogël.

Sqarojmë se, argumentimi i dhënë nga OE është i qenësishëm, pasi licenca profesionale e inxhinierit e paraqitur, jepet mbi bazën e diplomës që disponon inxhinieri, pra nuk mund të mendohet se mund të licencohet një person pa diplomën përkatëse. Po ashtu, bazuar në aktet ligjore, kontrolli teknik i automjeteve nuk mund të bëhet, pa likuiduar më parë taksën përkatëse. Nga ana e KVO nuk është përmendur në asnjë rast se si është kualifikuar OE “B.” Sh.p.k, ndërkohë që për një automjet nuk ka kontroll të vlefshëm, për dy automjete janë paraqitur polica sigurimi të cilave u ka kaluar afati si dhe nuk plotëson kriterin për numrin e punëtoreve të krahut.

Sa më sipër argumentet e paraqitura nuk justifikojnë skualifikimin nga gara të një operatori ekonomik për devijime të cilat nuk prekin në thelb ofertën e paraqitur dhe kualifikimin e një OE tjetër me ofertë më të lartë dhe me mangësi në dokumentacionin e paraqitur të ofertës. Në këto kushte, vërejtjet nuk qëndrojnë dhe nuk merren në konsideratë.

2. Mbi zbatimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje traversa druri hekurudhore normale dhe speciale” për vitin 2015.

a. Titulli i gjetjes: Përllogaritje e fondit limit me mangësi.

Situata: Nga ana e komisionit të përllogaritjes së fondit limit është aplikuar vetëm një alternativë dhe nuk janë marrë në konsideratë të tjerat, sidomos referimi tek kontratat e ngjashme të realizuara me sukses nga autoriteti kontraktor. Si pasojë kemi rritje artificiale të fondit limit i cili është përllogaritur nga 3 oferta të marra nga operatorë ekonomikë.

Kriteri: Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59, pika 2, përcaktohet:

“Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);

ose/dhe a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

Ndikimi/efekti: Si pasojë e mos marrjes në konsideratë të çmimit të kontratës realizuar nga vetë autoriteti kontraktor, përfunduar rreth 2 muaj para përllogaritjes së fondit limit është shkaktuar dëm ekonomik me vlerë 3,611,600 lekë.

Shkaku: Përdorimi i vetëm një alternative në përllogaritjen e fondit dhe mos marrja në konsideratë e alternativave të tjera.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandime: Komisioni i përllogaritjes së fondit limit duhet të dokumentojë përllogaritjen përkatëse, duke përdorur edhe alternativa të tjera siç është rasti i kontratave të ngjashme, sidomos për faktin se të njëjtat furnizime bëhen çdo vit nga ana e shoqërisë.

Nga auditimi rezultoi se:

Materiali teknik për procedurën e prokurimit është paraqitur nga Njësia e Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore (NjMIH) me shkresë nr. 467/5, datë 30.03.2015. Është kërkuar blerja e traversave druri me dimensione (2.6 x 0.26 x 0.16) m në sasinë 443 m³ dhe traversa speciale me dimensione (3.5 x 0.26 x 0.16) m në sasinë 40 m³. Në përshkrimin e arsytimit të blerjes, është përcaktuar se: *“Bazuar në rezultatet e kontrollit periodik të kryer në linjën hekurudhore kanë evidentuar domosdoshmërinë e ndërrimit të traversave të drurit të kalbura në linjë me traversa druri të reja në ndërruese, në hyrje dhe në dalje të stacioneve”*.

Urdhri i brendshëm për ngritjen e komisionit të përllogaritjes së fondit limit nr. 185/1, datë 29.01.2015, është nënshkruar nga z. E.D (Drejtuues i NjMIH). Komisioni përkatës përbëhet nga znj. M.K, z. M.B dhe z. Xh.B.

Përllogaritja e fondit limit është bërë duke iu referuar studimit të tregut. Është marrë ofertë nga 3 Operatorë ekonomikë (OE), ndër të cilët edhe subjektit “Z.” Sh.p.k, i cili ka paraqitur çmimin 72,500 lekë/m³ për traversa druri normale dhe 85,000 lekë/m³ për traversa speciale. Theksojmë se, bazuar në sistemin elektronik dhe dokumentacionin në dispozicion, ky OE me datën 23.07.2014, ka nënshkruar kontratë për furnizim me traversa normale me çmim 56,900 lekë/m³, për realizim kontrate me afat 3 muaj, pra për përfundim të furnizimit me datë 23.10.2014.

Sipas procedurës së mësipërme (vitit 2014), fondi limit është përcaktuar me vlerë 25,000,000 lekë për blerje të 416.7 m³ traversa normale, pra me çmim 60,000 lekë për m³.

Fondi limit për procedurën blerje traversa për vitin 2015 është llogaritur me vlerë 35,000,000 lekë (pa TVSH) për blerje materiale si më poshtë:

Përshkrimi i furnizimit	Njësia	Sasia	Çmimi lekë	Vlera lekë
Blerje traversa normale druri me dimensione (2.6 x 0.26 x 0.16) m	M ³	443	72,000	31,896,000
Blerje traversa speciale druri me dimensione (3.5 x 0.26 x 0.16) m	“	40	78,000	3,120,000
Shuma:				35,016,000

Nga ana e komisionit të përllogaritjes së fondit limit është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59, pika 2, përcaktohet:

*“Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:
çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura*



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);

ose/dhe a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës”.

Bazuar në kontratën e mëparshme, fondi limit duhet të përcaktohej si më poshtë:

Përshkrimi i furnizimit	Njësia	Sasia	Çmimi Viti 2014 lekë	Vlera lekë
Blerje traversa normale druri me dimensione (2.6 x 0.26 x 0.16) m	M ³	443	56,900	25,206,700
Blerje traversa speciale druri me dimensione (3.5 x 0.26 x 0.16) m	“	40	78,000	3,120,000
Shuma:				28,326,700

Sa më sipër fondi limit i parashikuar më tepër është me vlerë 6,673,300 lekë (35,000,000 lekë-28,326,700 lekë).

Duke marrë në konsideratë faktin se kontrata është nënshkruar me vlerë 31,938,300 lekë (pa TVSH), diferenca me vlerë 3,611,600 lekë (31,938,300 lekë - 28,326,700 lekë) përbën dëm ekonomik. Ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Përlllogaritjes së Fondit Limit i përbërë nga znj. M.K, z. M.B dhe z. Xh.B.

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje traversa druri hekurudhore normale dhe speciale” për vitin 2015.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 17, datë 05.05.2015	3. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
2. Iloji i Procedurës së Prokurimit I hapur	Urdhër nr. 17, datë 05.05.2015 T.P, juriste E.B L.D	Urdhër nr. 17/1, datë 05.05.2015 L.Gj A.N N.P
5. Fondi Limit (pa tvsh) 35,000,000 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 31,938,300	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 3,061,700 lekë
8. Data e hapjes së ofertave 28.05.2015	9. Burimi i Financimit Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender AL-A. Sh.p.k me ofertë 31,395,000 lekë Z. me ofertë 31,938,300 lekë b. Skualifikuar – 1 operator
11. Ankimime ska	12. Përgjigje e ankesës nga AK -	13. Përgjigje ankesës nga AKKP Shkresa nr.-
b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. lidhje e kontratës nr. ___, datë 01.07.2015	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 38,325,960 lekë	16. Likuiduar deri datë 31.12.2017 38,316,845 lekë



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

		Pa likuiduar: 9,587,187 lekë		
17. Situacioni përfundimtar /faturë malli/shërbimi datë x Vlerë -	18. afati i kontratës në ditë Parashikuar 120 ditë Realizuar 120 ditë	19. Zgjatja e kontratës me ditë -		
20. mbikëqyrësi i punimeve -	Licencë -	Kontrata -	Likuiduar -lekë	Pa likuiduar -lekë
21. kolaudatori i punimeve -	Licencë Nr.	Kontrata -	Likuiduar -lekë	Pa likuiduar -lekë
22. Akt Kolaudimi Datë-	23. Akt i marrjes në dorëzim Datë. 13.11.2015	24. Fletë Hyrja nr. 109, 114, 104, 132, 141		

Formulari i njoftimit të kontratës është botuar në Buletinin e APP nr. 18, datë 11.05.2015. Tenderi është hapur me datë 28.05.2015. Kanë marrë pjesë 2 OE. Subjektit “Al A.” Sh.p.k i është kërkuar sqarime nga ana e KVO me shkresë nr. 32, datë 03.06.2015, për mangësitë në dokumentacionin e paraqitur. Pas paraqitjes së dokumentacionit kanë rezultuar mangësi në lidhje me vulosjen e disa dokumenteve, apo mos përkthimin sipas rregullave, pasojë e të cilit është skualifikuar ky subjekt. Njoftimi i fituesit është botuar në Buletinin e APP nr. 24, datë 22.06.2015.

Kontrata është nënshkruar me datë 01.07.2015, me Kontraktorin “Z.” Sh.p.k, me vlerë 38,325,960 lekë. Kontrata i është dërguar për zbatim NjMIH me nr. 872, datë 02.07.2015.

Mbi zbatimin e kontratës së furnizimit.

Janë realizuar likuidimet si më poshtë:

Nr. rendor	Faturë tatimore		Hyrje në magazinë		Sasia m ³	Vlera lekë
	Nr.	Datë	Nr.	Datë		
1	13705896	11.08.2015	104	11.08.2015	129.79	10,294,942
2	13705900	01.09.2015	109	01.09.2015	77.8/6.6/6/11.3	8,090,865
3	21382457	23.09.2015	114	23.09.2015	127.6/2.7	10,343,847
4	21382472	30.10.2015	132	30.10.2015	107.7/0.4/6.6/6	9,957,193
	Shuma:				443/39.8	38,316,845
	Financuar					28,729,657

Për marrjen në dorëzim të materialeve, me urdhër nr. 1055/1, datë 06.07.2015, është ngritur komisioni i përbërë nga z. L.S, z. Ll.I dhe z. C.M.

Është mbajtur dokumentacion i rregullt për furnizimin e mallit, deri në bërjen hyrje në magazinë. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, si garancitë, fletë zhdoganimet, marrje në dorëzim dhe hyrje në magazinë, kontrata është përfunduar në afatin e përcaktuar.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Fondi limit nuk është përlogaritur duke patur në konsideratë ekonomikitetin, por duke përdorur alternativa të pa nevojshme, ndërkohë që në periudhën e përlogaritjes së këtij fondi, nga ana e autoritetit kontraktor është përfunduar një kontratë tërësisht e ngjashme, realizuar me çmime më të ulëta se të përlogaritura nga komisioni.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59, pika 2.



-Vlera 3,611,600 lekë përbën dëm ekonomik për shoqërinë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:

1. znj. M.K

2. z. M.B

3. z. Xh.B, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të përllogaritjes së fondit limit.

Komisioni i përllogaritjes së fondit limit ka paraqitur vërejtjet për rezultatet e auditimit protokolluar në KLSH me nr. 1313/7, datë 22.05.2018, si më poshtë:

Pretendohet se në kushtet kur INSTAT nuk ka shpallur çmime për traversa, për përllogaritjen e fondit limit është përdorur studimi i tregut si një nga alternativat e mundshme për t'u përdorur dhe është bërë në përputhje me ligjin.

Sqarojmë se studimi i tregut është bërë nëpërmjet paraqitjes së ofertave nga tre OE sipas kërkesës së komisionit. Nuk është marrë në konsideratë fakti se para tre muajsh nga përllogaritja e fondit limit, shoqëria ka realizuar me sukses një kontratë të ngjashme për blerje traversa, kontratë e cila realizohet çdo vit. Theksojmë se i njëjti komision, në procedurën e blerjes së traversave për vitin 2016 (trajtohet më poshtë), ka cilësuar se duke qenë një kontratë specifike, si çmim reference merret çmimi i kontratës së realizuar në vitin 2015, duke vepruar me dy standarde.

Veprimi i kryer duke rritur ndjeshëm vlerën e fondit limit është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore, të cilat në çdo rast parashikojnë mbrojtjen e interesave të autoritetit kontraktor. Mënyra e përzgjedhjes së procedurës së përllogaritjes së fondit limit nuk është dokumentuar, për të argumentuar mënyrën e përdorur të studimit të tregut.

Sa më sipër vërejtjet nuk merren në konsideratë.

3. Mbi auditimin e zbatimit të procedurës së prokurimit “Blerje traversa druri hekurudhore normale dhe speciale” për vitin 2016”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet që:

a. Titulli i gjetjes: Përllogaritje e fondit limit me mangësi.

Situata: Nga ana e komisionit të përllogaritjes së fondit limit në këtë procedurë është aplikuar alternativa e kontratave të ngjashme të realizuar nga autoriteti kontraktor, por është marrë për bazë kontrata me vlerë më të lartë.

Kriteri: Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59, pika 2, përcaktohet:

“Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);

ose/dhe a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit, duhet të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

Ndikimi/efekti: Si pasojë e marrjes si referencë e kontratës së ngjashme me vlerë më të lartë, është shkaktuar dëm ekonomik me vlerë 4,127,040 lekë.

Shkaku: Përdorimi i vetëm një alternative në përlllogaritjen e fondit dhe referimi tek kontrata e realizuar me çmimin më të lartë.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandime: Komisioni i përlllogaritjes së fondit limit duhet të dokumentojë përlllogaritjen përkatëse, duke përdorur edhe alternativa të tjera duke mbrojtur interesat e autoritetit kontraktor.

Nga auditimi konstatohet që:

Është argumentuar që nevojitet blerja e traversave normale në sasinë 523.4 m³ dhe traversa speciale në sasinë 45 m³.

Komisioni i përlllogaritjes së fondit limit përbëhet nga znj. M.K, z. M.B dhe z. Xh.B.

Në dokumentin e mbajtur nga komisioni për llogaritjen e fondit limit përcaktohet:

–“Çmime të publikuara nga entet shtetërore për “Blerje traversa druri hekurudhore normale dhe speciale të reja, **nuk ka**”.

–“Autoriteti kontraktor për vetë specifikën e këtij tenderi “Blerje traversa druri hekurudhore normale dhe speciale të reja) **për përcaktimin e fondit limit i është referuar eksperiencës së një viti më parë të realizuar me sukses nga vetë autoriteti kontraktor**”.

Për përcaktimin e fondit limit është aplikuar çmimi për traversa normale 66,100 lekë/m³ dhe për traversa speciale 66,400 lekë/m³.

Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59, pika 2,b përcaktohet:

“Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

b) **çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe**

Sa më sipër autoriteti kontraktor duhet t’i referojë kontratave të mëparshme dhe jo vetëm kontratës së një viti më parë e cila rezulton me çmim më të lartë se kontrata e realizuar në vitin 2014, apo 2013. Theksojmë se për traversat normale janë blerë në vitin 2013 me çmim 60,000 lekë/m³ dhe në vitin 2014 me çmim 56,900 lekë. Në këtë rast komisioni përkatës duhet t’i referojë çmimit më ekonomik të kontratave të realizuara. Është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2. b, ku përcaktohet:

“Qëllimi i këtij ligji është:

b. të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

Sqarojmë se, sipas përcaktimit të fondit limit për këtë procedurë (referenca tek kontrata të mëparshme të realizuara me sukses nga autoriteti kontraktor), duhet të veprohej edhe në procedurën e blerjes së traversave për vitin 2015.

Fondi limit është përcaktuar me vlerë 37,584,740.

Bazuar në kontratën e realizuar në vitin 2014, fondi limit duhet të ishte me vlerë si më poshtë:

Përshkrimi i furnizimit	Njësia	Sasia	Çmimi 2014 lekë	Çmimi 2016 lekë	Vlera e përcaktuar Lekë 1 x 3	Vlera e duhur Lekë 1 x 2
		1	2	3		



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

Blerje traversa normale druri me dimensione (2.6 x 0.26 x 0.16) m	M ³	523.4	56,900	66,100	34,596,740	29,781,460
Blerje traversa speciale druri me dimensione (3.5 x 0.26 x 0.16) m	“	45	70,000 (çmimi 2013)	66,400	2,998,000	3,150,000
Shuma:					37,584,740	32,931,460

Sa më sipër, fondi limit i përlogaritur më tepër është me vlerë 4,653,280 lekë (37,584,740 lekë – 32,931,460 lekë).

Duke marrë në konsideratë faktin se kontrata është nënshkruar me vlerë 37,058,500 lekë (pa TVSH), diferenca me vlerë 4,127,040 lekë (37,058,500 lekë - 32,931,460 lekë) përbën dëm ekonomik. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2. b, ku përcaktohet:

“Qëllimi i këtij ligji është:

b. të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

Ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Përlogaritjes së Fondit Limit i përbërë nga znj. M.K, z. M.B dhe z. Xh.B.

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje traversa druri hekurudhore normale dhe speciale” për vitin 2016.				
1. Urdhër Prokurimi nr. 463/2, datë 16.05.2016	3. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit		4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave	
2. lloji i Procedurës së Prokurimit I hapur	Urdhër nr. 17, datë 05.05.2015 T.P, juriste E.B L.D		Urdhër nr. 463/3, datë 16.05.2016 E.D L.S N.L	
5. Fondi Limit (pa tvsh) 37,583,334 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 37,058,500		7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 524,834 lekë	
8. Data e hapjes së ofertave 13.06.2016	9. Burimi i Financimit Buxheti i shtetit		10. Operatorët Ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender ALB SH. Sh.p.k me ofertë 37,058,500 lekë ALB-L. International me ofertë 37,483,152 lekë P. nuk ka paraqitur oferte E. S. nuk ka paraqitur ofertë b. Skualifikuar – 2 operator	
11. Ankimime ska	12. Përgjigje e ankesës nga AK -		13. Përgjigje ankesës nga AKKP Shkresa nr.-	
b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave				
14. lidhje e kontratës nr. ___, datë 12.07.2016	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 44,470,200 lekë		16. Likuiduar deri datë 31.12.2017 42,910,470 lekë Pa likuiduar: 4,559,730 lekë	
17. Situacioni përfundimtar /faturë malli/shërbimi datë x -	18. afati i kontratës në ditë Parashikuar 120 ditë Realizuar 143 ditë		19. Zgjatja e kontratës me ditë 23 ditë	
20. mbikëqyrësi i punimeve -	Licencë -	Kontrata -	Likuiduar -lekë	Pa likuiduar -lekë
21. kolaudatori i punimeve	Licencë	Kontrata	Likuiduar	Pa likuiduar



KONTROLLI I LARTË I SHITETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë "Hekurudha Shqiptare" SHA Durrës

-	Nr.	-	-lekë	-lekë
22. Akt Kolaudimi Datë-	23. Akt i marrjes në dorëzim		24. Fletë Hyrja nr.84-93	

Formulari i njoftimit të kontratës është botuar në Buletinin e APP nr. 21, datë 30.05.2016. Tenderi është hapur me datë 13.06.2016. Kanë marrë pjesë 4 OE. Njoftimi i fituesit është botuar në Buletinin e APP nr. 28, datë 18.07.2016.

Kontrata është nënshkruar me datë 02.07.2016, me Kontraktorin "Sh. AI" Sh.p.k, me vlerë 44,470,200 lekë. Kontrata i është dërguar për zbatim NjMIH me nr. 594, datë 12.07.2016.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Fondi limit nuk është përlogaritur duke patur në konsideratë ekonomikitetin, por duke përdorur alternativa të pa nevojshme, ndërkohë që në periudhën e përlogaritjes së këtij fondi, nga ana e autoritetit kontraktor është përfunduar një kontratë tërësisht e ngjashme, realizuar me çmime më të ulëta se ato të rezultuara.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 59, pika 2.

-Vlera 4,127,040 lekë përbën dëm ekonomik për shoqërinë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:

1. znj. M.K

2. z. M.B

3. z. Xh.B, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të përlogaritjes së fondit limit.

Komisioni i përlogaritjes së fondit limit ka paraqitur pretendimet për rezultatet e auditimit protokolluar në KLSH me nr. 1313/7, datë 22.05.2018, si më poshtë:

Pretendohet se në kushtet kur INSTAT nuk ka shpallur çmime për traversa, çmime të butuara nuk ekzistojnë si dhe duke marrë në konsideratë faktin se kjo kontratë është specifike, përdorur alternativa e kontratave të ngjashme, por është marrë si referencë kontrata me vlerë më të lartë, ajo për të cilën ky komision ka përlogaritur vlerën me rritje (trajtuar më sipër).

Veprimi i kryer duke rritur ndjeshëm vlerën e fondit limit është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore, të cilat në çdo rast parashikojnë mbrojtjen e interesave të autoritetit kontraktor.

Sa më sipër vërejtjet nuk merren në konsideratë.

4. Mbi auditimin e zbatimit të kontratës "Rikonstruksion i linjës hekurudhore Librazhd-Përrenjas (Lot I, Perigoni Librazhd-Xhyrë, km 99+400 deri km 111+800)".

a. **Titulli i gjetjes:** Mangësi në administrimin e kontratës së zbatimit.

Situata: Nga ana e Shoqërisë është shtyrë afati i punimeve pa shkaqe të përligjura. Disa zëra punimesh nuk janë realizuar konformë specifikimeve teknike.

Kriteri: Në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar neni 7.



Ndikimi/efekti: Kontraktori duhet të penalizohet për vonesa në përfundimin e punimeve me vlerë 663,298 lekë, si dhe është shkaktuar dëm ekonomik për punime të pa realizuara me vlerë 747,120 lekë.

Shkaku: Mos ndjekja e punimeve sipas përcaktimeve kontraktore.

Rëndësia: I mesëm.

Rekomandime: Autoriteti kontraktor, pavarësisht detyrimeve ligjore të mbikëqyrësit të punimeve, duhet të monitorojë hap pas hapi zbatimin e kontratës dhe të marrë vendimet e duhura konformë përcaktimeve ligjore e kontraktore.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet që:

Kontrata është nënshkruar me datë 02.12.2016, me Kontraktorin "B." Sh.p.k me vlerë 18,393,415 lekë. Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar deri me datë 31.12.2016.

Për mbikëqyrjen e punimeve është nënshkruar kontrata me Shoqërinë "GB E." përfaqësuar nga z. G.B, me datë 09.12.2016. Procesverbali për fillimin e punimeve është mbajtur me datë 09.12.2016, po ashtu njoftimi për fillimin e punimeve mban datën 09.12.2016. Bazuar në procesverbalin përkatës, punimet kanë përfunduar me datë 24.01.2017.

Bazuar në dokumentet e tenderit, Kontraktori ka paraqitur një kontratë për blerjen e traversave datë 29.10.2016 me kompaninë "H.", Bosnjë Hercegovinë. Bashkëngjitur observacioneve janë paraqitur fatura tatimore të blerjes së traversave nga Kontraktori, shoqëruar me garancinë, fletë origjine etj., por jo nga kontraktori i paraqitur në tender.

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike rezulton se:

Bazuar në preventivin e punimeve ishte parashikuar gërmimi me ekskavator i sasisë 1750 m³ dhera në kanale dhe 640 m³ gërmim me krah në për pastrim linje (në zonat e mbuluara me dhera), veprim i cili do të mundësonte lëvizjen e trenit në hekurudhë.

Në nenin 4 të kontratës është përcaktuar se punimet duhet të përfundojnë me datë 31.12.2016, në fund të vitit buxhetor. Me datë 05.01.2017, 5 ditë pas përfundimit të afatit të kontratës, kontratës bazë i është bërë shtesë që ka të bëjë me shtyrjen e afatit të punimeve deri me datë 24.01.2017, me argumentimin: "*Kjo shtesë e kontratës bëhet mbi bazën e kërkesës së ardhur nga kontraktori, në lidhje me problematikat në projektin e zbatimit, materialet sipas kontratës që do të transportoheshin me tren nuk mundësohen për shkak të gjendjes së linjës hekurudhore, e konfirmuar edhe nga mbikëqyrësi i punimeve...*".

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se transporti është realizuar me tren, vërtetuar nga pagesa e bërë nga Kontraktori për këtë qëllim dhe dokumentacioni i mbajtur nga shoqëria për këtë qëllim si për lëvizjen e lokomotivave ashtu dhe vagonëve përkatës për transport zhavori, në interes të kontraktorit "B." Sh.p.k. Sa më sipër kemi të bëjmë me shtyrje të afatit të kontratës, për argumente të cilat nuk kanë rezultuar në të vërtetë. Në këto kushte, bazuar në Kodin e Procedurave Administrative, kjo shtesë kontrate është e pavlefshme.

Nga verifikimi i dokumentacionit të punimeve, rezulton se deri me datë 31.12.2016, janë certifikuar punime me vlerë 11,484,054 lekë dhe punime të pa realizuara deri me këtë datë që përbën edhe datën e parashikuar për përfundimin e punimeve sipas kontratës, me vlerë 6,909,391 lekë. Bazuar në njoftimin përkatës, punimet kanë përfunduar me datë 24.01.2017, ose 24 ditë me vonesë.



Bazuar në nenin 7 të kontratës, për përfundim të punimeve përtej afatit të përcaktuar në kontratë, kontraktori duhet të penalizohet me vlerë 663,298 lekë (6,909,391 lekë x 4/1000 x 24 ditë).

Me datë 06.02.2018 dhe datë 21.03.2018, u verifikuan disa zëra punimesh në objekt, për distancën nga kilometër 101+800 deri në kilometër 107, nga ku rezultoi se:

-Pllakat shtruese kineze, nuk janë vendosur të reja por të përdorura, e vërtetuar nga amortizimi i lartë i tyre si dhe deformime. Po ashtu edhe gozhdët hekurudhore janë të amortizuara me ndryshk të theksuar, ndryshk i cili nuk mund të krijohet për një periudhë rreth 1 vit, referuar përfundimit të kontratës. Është likuiduar vlera 110,000 lekë për pllaka shtruese dhe vlera 260,000 lekë për gozhdë hekurudhore.

Vlera e 432,000 lekë [(100,000 lekë + 260,000 lekë) + TVSH], është përfituar padrejtësisht nga kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.

- Bazuar në librezën e masave, janë gërmuar dhera me ekskavator në sasinë 2560 m³ dhe gërmim me krah për pastrim në sasinë 760 m³ (në total 3320 m³). Bazuar në situacionin përfundimtar dhe të fondit rezervë është përshkruar gërmim me ekskavator në sasinë 2500 m³ dhe gërmim me krah në sasinë 720 m³ (gërmim në total 3220 m³). Sipas zërit "Transport dheu me auto deri 6 km", është certifikuar sasia 3590 m³. Në këto kushte është likuiduar më shumë transport me auto në sasinë 270 m³. ***Vlera 123,120 lekë (270 m³ x 380 lekë/m³ +TVSH), është përfituar padrejtësisht nga kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.***

- Nga verifikimi i shtresës së zhavorit rezulton se nuk është vendosur sipas përshkrimit në librezën e masave. Nga verifikimi (km 101+800 deri 102+200) rezulton se është shtruar distanca 100 ml, ndërkohë që në librezën e masave është përshkruar gjatësia 400 ml. Nga përlllogaritjet rezulton se sasia e përshkruar më tepër është në masën 120 m³ (300 ml x 0.4 m²). Në librezën e masave për këtë distancë, nuk janë detajuar përmasat e vendosjes së kësaj shtrese, por është përcaktuar vetëm seksioni tërthor me sipërfaqe 0.4 m² për ml.

-Nga verifikimi i dimensioneve të zhavorit të vendosur në distancën 900 ml nga kilometër 104+600 deri kilometër 105+500, rezulton se për një gjatësi 400 ml, sasia e vendosur është me seksion tërthor 0.2 m² dhe jo 0.4 m² sipas përshkrimit në librezën e masave, kryesisht mbi ura por edhe segmente të tjerë. Nga përlllogaritjet rezulton se është përfshirë më tepër sasia 80 m³ (400 ml x 0.2 m²).

Sa më sipër, vlera 192,000 lekë [(120 m³+ 80 m³) x 800 lekë/m³ +TVSH], është përfituar padrejtësisht nga kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.

Zhavorri i furnizuar nuk është në përputhje me specififikimet teknike sa i takon dimensioneve, ashtu edhe sasisë së përbërësve. Është hedhur në anë të rrugës pas asnjë rregull, i pa ngjeshur, duke mos arritur qëllimin për të cilin është vendosur.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar neni 7.

-Traversat jave vendosur pa respektuar kushtet teknike. Në shumë raste ato qëndrojnë në lartësi, nga mos vendosja dhe ngjeshje e shtresave, duke mos realizuar funksionin për të cilin janë vendosur.

- Sasia 481.9 m³ zhavor me vlerë 462,424 lekë, nuk është vendosur në zonën e kontratës, por në shembjen e linjës së Qukës, duke vërtetuar në këtë mënyrë, hartimin e kontratave pa studiuar siç duhet nevojën për ndërhyrje dhe ku është më emergjente.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:



Nuk është paraqitur dokumentacioni sipas kërkesave kontraktore dhe dokumentet e tenderit në lidhje me blerjen e traversave tek subjekti me të cilin është paraqitur kontrata e blerjes në dokumentet e tenderit (ofertë). Po ashtu nuk është paraqitur faturë tatimore, certifikatë garancie nga prodhuesi, apo dokument transporti. Nga verifikimi i punimeve në terren konstatohen punimet janë realizuar pa cilësinë e duhur, të shprehur në specifikimet teknike.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar neni 7.

Në kundërshtim me Kontratën neni 1, pika 1.2.

Në kundërshtim me Dokumentet e tenderit, shtojca 12 "Specifikimet teknike të ndërtimit të objektit

-Vlera 747,120 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë.

-Vlera 663,298 lekë, përbën penalitet të pambajtur për përfundim të punimeve jashtë afatit kontraktor.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:

1. Shoqëria "GB Civil E." Sh.p.k përfaqësuar nga z. G.B sa i takon punimeve.

2. z. I.D në cilësinë e ish-titullarit të autoritetit kontraktor.

3. z. A.D, në cilësinë e menaxherit të kontratës.

Sa më sipër është mbajtur Aktkonstatimi nr. 7/6, datë 23.03.2018.

5. Mbi auditimin e zbatimit të kontratës "Riaftësim traseje hekurudhore Lezhë, 2016".

a. **Titulli i gjetjes:** Mangësi në administrimin e kontratës së zbatimit.

Situata: Nga verifikimi i punimeve në objekt rezulton se shtresa e ballastit nuk është vendosur në trashësinë e përcaktuar në projektin e zbatimit.

Kriteri: Në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar neni 7.

Ndikimi/efekti: Nga përllogaritjet ka rezultuar se punimet e pa realizuara por të likuiduara janë në vlerën 779,760 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik.

Shkaku: Mos ndjekja e punimeve sipas përcaktimeve kontraktore.

Rëndësia: I mesëm.

Rekomandime: Autoriteti kontraktor, pavarësisht detyrimeve ligjore të mbikëqyrësit të punimeve, duhet të monitorojë hap pas hapi zbatimin e kontratës dhe të marrë vendimet e duhura konformë përcaktimeve ligjore e kontraktore.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet që:

Kontrata e punimeve civile është nënshkruar me datë 11.11.2016, ndërmjet Hekurudhës Shqiptare dhe Kontraktorit "Gj." Sh.p.k, me vlerë 3,009,372 lekë. Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur z. G.B.

Njoftimi për fillimin e punimeve është bërë më datë 12.11.2016. Njoftimi i përfundimit të punimeve mban datën 26.12.2016.

Me datë 07.03.2018, u bë verifikimi i disa zërave të punimeve të realizuara në objekt, kryesisht sa i takon shtresës së ballastit të vendosur në hekurudhë. U bënë sondazhe në segmentin 59+400



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë "Hekurudha Shqiptare" SHA Durrës

deri 59+700 dhe 62+500 deri 63+200. Nga gërmimet e kësaj shtrese në disa vende, mjaftueshëm për të arritur një konkluzion të saktë, rezultoi se shtesa e ballastit është ndërtuar në bazamentin e shtrirjes së traversave deri në lartësinë 16 cm, ndërkohë që kjo trashësi duhet të ishte 35 cm. Bazuar në librezën e masave sasia e ballastit të hedhur është në masën 1140 m³. Duke marrë në konsideratë gjerësinë e trupit të hekurudhës në nivelin e sipërm të traversave 3.4 m dhe gjerësinë në planin e vendosjes së traversave 3.8 m, nga përlogaritjet rezulton se është situacionuar më shumë sasia 684 m³ [(3.4 +3.8)/2 x 0.19 m x 1000 ml].

Sa më sipër, vlera 779,760 lekë (684 m³ x 950 lekë/m³ + TVSH), është përfituar padrejtësisht nga kontraktori "G.J." Sh.p.k dhe përbën dëm ekonomik.

Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar neni 7, ku përcaktohet:

"...Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit. Kur mbikëqyrësi i punimeve konstaton raste të ndryshimit të projektit, është i detyruar të njoftojë menjëherë inspektoratin ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut..."

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Punimet nuk janë realizuar sipas specifikimeve teknike që kanë të bëjnë kryesisht me trashësinë e shtresës së ballastit.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar neni 7.

-Vlera 779,760 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e shoqërisë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:

1. Shoqëria "GB C. E." Sh.p.k përfaqësuar nga z. G.B.

Sa më sipër është mbajtur Aktkonstatimi nr. 7/5, datë 23.03.2018.

6. Mbi auditimin e zbatimit të kontratës "Blerje traversa druri, për vitin 2016".

a. **Titulli i gjetjes:** Mangësi në administrimin e kontratës së zbatimit.

Situata: Nga ana e Shoqërisë është shtyrë afati i punimeve pa shkaqe të përligjura.

Kriteri: Në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar neni 7.

Ndikimi/efekti: Kontraktori duhet të penalizohej për vonesa në përfundimin e punimeve me vlerë 4,209,874 lekë.

Shkaku: Mos ndjekja e punimeve sipas përcaktimeve kontraktore.

Rëndësia: I mesëm.

Rekomandime: Autoriteti kontraktor, pavarësisht detyrimeve ligjore të mbikëqyrësit të punimeve, duhet të monitorojë hap pas hapi zbatimin e kontratës dhe të marrë vendimet e duhura konformë përcaktimeve ligjore e kontraktore.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet që:

Kontrata e furnizimit është nënshkruar me datë 12.07.2016, me Kontraktorin “Sh. Al” Sh.p.k, me vlerë 44,470,200 lekë. Afati i realizimit të furnizimit është përcaktuar 120 ditë dhe furnizimi duhet të përfundonte me datë 12.11.2016.

Janë realizuar pagesa si më poshtë:

Nr. rendor	Faturë tatimore		Hyrje në magazinë		Sasia m ³	Vlera lekë
	Nr.	Datë	Nr.	Datë		
1	29694923	03.10.2016	84	26.10.2016	63.9	4,998,880
2	34802953	02.11.2016	87	08.11.2016	21.6	1,684,800
3	34802956	07.11.2016	88	08.11.2016	21.6	1,684,800
4	34802954	08.11.2016	90	08.11.2016	21.6	1,684,800
5	34802955	08.11.2016	89	08.11.2016	21.6	1,684,800
6	34802958	21.11.2016	91	21.11.2016	21.6	1,684,800
7	34802959	21.11.2016	92	21.11.2016	21.6	1,684,800
8	34802963	21.11.2016	93	21.11.2016	18.6/1.16/0.95 0.67	1,675,980
9	34802589	28.12.2016	6	28.12.2016	185.3/11.7/8.06 11.82	16,967,370
10	34802593	29.12.2016	7	29.12.2016	107.3/2.44/7.36	9,169,440
11	34802597	30.12.2016	9	30.12.2016	18.47/1.14/0.33	1,559,730
	Shuma:					44,470,200
	Financuar					42,910,470

Për furnizimet sipas tabelës së mësipërme me nr. rendor 10, traversat nuk janë blerë në Rumani por nga subjekti “Gj.” Sh.p.k, Lezhë. Traversat janë pranuar dhe marrë në dorëzim datë 30.12.2016, nga komisioni i përbërë nga z. D.R, z. P.D dhe z. L.I.I.

Në procesverbalin e dorëzimit theksohet se sasia 117.18 m³ traversa normale me vlerë 6,979,700 lekë, janë blerë nga subjekti “Gj.” Sh.p.k Lezhë. Ky material është situacionuar në Elbasan dhe Fier.

Kontraktori “Sh. AL” ka blerë traversa druri nga Subjekti “Gj.” sh.p.k, subjekt i cili ka vërtetuar nëpërmjet dokumentacionit doganor se e ka blerë materialin në Mal të Zi, sipas faturës datë 28.07.2015. Bashkëngjitur dokumentit doganor subjekti “Gj. Sh.p.k, ka paraqitur edhe certifikatën e origjinës të prodhuesit “M.Z” Podgoricë, si dhe garancinë për traversat e furnizuara. Dokumentacioni i

Pranimi i këtij produkti të furnizuar nga një prodhues i ndryshëm nga ai i deklaruar në dokumentet e tenderit, është në kundërshtim me dokumentet e tenderit dhe me nenin **10** të kontratës ku përcaktohet:

“Kontraktuesi do ti dërgojë Autoritetit kontraktor dokumentet e mëposhtme:

- a. Origjinalin dhe dy kopje të faturës së kontraktuesit e cila përmban numrin e kontratës, përshkrimin e mallit, sasinë çmimin për njësi dhe vlerën totale.*
- b. Origjinalin ose dy kopje të noterizuara të certifikatës së origjinës.*
- c. Origjinalin ose dy kopje të noterizuara të certifikatës së garancisë se prodhuesit apo furnizuesit.*
- d. Origjinalin ose kopje të noterizuara të deklaratës doganore për sasinë e traversave të lëvruara”.*



Ngarkohet me përgjegjësi komisioni i marrjes në dorëzim i përbërë nga z. D.R z. Ll.I dhe z. P.D dhe Ish-Drejtori i NJBMIH z. E.D.

Kontratës i është bërë amendamenti nr. 1 me (pa numër), datë 07.10.2016. Ky amendament është bërë me arsyetimin “Kjo shtesë kontrate bëhet në bazë të kërkesës së ardhur nga kontraktuesi, në lidhje me pengesat e sjella nga Subjekti “Esenzitze” Rumani për shkak të remontit në fabrikë, kjo e konfirmuar me shkresën përkatës dhe në zbatim të nenit 6, nenit 12, pika 2 dhe nenit 15 të kontratës **nisur dhe nga fakti se afati i kontratës është plotësuar**, duke ju referuar edhe nenit 24 dhe 25.1 të kushteve të përgjithshme të kontratës të furnizimit me mallra, duke qenë se ekzistojnë kushtet për zgjatjen e afatit për interes publik të Blerësit, palët ranë dakord që kontrata të zgjasë vlefshmërinë e saj deri me datë **23.11.2016**”.

Kontraktori nuk ka paraqitur asnjë dokument në mbështetje të pretendimeve të tij.

Kontratës i është bërë amendamenti nr. 2, me nr. 954/3, datë 07.11.2016. Ky amendament është bërë me arsyetimin “Kjo shtesë kontrate bëhet në bazë të kërkesës së ardhur nga kontraktuesi, në lidhje me pengesat e sjella nga forca madhore (përmbytjet në Rumani), e konfirmuar nga shoqëria e transportit Caushi-Trans Tiranë, Shoqëri e cila është kontraktuar nga Shoqëria “Sh. AL”, për transportin e traversave nga Rumania, kjo e konfirmuar me shkresën përkatëse dhe në zbatim të nenit 6, nenit 12, pika 2 dhe nenit 15 të kontratës **nisur dhe nga fakti se afati i kontratës është plotësuar**, duke ju referuar edhe nenit 24, 25.1 dhe 22 të kushteve të përgjithshme të kontratës të furnizimit me mallra, duke qenë se ekzistojnë kushtet për zgjatjen e afatit për interes publik të Blerësit, palët ranë dakord që kontrata të zgjasë vlefshmërinë e saj deri me datë 20.12.2016”.

Në dosjen e prokurimit rezulton një njoftim i Shoqërisë “Caushi-Trans” kontraktuar për transportin e traversave nga “Sh. AL” Sh.p.k, pa numër dhe pa datë si dhe të pa protokolluar në Shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës, sipas të cilit, njoftohet Kontraktori “Sh. AL” se është e pamundur të realizohet parashikimi i kalendarit të transporteve, për shkak të motit të keq dhe përmbytjeve në Rumani. **Është kërkuar shtyrje afati për përfundimin e furnizimit me datë 23.12.2016.**

Po ashtu, në dosjen e prokurimit rezulton një njoftim i kontraktorit nr. 91, pa datë i pa protokolluar pranë Shoqërisë, sipas të cilit kërkohet shtyrje afatit të furnizimit deri me datë 25.12.2016.

Në nenin 6 të kontratës përcaktohet: “Lëvrimiti i traversave do të bëhet sipas grafikut të lëvrimit, brenda 120 ditëve kalendarike, afat ky që fillon që nga dita e nënshkrimit të kontratës”.

Në nenin 12 të kontratës përcaktohet: “12.1. Palët mund të bëjnë ndryshime në përmbajtjen e kontratës për aq sa e lejon ligji.

12.2. Shtesa të kësaj kontrate do të konsiderohen gjithë dispozitat shtesë të kontratës apo ofertës, të cilat nuk ndryshojnë elementët e tyre përbërës, duke përfshirë pa kufizuar vleftën, llojin, sasinë, dhe cilësinë e mallit, afatin e lëvrimit si dhe vendin e dorëzimit”.

Në nenin 15 të kontratës përcaktohet: “Do të konsiderohet forcë madhore çdo ngjarje që ndodh jashtë kontrollit të kontraktuesit dhe nuk përbën gabim apo neglizhencë nga ana e kontraktuesit dhe që nuk mund të parashikohet. Këtu bëjnë pjesë luftërat, zjarret, përmbytjet, tërmetet, epidemitë dhe embargot”.

Në lidhje me sa më sipër arrihet në konkluzionin se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë "Hekurudha Shqiptare" SHA Durrës

-Shtesa e parë e kontratës është bërë pa asnjë bazë. Remonti i fabrikës, nuk përbën forcë madhore, pasi është e parashikueshme, për më tepër që kontraktori ka kryer furnizime të rregullta.

-Forcën madhore për shkak të përmbytjeve në Rumani (nëse konsiderohet e tillë) nuk ka ndikuar për furnizimin, pasi kontraktori ka kryer furnizime të rregullta dhe konkretisht datë 03.10.2016, datat 02, 07, 08, 21.11.2016.

- Shtesa e kontratës është bërë deri me datë 20.12.2016, ndërkohë që nuk është aplikuar asnjë penalitet për dorëzim të vonuar.

- Shtesat e kontratës, janë bërë pa argumentime ligjore.

Sa më sipër, duke marrë në konsideratë faktin e shtyrjes së afatit deri me datë 20.12.2016 rezulton se pas kësaj date (38 ditë me vonesë) janë furnizuar traveta me vlerë si më poshtë:

Nr. rendor	Faturë tatimore		Hyrje në magazinë		Sasia m ³	Vlera lekë
	Nr.	Datë	Nr.	Datë		
4	34802589	28.12.2016	6	28.12.2016	185.3/11.7/8.06 11.82	16,967,370
5	34802593	29.12.2016	7	29.12.2016	107.3/2.44/7.36	9,169,440
6	34802597	30.12.2016	9	30.12.2016	18.47/1.14/0.33	1,559,730
	Shuma:					27,696,540

Bazuar në nenin 5, pika 1, të kushteve të kontratës, për dorëzim të vonuar kontraktori duhet të penalizohet me vlerë 4,209,874 lekë [27,696,540 lekë (vlera e pa realizuar) x 4/1000 x 38 ditë]. Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi z. I.D, në cilësinë e Ish-Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Juristi z. A.D dhe z. E.D.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Një sasi e traversave janë furnizuar pa dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit dhe kontratën përkatëse dhe nuk duhet të merrej në dorëzim. Kjo sasi traversash nuk garantohej nëse plotëson cilësinë dhe specifikimet teknike, po ashtu nuk ka garancinë e duhur sipas specifikimeve.

Kontrata e furnizimit është shtyrë në afat në kundërshtim me termat e saj dhe për rrethana të cilat nuk qëndrojnë, pra kemi të bëjmë me informim nga ana e kontraktorit të rrethanave të cilat nuk kanë ndikuar në zbatimin e kontratës.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

Dokumentet e tenderit dhe me nenin 10 të kontratës.

Në kundërshtim me nenin 6 të kontratës.

-Vlera 4,209,874 lekë përbën penalitet të pambajtur ndaj kontraktorit, për dorëzim të vonuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:

1. z. I.D, në cilësinë e Ish-Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

2. z. A.D, në cilësinë e juristit të shoqërisë.

3. z. E.D, në cilësinë e Ish-Drejtori i NJBMIH.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

4. z. D.R.

5. z. L.I.

6. z. P.D, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim.

Sa më sipër është mbajtur Aktkonstatimi nr. 7/4, datë 23.03.2018.

7. “Rinovim agregate për lokomotiva” viti 2017.

Njësina e Prokurimit e përbërë nga E.L, A.G dhe L.D dhe me Komisionin e Vlerësimit të Ofertave G.B, K.H dhe F.R, mbi zbatimin e procedurave të prokurimi, në objektin “Rinovim agregate për lokomotiva”, me këto të dhëna:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rinovim agregate për lokomotiva” për vitin 2017.				
1. Urdhër Prokurimi nr. 842/6, datë 21.11.2017	3. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit		4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave	
2. lloji i Procedurës së Prokurimit I hapur	Urdhër nr. 842/6, datë 21.11.2017 E.L A.G L.D		Urdhër nr. 842/7, datë 21.11.2017 G.B Kryetar K.A Anëtar F.R Anëtar	
5. Fondi Limit (pa tvsh) 6,850,000 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 6,180,000		7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh) 670,000 lekë	
8. Data e hapjes së ofertave 15.12.2017	9. Burimi i Financimit Buxheti i shtetit		10. Operatorët Ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender Z. Sh.p.k me ofertë 6,180,000 lekë b. Skualifikuar – 0 operator	
11. Ankimime ska	12. Përgjigje e ankesës nga AK -		13. Përgjigje ankesës nga AKKP Shkresa nr.-	
b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave				
14. lidhje e kontratës nr. ___, datë 26.12.2017	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 7,416,000 lekë		16. Likuiduar deri datë 31.12.2017 0 lekë Pa likuiduar: 7,416,000 lekë	
17. Situacioni përfundimtar /faturë malli/shërbimi datë x -	18. afati i kontratës në ditë Parashikuar deri më 31.12.2017 Realizimi më 29.12.2017		19. Zgjatja e kontratës me ditë	
20. mbikëqyrësi i punimeve -	Licencë -	Kontrata -	Likuiduar -lekë	Pa likuiduar -lekë
21. kolaudatori i punimeve -	Licencë Nr.	Kontrata -	Likuiduar -lekë	Pa likuiduar -lekë
22. Akt Kolaudimi Datë-	23. Akt i marrjes në dorëzim		24. Fletë Hyrja nr.	

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

-Kjo procedure prokurimi është iniciuar nga nevojat e Njesisë së Mjeteve të Lëvizshme për bazë materiale për vënie në punë të lokomotivave.

-Me shkresën nr. 337 prot. Datë 27.10.2017 drejtuesi i NJSHML A.H i dergon administratorit të shoqërisë specifikimet teknike të hartuara nga komisioni i përbërë nga H.B, M.J dhe Z.D për “rinovim agregate për lokomotiva” 1. Rinovim Indoto Gjenaratori, 2. Rinovim Indoto Motorr Traksioni, 3. Rinovim Indoto Dinamo e Kombinuar 4. Rinovim Motorr MÇO për nevojat e kësaj njësie.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

-Me shkresën nr. 357/1 prot. Datë 17.11.2017 drejtuesi i NJSHML A.H i dergon administratorit të shoqërisë fondin limit të përlogaritur nga ofertat e marra në treg nga operatorë të ndryshëm që ofrojnë këto shërbime.

Nga verifikimi i kontratave të mëparshme rezultoi se në HSH ekzistojnë kontrata të mëparshme me të njëjtën objekt por nga përlogaritja e vlerës së tyre me ofertat e marra për përlogaritjen e fondit limit rezultoi se fondi limit për këtë procedurë për vitin 2017 është rreth 5% më i ulët se vitet e mëparshme duke bërë që kjo procedure e përzgjedhur për përlogaritjen e fondit limit të jetë e suksesshme.

-Administratori i shoqërisë I.D ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 842/6 prot. datë 21.11.2017 për procedurën e prokurimit “Rinovim agregate për lokomotiva” me fond limit prej 6,850,000 lekë, si dhe njësinë e prokurimit e cila përbëhet nga: (E.L, A.G dhe L.D).

-Me Urdhër Nr. 842/7, datë 21.11.2017 është ngritur komisioni për vlerësimin e ofertave i përbërë nga G.B kryetarë, K.H dhe F.R anëtarë.

Me procesverbalin datë 15.12.2017 në NJSHML komisioni i vlerësimit të ofertave ngritur me urdhër Nr. 842/7, datë 21.11.2017 për procedurën e prokurimit me objekt “Rinovim agregate për Lokomotiva” ka hapur dhe verifikuar ofertat në sistemin elektronik ku rezultoi vetëm një pjesëmarrës “Z.” sh.p.k me ofertë 6,180,000 lekë pa TVSH 10% më pak se fondi limit.

Më datë 16.12.2017 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës për procedurën e prokurimit “Rinovim agregate për lokomotiva” në mbështetje të urdhrin të prokurimit nr. 842/6 datë 21.11.2017 për këtë procedurë me fond limit prej 6,850,000 lekë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për praninë kualifikim të paraqitura nga operatori ekonomik “Z.” sh.p.k KVO ka bërë vlerësimin përfundimtarë ku rezultoi se:

Shoqëria “Z.” sh.p.k me vlerë të ofertës 6,180,000 lekë pa TVSh kualifikohet.

Nga administratori i shoqërisë është nxjerrë formulari i njoftimit të fituesit në sistemin e APP.

Me kontratën nr. 1 Datë 26.12.2017 është lidhur kontrata midis autoritetit kontraktor Hekurudha Shqiptare SHA Durrës dhe operatorit ekonomik fitues “Z.” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Rinovim agregate për lokomotiva” me vlerë kontrate prej 6,180,000 lekë pa TVSH ose 7,416,000 lekë me tvsh.

-Nga verifikimi fizik në magazinat e NJSHML rezultoi se agregatet e rinovuar ishin gjendje në magazinë, pasi ishin verifikuar dhe marrë në dorëzim nga personat përgjegjës.

8. “Blerje aksesorë dhe pajisje hekurudhore” viti 2016.

Njësia e Prokurimit e përbërë nga E.L, A.G dhe L.D dhe me Komisionin e Vlerësimit të Ofertave E.D, A.K dhe M.V, mbi zbatimin e procedurave të prokurimit, në objektin “Blerje aksesorë dhe pajisje hekurudhore”, me këto të dhëna:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje aksesorë dhe pajisje hekurudhore” për vitin 2016.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 463/6, datë 12.07.2016	3. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit	4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
2. Iloji i Procedurës së Prokurimit I hapur	Urdhër nr. 17, datë 05.05.2015 E.L A.G L.D	Urdhër nr. 463/3, datë 16.05.2016 E.D Kryetar A.K Anëtar M.V Anëtar
5. Fondi Limit (pa tvsh) 6,666,667 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 5,780,000 lekë	7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

		886,667 lekë		
8. Data e hapjes së ofertave 15.08.2016	9. Burimi i Financimit Buxheti i shtetit	10. Operatorët Ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender “A.” shpk me ofertë 4,387,000 lekë “Z.” sh.p.k me vlerë ofertë 5,710,000 lekë “Sh. 07” sh.p.k me ofertë 5,780,000 lekë “T. T. C.” sh.p.k me vlerë oferte 6,528,000 lekë “A. L. I.” sh.p.k me oferte 6,560,000 lekë E. S. nuk ka paraqitur ofertë b. Skualifikuar – 2 operator		
11. Ankimime “A.” shpk	12. Përgjigje e ankesës nga AK 723/1 datë 15.9.2016	13. Përgjigje ankesës nga AKKP Vendim nr. 89/2016 04.11.2016		
b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave				
14. lidhje e kontratës nr. ___, datë 26.11.2016	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 6,936,000 lekë	16. Likuiduar deri datë 31.12.2017 6,936,000 lekë		
17. Situacioni përfundimtar /faturë malli/shërbimi datë x	18. afati i kontratës në ditë Parashikuar 120 ditë	19. Zgjatja e kontratës me ditë		
20. mbikëqyrësi i punimeve -	Licencë -	Kontrata -	Likuiduar -lekë	Pa likuiduar -lekë
21. kolaudatori i punimeve -	Licencë Nr.	Kontrata -	Likuiduar -lekë	Pa likuiduar -lekë
22. Akt Kolaudimi Datë-	23. Akt i marrjes në dorëzim	24. Fletë Hyrja nr.		

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

-Kjo procedure prokurimi është iniciuar nga nevojat e Njesisë së Biznesit Menaxhimit Infrastrukturës Hekurudhore për bazë materiale për mbajtjen në gjendje punë të hekurudhës.

-Me shkresën nr. 141/6 prot., datë 18.03.2016 drejtuesi i NJBMIH E.D i dërgon administratorit të shoqërisë specifikimet teknike të hartuara nga komisioni i përbërë nga M.K, Dashmir Recit dhe Ll.I për “Blerje aksesorë dhe pajisje hekurudhore” për nevojat e kësaj njësie.

-Me shkresën nr. 141/6 prot., datë 18.03.2016 drejtuesi i NJBMIH E.D i dërgon administratorit të shoqërisë fondin limit të përlogaritur nga ofertat e marra në treg nga operatorë të ndryshëm që ofrojnë këto shërbime konkretisht: “M.” sh.p.k, “Fort” sh.p.k dhe “A.” sh.p.k.

-Administratori i shoqërisë ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 463/6 prot. datë 12.07.2016 për procedurën e prokurimit “Blerje aksesorë dhe pajisje hekurudhore” me fond limit prej 6,666,667 lekë, si dhe ngarkon njësinë e prokurimit e përbërë nga E.L, L.D dhe A.G për zbatimin e këtij urdhri.

-Me Urdhër Nr. 463/10, datë 12.07.2016 është ngritur komisioni për vlerësimin e ofertave i përbërë nga E.D kryetarë, A.K dhe Miranda Veli anëtarë.

Me datë 08.08.2016 titullari i aturitetit kontraktor bën njoftimin në sistemin e app për modifikimin e dst, shtojca 8, për procedurën e hapur me objekt “Blerje Aksesorë dhe pajisje hekurudhore” konkretisht:

Ishte

Pika 2.1 kapaciteti ligjore i operatorit ekonomik:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

Për sa i përket përvojës së mëparshme kërkohet: Kontrata të ngjashme në njëvlerë jo më të vogël se 40% të fondit limit...

Bëhet

Pika 2.1 kapaciteti ligjore i operatorit ekonomik:

Për sa i përket përvojës së mëparshme kërkohet: Kontrata të ngjashme në njëvlerë jo më të madhe se 40% të fondit limit...

Nga analizimi i këtij kriteri të ndryshuar nga njësia e prokurimit të përbërë nga E.L, L.D dhe A.G si dhe miratuar nga ish-Administratori dukshëm i pa studiuar mira ose më saktë pa mbështetje logjike financiare dhe ligjore pasi një kontratë e realizuar me sukses në një vlerë edhe më të madhe se 40% e këtij fondi sillte një besueshmëri më të madhe ndaj operatorëve pjesëmarrës sesa një operatorë me eksperiencë të mëparshme nga 0% - 40% të fondit limit që prokurohet.

Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi njësia e prokurimit të përbërë nga E.L, L.D dhe A.G.

Me procesverbalin datë 15.08.2018 komisioni i vlerësimit të ofertave ngritur me urdhër Nr. 463/10, datë 12.07.2016 për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje aksesore dhe pajisje hekurudhore” ka hapur dhe verifikuar ofertat në sistemin elektronik ku rezultoi si më poshtë;

1. Shoqëria “A.” shpk me vlerë oferte 4,387,000 lekë pa tvsh
2. Shoqëria “Z.” sh.p.k me vlerë oferte 5,710,000 lekë pa TVSH
3. Shoqëria “Sh.07” sh.p.k me vlerë oferte 5,780,000 lekë pa TVSH
4. Shoqëria “T. T. C.” sh.p.k me vlerë oferte 6,528,000 lekë pa TVSH
5. Shoqëria “A. L. I.” sh.p.k me vlerë oferte 6,560,000 lekë pa TVSH
6. Shoqëria “E. S.” sh.p.k pa ofertë

Me procesverbalin datë 06.09.2018, komisioni i vlerësimit të ofertave ngritur me urdhër Nr. 463/10, datë 12.07.2016 për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje aksesore dhe pajisje hekurudhore” vendosi të bëjë klasifikimin e ofertave si më poshtë:

1. Shoqëria “A.” shpk me vlerë oferte 4,387,000 lekë pa tvsh,
Nuk kualifikohet për arsye se:
 - a. Nuk plotëson kriterin mbi numrin e të punësuarve (vetë 2 vete për 3 muajt e fundit)
 - b. Mungon vërtetimi i regjistrimit të kompanisë furnizuese në regjistrat tregtarë të shtetit ku operon.
 - c. Mungon certifikata ISO 14001:2004
 - d. Mungon vërtetimi i pagesës së taksave vendore
2. Shoqëria “Z.” sh.p.k me vlerë oferte 5,710,000 lekë pa TVSH
Nuk kualifikohet për arsye se:
 - a. Mungon vërtetimi i regjistrimit të kompanisë furnizuese në regjistrat tregtarë të shtetit ku operon.
 - b. Mungon vërtetimi i pagesës së taksave vendore
3. Shoqëria “Sh. 07” sh.p.k me vlerë oferte 5,780,000 lekë pa TVSH
Kualifikohet
4. Shoqëria “T.T.C” sh.p.k me vlerë oferte 6,528,000 lekë pa TVSH
Kualifikohet
5. Shoqëria “A. L. I.” sh.p.k me vlerë oferte 6,560,000 lekë pa TVSH



Kualifikohet

6. Shoqëria “E.S” sh.p.k pa ofertë

-Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave është kryer me 6 ditë vonesë përtej afatit të lejuar veprime në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 i ndryshuar neni 66 pika 2 ku citohet Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, përveç rasteve të tjera të cilësuar ndryshe në këto rregulla, veprim që ngarkon me përgjegjësi komisionin e vlerësimit të ofertave të përbërë nga E.D, A.K dhe M.V.

-Pas vlerësimit të ofertave më datë 09.09.2016 pranë Hekurudha Shqiptare sha është paraqitur ankesa nga operatori ekonomik “A.” shpk duke kundërshtuar skualifikimin e tij dhe pretenduar të kundërtën.

-Me shkresën nr. 723/1 prot datë 15.09.2016 administratori i shoqërisë pas verifikimit të ankesës i kthen përgjigje operatorit ekonomik “A.” shpk ku mban të njëjtin qëndrim si KVO në mos plotësim të kushteve nga operatori ekonomik e për rrjedhojë mos kualifikimin e tij.

-Me shkresën nr. 749 prot., datë 21.09.2016 Komisioni i prokurimit publik sjell vendimin nr. 2003/1 datë 20.09.2016 për pezullimin e procedurës pas ankesës së operatorit ekonomik “A.” shpk.

-Me shkresën nr. 723/3 prot., datë 21.09.2016 titullari i autoritetit kontraktor ka nxjerrë vendimin për pezullimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje aksesore dhe pajisje hekurudhore”.

-Me shkresën nr. 689/5 prot., datë 23.09.2016 titullari i autoritetit kontraktor ka dërguar informacion Komisionit të prokurimit publik në lidhje me vendimin nr. 2003/1 datë 20.09.2016 të K.P.P si dhe dokumentacionin përkatës në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

-Me shkresën nr. 839/1 prot., datë 04.11.2016 Komisioni i prokurimit publik ka dërguar vendimin nr. 89/2016prot. Datë 04.11.2016 i cili ka vendosur:

Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “A.” shpk për procedurën e prokurimit “Blerje aksesore dhe pajisje hekurudhore” me nr. Ref-45050-07-15-2016 me fond limit 6,666,667 lekë.

Më datë 11.11.2016 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës për procedurën e prokurimit “Blerje aksesore dhe pajisje hekurudhore” në mbështetje të urdhrit të prokurimit nr. 463/10 datë 12.07.2016 për këtë procedurë me fond limit prej 6,666,667 lekë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për praninë kualifikim të paraqitura nga operatorët ekonomik, më datë 06.09.2016 KVO ka bërë vlerësimin përfundimtarë ku rezultoi se:

1. Shoqëria “A.” shpk me vlerë oferte 4,387,000 lekë pa tvsh,

Nuk kualifikohet për arsye se:

- a. Nuk plotëson kriterin mbi numrin e të punësuarve (vetë 2 vete për 3 muajt e fundit)
- b. Mungon vërtetimi i regjistrimit të kompanisë furnizuese në regjistrat tregtarë të shtetit ku operon.
- c. Mungon certifikata ISO 14001:2004
- d. Mungon vërtetimi i pagesës së taksave vendore

2. Shoqëria “Z.” sh.p.k me vlerë oferte 5,710,000 lekë pa TVSH

Nuk kualifikohet për arsye se:

- a. Mungon vërtetimi i regjistrimit të kompanisë furnizuese në regjistrat tregtarë të shtetit ku operon.
- b. Mungon vërtetimi i pagesës së taksave vendore



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

3. Shoqëria “Sh. 07” sh.p.k me vlerë oferte 5,780,000 lekë pa TVSH
Kualifikohet
4. Shoqëria “T.T.C” sh.p.k me vlerë oferte 6,528,000 lekë pa TVSH.
Kualifikohet
5. Shoqëria “A. L. I.” sh.p.k me vlerë oferte 6,560,000 lekë pa TVSH
Kualifikohet
6. Shoqëria “E. S” sh.p.k pa ofertë.

Mbështetur në ligjin nr. 9643 datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime rendisim në vend të parë operatorin ekonomik “Sh. 07” shpk me ofertën më të ulët të kualifikuar për shpallje fitues.

Nga administratori i shoqërisë është nxjerrë formulari i njoftimit të fituesit në sistemin e APP me datë 11.11.2016 me operator ekonomik “Sh. 07” shpk.

Me kontratën nr. 6 Datë 24.11.2016 është lidhur kontrata midis autoritetit kontraktor Hekurudha Shqiptare SHA Durrës dhe operatorit ekonomik fitues “Sh. 07” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Blerje aksesorë dhe pajisje hekurudhore” me vlerë kontrate prej 5,780,000 lekë pa TVSH 13.5% më pak se fondi limit ose 6,963,000 lekë me tvsh.

-Nga verifikimi në sistemin elektronik dhe dosjes fizik operatori ekonomik i plotëson kriteret për kualifikim. Për sa i përket verifikimit fizik të mallit kjo ishte e pamundur si rezultat i vendosjes në hekurudhë të këtyre pajisjeve e aksesorëve.

9. “Riaftësimi i trasesë hekurudhore Milot-Lezhë”.

Njësia e Prokurimit e përbërë nga T.P, E.B dhe L.D dhe me Komisionin e Vlerësimit të Ofertave P.P, M.S dhe A.D, mbi zbatimin e procedurave të prokurimi, në objektin “Riaftësimi i trasesë hekurudhore Milot-Lezhë”, me këto të dhëna:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia prokurimit
1. Urdhër Prokurimi prot. datë 15.07.2014 2. Vlera e përlogaritur e kontratës 5,700,837 lekë, pa TVSH 3. Tender; Procedurë e Hapur (me mjete elektronike) 4. Data e zhvillimit të tenderit 20.08.2014 5. Fituesi "B." sh.p.k 6. Data e lidhjes së kontratës: 29.09.2014 7. Vlera e kontratës: 5,074,900 lekë pa TVSH. 8. Vlera me TVSH: 6,089,8800 lekë	P.P Kryetar M.S Anëtar A.D Anëtar	T.P E.B L.D
Kanë paraqitur oferta në tender, 4 operatorë ekonomik.	Kualifikuar 2 O.E	

Kontrata e punimeve riaftësim linje Milot-Lezhë, për vitin 2014, është nënshkruar me datë 29.09.2014, me Kontraktorin "B." Sh.p.k, me vlerë 6,089,880 lekë. Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur Shoqëria "G." Sh.p.k, me përfaqësues z. A.D.

Kontrata përfshin punime demontimi, shtresash, ngritje linje, vendosje traversa druri të reja, për distancat:

1.Linja hekurudhore ne km 59+700 – 59+850.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë "Hekurudha Shqiptare" SHA Durrës

2.Linja hekurudhore ne km 60+000 – 60+400.

3.Linja hekurudhore ne km 61+000 – 61+400.

4.Linja hekurudhore ne km 61+750- 61+800.

Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 60 ditë.

Punimet kanë filluar me datë 22.10.2014. Bazuar në procesverbalin përkatës, punimet kanë përfunduar me datë 08.12.2014, brenda afatit të rishikuar, për arsye të përmytjeve.

Situacioni përfundimtar është miratuar me vlerë 5,785,386 lekë.

Sa i përket punimeve të realizuara nga zbatimi i kësaj kontrate, nuk u bënë verifikime në terren, për faktin se ka kaluar një periudhë e gjatë nga zbatimi dhe kemi të bëjme me amortizim të tyre, si dhe për faktin se në vite, në linjën hekurudhore Milot-Lezhë, janë bërë edhe ndërhyrje të tjera nga vetë shoqëria.

U verifikua dokumentacioni nga ku rezultoi se:

Për blerjen e traversave është paraqitur dokumentacioni i cili është noterizuar me nr. 1512/1, datë 22.11.2014, nga noter z. K.B. Dokumenti doganor i përket datës 14.11.2014. Traversat janë blerë nga subjekti "M. BB Z. 2." Crna Gora. Në këtë dokument doganor përcaktohet se kanë hyrë në doganë 33 m³, ose 27000 kg lëndë drusore traversa hekurudhore **të përdorura**, të pa paketuara (rifuxho). Edhe në Urdhrin e çlirimit faturë nr. 2014, M, 320, është përcaktuar traversa hekurudhore të përdorura. Pranimi dhe vendosja e traversave të përdorura është në kundërshtim me specifikimet teknike të kontratës dhe preventivin e punimeve. Bazuar në situacionin përfundimtar, për zërin "F.V traversa druri të reja normale", është likuiduar sasia 136 copë, me çmim 4,500 lekë/copë, me vlerë 612,000 lekë. **Sa më sipër, nga ana e Kontraktorit "B." Sh.p.k, është përfutuar padrejtësisht vlera 733,400 lekë (612,000 lekë + TVSH), vlerë e cila përbën dëm ekonomik.**

Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar neni 7, ku përcaktohet:

"...Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit. Kur mbikëqyrësi i punimeve konstaton raste të ndryshimit të projektit, është i detyruar të njoftojë menjëherë inspektoratin ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut..."

Për veprimet e mësipërme mban përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve Shoqëria "G." Sh.p.k, përfaqësuar nga z. A.D.

10. "Sigurimi i shërbimit me SHRSF për stacionin e mallit dhe udhëtarit Vlorë" viti 2015.

Njësia e Prokurimit e përbërë nga T.P, E.B dhe L.D dhe me Komisionin e Vlerësimit të Ofertave P.P, A.D dhe B.Gj, si dhe grupi i shqyrtimit të ankesës Sh.Gj, V.M dhe N.P mbi zbatimin e procedurave të prokurimi, në objektin "Sigurimi i shërbimit me SHRSF për stacionin e mallit dhe udhëtarit Vlorë", me këto të dhëna:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
-----------------------	------------------------------------	---------------------



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

1. Urdhër Prokurimi prot.2 datë 12.02.2015	P.P Kryetar	T.P
2. Vlera e përlogaritur e kontratës 5,245,684 lekë, pa TVSH	A.D Anëtar	E.B
3. Tender; Procedurë e Hapur (me mjete elektronike)	B.Gj Anëtar	L.D
4. Data e zhvillimit të tenderit 09.03.2015		
5. Fituesi "S." sh.p.k		
6. Data e lidhjes së kontratës: 10.05.2015		
7. Vlera e kontratës: 5,151,600 lekë pa TVSH.		
8. Vlera me TVSH: 6,181,920 lekë		
Kanë paraqitur oferta në tender, 5 operatorë ekonomik.	Kualifikuar 3 O.E	

b. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

-Kjo procedure prokurimi është iniciuar nga nevojat e Njesisë së Biznesit Menaxhimit Infrastrukturës Hekurudhore për ruajtjen e ambienteve të stacionit hekurudhorë Vlorë mallit dhe udhëtarit.

-Me shkresën nr. 1874 prot. Datë 06.11.2014 drejtuesi i NJBMIH E.D krijon komisionin për llogaritjen e fondit limit si dhe përcaktimin e specifikimeve teknike për objektin e prokurimit “Sigurimi i shërbimit me SHRSF për stacionin e mallit dhe udhëtarit Vlorë” të përbërë nga M.S, S.P dhe E.Z.

-Me shkresën nr. 1874/1 prot. Datë 20.11.2014 drejtuesi i NJBMIH E.D i dërgon administratorit të shoqërisë fondin limit të përlogaritur si dhe specifikimet teknike.

-Administratori i shoqërisë ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 2 prot., datë 12.02.2015 për procedurën e prokurimit “Sigurimi i shërbimit me SHRSF për stacionin e mallit dhe udhëtarit Vlorë” me fond limit prej 5,245,684 lekë, si dhe ngarkon njësinë e prokurimit e përbërë nga E.L, L.D dhe A.G për zbatimin e këtij urdhri.

-Me Urdhër Nr. 2/1, datë 12.02.2015 është ngritur komisioni për vlerësimin e ofertave i përbërë nga P.P kryetarë, A.D dhe B.Gj anëtarë.

Me procesverbalin datë 09.03.2015 komisioni i vlerësimit të ofertave ngritur me urdhër Nr. 2/1, datë 12.02.2015 për procedurën e prokurimit me objekt “Sigurimi i shërbimit me SHRSF për stacionin e mallit dhe udhëtarit Vlorë” ka hapur dhe verifikuar ofertat në sistemin elektronik ku rezultoi si më poshtë;

1. Shoqëria “S.” shpk me vlerë oferte 5,151,600 lekë pa tvsh

Me procesverbalin datë 24.03.2015 komisioni i vlerësimit të ofertave ngritur me urdhër Nr. 2/1, datë 12.02.2015 për procedurën e prokurimit me objekt “Sigurimi i shërbimit me SHRSF për stacionin e mallit dhe udhëtarit Vlorë” vendosi të bëjë klasifikimin e ofertave si më poshtë:

1. Shoqëria “S.” shpk me vlerë oferte 5,151,600 lekë pa tvsh,

Nuk kualifikohet për arsye se:

- a. Referuar C.V se aktivitetit të kësaj shoqërie, rezulton se nuk disponohet salla operative me pajisjet përkatëse dhe grupin e gatshëm, referuar pikës 11 kriteret e veçanta...
- b. Automjetet e disponuara nga shoqëria janë paraqitur pa siguracione e kolaudime për vitin 2015...



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

-Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave është kryer në ditën e 15 të afatit maksimal të lejuar referuar VKM nr. 914 datë 29.12.2014 i ndryshuar neni 66 pika 2.

-Pas vlerësimit të ofertave më datë 26.03.2015 pranë Hekurudha Shqiptare sha është paraqitur ankesa nga operatori ekonomik “S.” shpk duke kundërshtuar skualifikimin e tij dhe pretenduar të kundërtën.

-Me shkresën nr. 392/1 prot., datë 30.03.2015 administratori i shoqërisë ka nxjerrë vendimin për pezullimin e procedurës së prokurimit si dhe ka ngarkuar sektorin juridik të përbërë nga Sh.Xh, V.M dhe N.P dhe njësinë e prokurimit për shqyrtimin e e ankesës.

-Me shkresën nr. 392/2 prot., datë 31.03.2015 administratori i shoqërisë referuar konkluzione të hartuara nga grupi i verifikimit të ankesës Sh.Xh, V.M dhe N.P të cilët dalin në përfundimin se: skualifikimi i këtij operatori është padrejtë si dhe Urdhërojmë rivlerësimin e ofertës për operatorin ekonomik “S.” sh.p.k nga ana e KVO.

Në bazë të këtij relacioni ka dalë dhe shkresa e administratorit të shoqërisë drejtuar shoqërisë “S.” sh.p.k shkresë e konceptuar nga Sh.Xh dhe miratuar nga H.D.

Referuar ligjit nr. 9643 datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si dhe vkm nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime neni 78 pika 6. E cila citon:

Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm:

- a) ...Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa...

Komisioni i ngritur për shqyrtimin e ankesës ka vepruar dukshëm në kundërshtim me ligjin, ai jo vetëm që ka dhënë një orientim të gabuar për titullarin e autoritetit kontraktor por edhe ka urdhër KVO për rivlerësimin e ofertës së këtij operatori duke vepruar pa kompetencë dhe tagër ligjorë veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Sh.Xh V.M dhe N.P.

-Me shkresën nr. 392/3 prot., datë 08.04.2015 titullari i autoritetit kontraktor ka nxjerrë vendimin për heqjen e pezullimit të procedurës së prokurimit me objekt “Sigurimi i shërbimit me SHRSF për stacionin e mallit dhe udhëtarit Vlorë”.

Me procesverbalin datë 15.04.2015 komisioni i vlerësimit të ofertave ngritur me urdhër Nr. 2/1, datë 12.02.2015 për procedurën e prokurimit me objekt “Sigurimi i shërbimit me SHRSF për stacionin e mallit dhe udhëtarit Vlorë” nisur nga shkresa nr. 392/2 prot., datë 31.03.2015 e administratorit të shoqërisë ka bërë rivlerësimin e procedurës së prokurimit referuar relacionit të komisionit për shqyrtimin e ankesave vendosi të kualifikojë operatorin ekonomik “S.” shpk me vlerë oferte 5,151,600 lekë pa tvsh,

Anëtari i KVO A.D ka bërë kundërshtimet e tij dhe nuk ka pranuar të kualifikojë këtë operator ku i ka dërguar dhe shkresë znj. T.P me detyrë Kryetare e njësisë së prokurimit.

Me shkresën nr. 70 prot., datë 16.04.2015, znj. T.P i kthen përgjigje anëtarit të KVO për skualifikim të gabuar nga KVO dhe veprim sipas ligjit të anëtarit të saj nëse ka kundërshtime reflektimin e tyre në procesverbal.

Më datë 29.04.2015 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës për procedurën e prokurimit “Sigurimi i shërbimit me SHRSF për stacionin e mallit dhe udhëtarit Vlorë” në mbështetje të urdhrit të prokurimit nr. 2 datë 12.02.2015 me fond limit prej 5,245,684 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për praninë kualifikim të paraqitura nga operatorët ekonomik, më datë 06.09.2016 KVO ka bërë vlerësimin përfundimtarë ku rezultoi se:

1. Shoqëria “S.” shpk me vlerë oferte 5,151,600 lekë pa tvsh, Mbështetur në ligjin nr. 9643 datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime rendisim në vend të parë operatorin ekonomik “S.” shpk (operator i vetëm pjesëmarrës) për shpallje fitues.

Nga administratori i shoqërisë është nxjerrë formulari i njoftimit të fituesit në sistemin e APP me datë 04.05.2015 me operator ekonomik “S.” shpk.

Me kontratën nr. 2 Datë 12.05.2015 është lidhur kontrata midis autoritetit kontraktor Hekurudha Shqiptare SHA Durrës dhe operatorit ekonomik fitues “S.” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Blerje aksesorë dhe pajisje hekurudhore” me vlerë kontrate prej 5,151,600 lekë pa TVSH 2% më pak se fondi limit ose 6,181,920 lekë me tvsh.

-Nga verifikimi në sistemin elektronik dhe dosjes fizik operatori ekonomik për sa i përket Automjeteve të disponuara nga shoqëria janë paraqitur pa siguracione e kolaudime për vitin 2015 e për rrjedhojë nuk mund të merren si të mirëqena pasi me to nuk mund të qarkullohet e për rrjedhojë nuk janë në gjendje gatishmëri në funksion të kontratës. Nisur nga sa më sipër për rrjedhojë kjo procedurë duhej anuluar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- z. E.L, Kryetare e njësisë së prokurimit*
- znj. A.G anëtare e njësisë së prokurimit*
- znj. L.D, anëtarë i njësisë së prokurimit*
- z. E.D, kryetar i KVO*
- z. A.K, anëtarë i KVO*
- znj. Miranda Veli, anëtare e KVO*
- z. Sh.Xh, shqyrtues ankese*
- znj. V.M, shqyrtues ankese*
- znj. N.P, shqyrtues ankese*
- z. A.D, mbikëqyrës punimesh*

IV.8 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet që:

-Strukturat përgjegjëse të “Hekurudha Shqiptare“, nuk kanë pasur dijëni dhe nuk kanë zbatuar rekomandimet e auditit të mëparshëm të KLSH mbi kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Hekurudha Shqiptare SHA nuk ka një kuptim të mirëfilltë të të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ‘Për menaxhimin financiar dhe kontrollin’, i ndryshuar.

-Grupi i auditimit të KLSH konstaton se nuk janë përcaktuar **nëpunësi autorizues (NA)** dhe ai **zbatues (NZ)**, si dhe nuk është dërguar NJQHMFK në Ministrinë e Financave në afatet e përcaktuara dhe informacione mbi NA dhe NZ nuk i janë dërguar Degës së Thesarit Tiranë. Kjo



bie në kundërshtim me nenin 12 të “**Ligjit nr. 10296 , datë 8.07.2010**,” *Nëpunësi zbatues, duhet të jetë niveli menaxherial në vartësi direkt të Administratorit. Gjithashtu në funksionet e tij, Drejtori Ekonomik mbulon çështjet e planifikimit, zbatimit të buxhetit, kontabilitetit, monitorimit, si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të konsoliduar të njësisë në përputhje me kërkesat e ligjit në fuqi*. Nuk ka asnjë person të autorizuar për të kryer funksionet e përcaktuara më sipër dhe të jetë në vartësi direkt të Administratorit. Ka dalë një urdhër nga Administratori dhe kanë nisur procedurat për të përcaktuar NA dhe NZ që nuk përkon me periudhën objekt auditimi 2015-2017.

Përsa më sipër mban përgjegjësi ish-Titullari i Hekurudha Shqiptare. SHA për periudhën objekt auditimi 2015-2017

-Grupi i auditimit vëren se te Hekurudha Shqiptare SHA nuk janë hartuar **gjurmët e auditimit** të detajuara për procedurat kryesore, bazuar në gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlera të vogla dhe të larta dhe në bazë të detyrimeve të pikës nr. 3 të Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 92 prot., datë 29.12.2011. Pra, **nuk ka hartim, miratim dhe arkivim të kësaj gjurme**, veprime këto në përmbushje të kërkesave të nenit 16, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të detyrimeve të kapitullit III të “Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, miratuar nga Ministri i Financave me Urdhër nr. 54, datë 15.07.2010. Kjo bie në kundërshtim me “Nenin 16” të “**Ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010**”, **Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit**, pika 2. *“Titullarët e njësisë publike miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit”*.

Përsa më sipër mban përgjegjësi ish-Titullari i Hekurudha Shqiptare sh.a për periudhën objekt auditimi 2015-2017

-Nga ana e institucionit nuk janë përgatitur **Pyetësorët e Vetëvlerësimit, Deklarata** për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të brendshëm dhe Raporti Vjetor për Funksionimin e Sistemeve të Kontrollit të brendshëm për vitin 2015 dhe 2016. Rrjedhimisht për këto dy vite nuk janë nënshkruar nga Administratori dhe nuk i janë dërguar Ministrisë së Financave. Kjo bie në kundërshtim me “Nenin 18” të “**Ligjit nr. 10296 , datë 8.07.2010**”, “**Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm**” pika 1, *“Nëpunësi autorizues i njësisë publike depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual. Për të realizuar detyrimin e tij, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të zbatojë një sistem të brendshëm raportimi për të marrë informacion nga njësitë e varësisë, për të mbështetur deklaratën, sipas këtij ligji*” dhe pika 2. *“Nëpunësi i parë autorizues përgatit dhe depoziton te Ministri i Financave raportin vjetor të konsoliduar jo më vonë se fundi i muajit prill, duke u mbështetur në raportet, sipas pikës 1 të këtij neni, për kontrollin e brendshëm të sektorit publik”*. Në zbatim të programit të auditimeve për vitin 2017, i miratuar nga Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë HSH sh.a. Durrës, me nr. 13 prot., datë 22.11.2016 Sektori i Auditimit të brendshëm realizoi një angazhim auditimi



tematik, në Njësinë e Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse nga 10 deri me 31 Maj 2017 dhe vazhdim. Ka dalë urdhër nr 218 nga Administratori me datën 15.03.2018 dhe kanë nisur procedurat për të përgatitur pyetësorët e vetëvlerësimit dhe deklaratat që nuk përkon me periudhën objekt auditimi 2015-2017.

Përsa më sipër mban përgjegjësi Drejtori Drejtorisë Ekonomike dhe ish-Titullari i Hekurudha Shqiptare Sh.a për periudhën 2015-2017

-Audituesit e KLSH-së konstatojnë se nuk janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e **Regjistrit të Risqeve**, monitorimin e kontrolleve të risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive. Nga ana e Administratorit nuk është caktuar një koordinator risku, I cili të bashkërendojë veprimtaritë që lidhen me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve. Kjo bie në kundërshtim me “Nenin 9” të **“Ligjit nr. 10296 , datë 8.07.2010”**, *“Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”*, pika c) *“monitorimin e kontrolleve të risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë që menaxhojnë”*; dhe me Nenin 10 **“Përgjegjshmëria menaxheriale e koordinatorit të riskut”** pika 2, *“Koordinatori i riskut është përgjegjës për: a) bashkërendimin e veprimtarive që lidhen me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë dhe ngritjen e sistemit për menaxhimin e riskut, në përpjesëtim me përmasat e tij; b) këshillimin dhe dhënien e instruksioneve menaxherëve të tjerë të njësisë publike, në bashkëpunim me njësinë qendrore të harmonizimit, për menaxhimin financiar dhe kontrollin; c) paraqitjen e raportit të përgjithshëm të risqeve të njësisë publike tek titullari i njësisë publike dhe grupi i menaxhimit strategjik të njësisë publike”*.

Ka dalë një urdhër i Titullarit në vitin 2018, (periudhë që nuk përkon me periudhën objekt auditimi 2015-2017), *“Për ngritjen dhe funksionimin e grupit të menaxhimit strategjik të MFK dhe të Riskut të “Hekurudha Shqiptare SHA”*

-Grupi i auditimit të KLSH u fokusua në funksionimin menaxherial të realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij për të gjithë komponentët si : **“mjedisi i kontrollit”, “menaxhimi i riskut”, “aktivitetet e kontrollit”, “informimi dhe komunikimi” “monitorimi”**.

-Nga auditimi i detyrimeve që burojnë në kuadër të **përgjegjshmërisë menaxheriale të titullarit** së Hekurudha Shqiptare , parashikuar në pikën 8 të nenit 8 të ligjit nr. 10296, konstatohet se, janë kryer detyrimet që lidhen me hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e objektivave të Shoqërisë, të planeve vjetore dhe plan-veprimet për arritjen e objektivave si dhe miratimin e një strukture të përshtatshme organizative dhe vendosjen e linjave të raportimit, që mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësisë të tyre. Nga auditimi është konstatuar se, në kundërshtim me nenin 9, pika 5, nenin 12 dhe nenin 15 të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, në këtë institucion nuk funksionon *delegimi i detyrave*. Në kundërshtim me ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin si dhe me nenin 51, të Statutit të Hekurudha Shqiptare, institucioni nuk ka të miratuar një strategji zhvillimi ku të përcaktohen qëllimet dhe objektivat zhvillimore strategjike të tij në tërësi.

- Hekurudha Shqiptare nuk ka në dispozicion dokumentacion për privatizimin e objekteve dhe shesheve që janë privatizuar. Objektet e privatizuara figurojnë akoma të regjistruara në regjistrin e Hekurudha Shqiptare. Hekurudha Shqiptare nuk disponon urdhër të pronarit (ish-Ministria e



Transporteve) që autorizon sektorin e pronave të përgatisë dokumentacionin për privatizimin e objekteve. Kjo detyrë mbulohet në rregulloren e Brendshme në pikën 38 nga Sektori i Pronave.

Përsa më sipër mban përgjegjësi Sektori i Pronave.

-Etika personale dhe profesionale.

Auditimi konstaton se nuk është hartuar Kodi Etik.

Njësia në mbështetje të kuadrit ligjor ekzistues, nuk ka hartuar rregulloren “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, si dhe nuk ka hartuar rregulloren “Për etikën”. Lidhur me shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave në këtë drejtim, nuk është iniciuar asnjë procedurë e tillë.

Shoqëria nuk ka procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara. Nga ana e Drejtorisë së Personelit, nuk është hartuar një rregullore për standardet e sjelljes, pra nuk rezulton të jenë miratuar.

Në rregulloren e Brendshme të Hekurudha Shqiptare, nuk ka të përcaktuar në asnjë rast rregullat e etikë personale dhe profesionale në punë. Ka dalë një urdhër nga Drejtoria e personelit për vlerësimin e performancës në punë, me nr 227 datë 26.02.2018, që nuk përkon me periudhën objekt auditimi 2015-2017

Përsa më sipër mban përgjegjësi ish-Drejtori i Shërbimeve Mbështetëse të Hekurudha Shqiptare SHA për periudhën 2015-2017.

Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të auditit të brendshëm.

Shoqëria disponon një Rregullore të Brendshme të Punës, e aprovuar me Vendimin nr. 3, datë 14.06.2013 Këshillit Mbikëqyrës të Hekurudha Shqiptare SHA, ku janë përcaktuar detyrat për punonjësit. Hekurudha Shqiptare ka në strukturë një drejtori të **auditimit të brendshëm**, e miratuar me Urdhrin nr 69 datë 29.10.2010 të Ministrit të Financave, si instrument efektiv për paralajmërimin e mangësive, shkeljeve dhe parregullsive në realizimin e përgjegjësisë shtetërore dhe për vlerësimin e efikasitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Në bazë të strukturës organike të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, Drejtori i Auditit të Brendshëm emërohet e lirohet nga detyra me Vendim të KM, me propozim të Administratorit të Shoqërisë.

-Auditimi i brendshëm ka miratuar programet vjetore në Këshillin Mbikëqyrës, ka realizuar auditimet e programuara e raportuar çdo tremujor në drejtorinë e shoqërisë dhe në këshillin mbikëqyrës, dhe ka rekomandime për masa disiplinore që nuk janë zbatuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

z. I.D, në cilësinë e Ish-Administratori i Shoqërisë.

z. E.D, në cilësinë e Ish-Drejtori Njesisë Biznes Menaxhimit Infrastrukturës Hekurudhore.

z. A.P, në cilësinë e Drejtorit Ekonomik të Shoqërisë.

znj. D.O, në cilësinë e Shefes së Sektorit të Pronave.



IV.9. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet që:

-Kontratat e lidhura me subjektet private për vitet 2015-2017, nuk kanë Stemen e Hekurudhës, intestimin “Republika e Shqipërisë”, emërtimin e organit shtetëror dhe strukturës përkatëse, në kundërshtim me “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, kapitulli II-B, “Përpilimi, shtypja, shumëfishimi dhe evidencimi i dokumenteve”, neni 12, dalë në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, në të cilin është përcaktuar se: *“Dokumentet që dalin nga organi shtetëror duhet të kenë: Stemen e Republikës, intestimin “Republika e Shqipërisë”, emërtimin e organit shtetëror dhe strukturës përkatëse (nëse ka të tillë), numrin e regjistrimit të korrespondencës (Mod. 1), vendin dhe datën, shkurtimin e lëndës, adresën e korrespondentit, formulën “në përgjigje” ose “vijim të shkresës” (kur është rasti), numrin e lidhjeve (kur ka), tekstin e dokumentit, funksionin, emrin e mbiemrin e personit që nënshkruan dokumentin dhe nënshkrimin e tij, si dhe vulën. Data dhe numri i protokollit vendosen pas firmosjes nga titullari. Ekzemplari i dokumentit që mbahet në sekretari apo sekretari-arkiv siglohet edhe nga përpiluesi dhe përgjegjësi i sektorit. Në të shënohet edhe sasia e ekzemplarëve të shtypur.*

-Nuk ka autorizim nga Administratori i Shoqërisë për monitorimin e kontratave nga Njësia e Dhënies me Qira. Kjo bie në kundërshtim me nenin 14 pika 3 e Statutit të Shoqërisë, dhe neni 5 pika 4 e rregullores së Hekurudhës Shqiptare Sha për lidhjen e kontratave.

-Njësia e Infrastrukturës ka bërë të mundur lidhjen e kontratave me subjektet private për vitet 2015-2017 me sipërfaqe mbi 200 m² për afat kohor 1 vjeçar duke i përjashtuar nga konkurrimi. Kjo bie në kundërshtim me **Vendimin nr. 54**, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, I, “Pasuritë shtetërore që jepen me qira ose emfiteozë, kriteret e konkurrimit, e drejta, kompetencat dhe afatet”, pika 3, **“Kriteret e konkurrimit për dhënien me qira të pasurisë shtetërore janë si më poshtë vijon:- niveli i investimit; - niveli i punësimit;- oferta e detyrimit mujor të qirasë. Institucionet qendrore dhe vendore mund të vendosin edhe kriteret e tjera shtesë”** dhe pika 6, *“Të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë dhe të përcaktimit të afateve të dhënies me qira e kanë”*: b) **“organi, që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore të institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore, që jep me qira deri në 20 vjet: i) sipërfaqe mbi 200 m²”**.

-Njësia e Infrastrukturës ka bërë të mundur lidhjen e kontratave me subjektet private për vitet 2015-2017 me sipërfaqe “Truall i lirë” deri në 200 m² duke i përjashtuar nga konkurrimi dhe në kundërshtim me **Vendimin nr. 54**, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, I, *“Pasuritë shtetërore që jepen me qira ose emfiteozë, kriteret e konkurrimit, e drejta, kompetencat dhe afatet”* **“Institucionet, ndërmarrjet a shoqëritë shtetërore nuk mund të japin me qira vetëm “truall të lirë” me sipërfaqe deri në 200 m²”**. Kjo bie në kundërshtim me Udhëzimin nr. 6756, datë 3.9.2015 “Për zbatimin e vendimit të këshillit të ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata



të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar 4. Me termin **“truall i lirë”**, të shprehur në pikën 2 të kreut të I-rë dhe në pikën 2 të kreut të III-të të VKM-së, do të kuptohen rastet, kur sipërfaqja është **shesh i lirë** (por jo tokë bujqësore, ose tokë e pafrytshme).

-Në shumë dosje nuk gjendet propozimi për dhënien me qira ose emfiteozë të objektit, i cili përmban propozimin për veprimtarinë që mund të ushtrohet në këtë pasuri, vendimi i organit drejtues të institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore (këshilli mbikëqyrës) dhe miratimi i ministrisë së linjës. Ky veprim është në kundërshtim me Vendimin nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, pika a) *“Propozimin për dhënien me qira ose emfiteozë të objektit, i cili përmban propozimin për veprimtarinë që mund të ushtrohet në këtë pasuri”*.

-Në asnjë dosje nuk gjendet procesverbali ku të përfshihet gjendja fizike e pronës, vlera kontabël e objektit që jepet me qira, sipas llogarive financiare të vitit paraardhës, apo pamje fotografike të momentit, në kundërshtim me Vendimin nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, pika VI “Monitorimi i kontratave”, pika 2 ku përcaktohet: *“Njësia monitoruese e kontratave të qirasë ose të emfiteozës kryen këto detyra: “Pas lidhjes së kontratës së qirasë ose të emfiteozës, bën dorëzimin të qiramarrësi ose emfiteozëmarrësi me procesverbal të objektit të përshkruar në kontratë, sipas gentplanit përkatës. Në procesverbal përshkruhet qartë gjendja fizike e pronës, vlera kontabël e objektit që jepet me qira ose emfiteozë, sipas llogarive financiare në fund të vitit paraardhës dhe shoqërohet me pamje fotografike të momentit”*. Njësia e shërbimeve është e përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e kontratave sipas procedurave standarde për dhënien me qira të aseteve hekurudhore konform legjislacionit. Kjo është e përcaktuat dhe në rregulloren e brendshme të Hekurudha Shqiptare neni 13 i sajë.

-Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” SHA, nuk ka përfunduar procesin e regjistrimit të aseteve në Z.V.R.P.P përkatëse, përjashtim bën vetëm godina e Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudha Shqiptare SHA ,dhe ky regjistrim ka qenë i pjesshëm pasi ka përfunduar vetëm për objektin, ndërkohë për truallin është në proces. Në kundërshtim me VKM nr. 120 datë 04.03.2004 pika 2 *“Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit”*.

Nga auditimi me përzgjedhje i kontratave të lidhura dhe procedurave për dhënien me qira ose emfiteozë të pasurive shtetërore nga Hekurudha Shqiptare sh.a, për periudhën e auditimit, rezultoi si më poshtë:

Gjatë vitit 2015 rezulton se:

-Kontratë qiraja pa numër, datë 17.11.2015, lidhur me shoqatën Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave. Mungon kërkesa për vitin 2015 e këtij Inspektorati drejtuar Hekurudha Shqiptare Sh.A.

-Kontratë qiraja pa numër, datë 06.05.2015, lidhur me personin fizik A.T me nr NIPT-i J73312239M. Shkresat janë pa nr rendor. Kërkesa drejtuar Shoqërisë është pa datë. Hekurudha Shqiptare ka lidhur kontratë për 200 m² sipërfaqe të brendshme dhe 5 m² sip.funksionale. Kjo bie në kundërshtim me Vendimin nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, pika



5) “Përjashtohen nga konkurrimi: a) dhënia me qira e sipërfaqeve deri në 200 m², të cilat jepen me afat deri në 1 vit;” dhe pika 6. Të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë dhe të përcaktimit të afateve të dhënies me qira e kanë: i) objekte që ka në administrim, me sipërfaqe deri në 200 m² (ku të jetë përfshirë dhe sipërfaqja funksionale);”.

Njësia e dhënies me qira ka dhënë një sipërfaqe prej 205 m², duke përjashtuar nga konkurrimi subjektin qiramarrës.

Përsa më sipër mban përgjegjësi drejtorja e biznes menaxhimit infrastrukturës të Hekurudha Shqiptare.

Gjatë vitit 2016 rezulton se:

-Kontratë qiraja pa numër, datë 04.04.2016, lidhur me shoqatën e invalidëve të punës Lezhë. Mungon genplani i objektit, në 6 (gjashtë) kopje origjinale, të hartuar nga eksperti topograf i licencuar dhe të konfirmuar nga drejtuesi i institucionit shtetëror, data e lidhjes së kontratës. Në akt dorëzimit të kësaj kontrate nga shoqëria të qiramarrësi mungon data e marrjes në dorëzim të objektit dhe propozimi për veprimtarinë që mund të ushtrohet në këtë pasuri.

-Kontratë qiraja pa numër, datë 04.04.2016, lidhur me Shoqërinë “Y. Sh.P.k”. Mungon genplani i objektit, në 6 (gjashtë) kopje origjinale, të hartuar nga eksperti topograf i licencuar dhe të konfirmuar nga drejtuesi i institucionit shtetëror. data e lidhjes së kontratës. Në akt dorëzimit të kësaj kontrate nga shoqëria të qiramarrësi mungon data e marrjes në dorëzim të objektit dhe propozimi për veprimtarinë që mund të ushtrohet në këtë pasuri.

-Kontratë qiraja pa numër, datë 01.05.2016, lidhur me personin fizik Dritan Kasa me nr NIPT-i K63418201G. Shkresat janë pa nr rendor. Dritan Kasa në kërkesën drejtuar Shoqërisë kërkon 100 m², Hekurudha Shqiptare ka lidhur kontratë për 200 m² sipërfaqe të brendshme dhe 5 m² sip.funksionale. Kjo bie në kundërshtim me kërkesën e të interesuarit dhe Vendimin nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, pika 5) “Përjashtohen nga konkurrimi: a) dhënia me qira e sipërfaqeve deri në 200 m², të cilat jepen me afat deri në 1 vit;” dhe pika 6. Të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë dhe të përcaktimit të afateve të dhënies me qira e kanë: i) objekte që ka në administrim, me sipërfaqe deri në 200 m² (ku të jetë përfshirë dhe sipërfaqja funksionale);”.

Njësia e dhënies me qira ka dhënë një sipërfaqe prej 205 m², duke përjashtuar nga konkurrimi subjektin qiramarrës.

-Kontratë qiraja pa numër, datë 01.09.2016, lidhur me personin fizik Donald Balukja me nr NIPT-i L62906202O. Shkresat janë pa nr rendor. Dritan Kasa në kërkesën drejtuar Shoqërisë kërkon 200 m², të sheshit që është në krah të vinçit pranë stacionit hekurudhor Elbasan. Hekurudha Shqiptare ka lidhur kontratë për 200 m² “Shesh i lirë funksional”. Kjo bie në kundërshtim me Vendimin nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, I, “Pasuritë shtetërore që jepen me qira ose emfiteozë, kriteret e konkurrimit, e drejta, kompetencat dhe afatet”, pika 6, “Institucionet, ndërmarrjet a shoqëritë shtetërore nuk mund të japin me qira vetëm “truall të lirë” me sipërfaqe deri në 200 m²”. Kjo bie në kundërshtim edhe me Udhëzimin nr. 6756, datë 3.9.2015 “Për zbatimin e vendimin të këshillit të ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 “për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar 4. Me termin “**truall i lirë**”, të shprehur në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

pikën 2 të kreut të I-rë dhe në pikën 2 të kreut të III-të të VKM-së, do të kuptohen rastet, kur sipërfaqja është **shesh i lirë** (por jo tokë bujqësore, ose tokë e pafrytshme).

Njësia e dhënies me qira ka dhënë një “Shesh të lirë funksional” në kundërshtim të plotë me V.K.M nr 54 datë 05.02.2014.

-Kontratë qiraja pa numër, datë 04.04.2016, lidhur me personin fizik Shpëtim Qosja me nr NIPT-i L32910201A. Shkresat janë pa nr rendor. Sh.Q në dy kërkesa të ndryshme drejtuar Shoqërisë kërkon 200 m² të sheshit dhe 48 m² “Zyrë” që sipas genplanit paraqitur janë të ngjitura në krah të stacionit hekurudhor Krastë, Elbasan. Hekurudha Shqiptare ka lidhur kontratë për 200 m² “Shesh i lirë funksional”. Kjo bie në kundërshtim me Vendimin nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, I, “Pasuritë shtetërore që jepen me qira ose emfiteozë, kriteret e konkurrimit, e drejta, kompetencat dhe afatet”, pika 6, “*Institucionet, ndërmarrjet a shoqëritë shtetërore nuk mund të japin me qira vetëm “truall të lirë” me sipërfaqe deri në 200 m²”*. Hekurudha Shqiptare ka lidhur kontratë për objektin “Zyrë” me sipërfaqe 48 m² dhe funksionale 10 m². Njësia e dhënies me qira i ka dhënë në total personin fizik Shpëtim Qosja **258 m²**, duke e ndarë në dy kontrata të ndryshme pasurinë shtetërore.

-Njësia e dhënies me qira ka dhënë një “Shesh të lirë funksional” në kundërshtim të plotë me VKM nr 54 datë 05.02.2014. Nga verifikimi i Gent-Planit rezultoi se të dy pasurit e përfituara rrjedhin nga e njëjta pasuri mëme por qe e paraqitur ne Gent-Plan si dy pasuri të ndara. Njësia e dhënies me qira ka ndarë në dy kontrata të ndryshme pasurinë në funksion të sajë. Nisur nga këto të dhëna vihet re një stimulim për personin fizik Shpëtim Qosja duke e shmangur nga konkurrenca e ndershme dhe mënjeluar konkurrimin. Nga ana e Hekurudha Shqiptare SHA pas miratimit të vendimit për dhënien me qira Dokumentacion duhej përcillej pranë Ministrisë së Ekonomisë për lidhje kontrate, duke qenë se sipërfaqja e tejkalon **200 m²** në zbatim Vendimin nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, I, “Pasuritë shtetërore që jepen me qira ose emfiteozë, kriteret e konkurrimit, e drejta, kompetencat dhe afatet”.; *Për objektet e përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 6 të kapitullit i të këtij vendimi, pas përgatitjes së dokumentacionit, drejtuesi i ndërmarrjes, shoqërisë apo institucionit shtetëror, që ka në administrim objektin që do të jepet me qira ose emfiteozë, e përcjell atë në organin që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore, i cili, me urdhër të titullarit të tij, vazhdon procedurat për dhënien me qira ose emfiteozë të pasurisë shtetërore.*

-Kontratë qiraja pa numër, datë 04.04.2016, lidhur me personin fizik M.D me nr NIPT-i L32504204F. Shkresat janë pa nr rendor. Nuk ka kërkesën drejtuar Shoqërisë. Hekurudha Shqiptare ka lidhur kontratë për 200 m² sipërfaqe të brendshme dhe 5 m² sip.funksionale. Kjo bie në kundërshtim me Vendimin nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” , pika 5) “*Përfshihen nga konkurrimi: a) dhënia me qira e sipërfaqeve deri në 200 m², të cilat jepen me afat deri në 1 vit;*” dhe pika 6. *Të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë dhe të përcaktimit të afateve të dhënies me qira e kanë: i) objekte që ka në administrim, me sipërfaqe deri në 200 m² (ku të jetë përfshirë dhe sipërfaqja funksionale);”*.

Njësia e dhënies me qira ka dhënë një sipërfaqe prej 205 m², duke përjashtuar nga konkurrimi subjektin qiramarrës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

-Kontratë qiraja pa numër, datë 04.04.2016, lidhur me personin fizik Arsi Tanaj me nr NIPT-i J73312239M. Shkresat janë pa nr rendor. Kërkesa drejtuar Shoqërisë është pa datë. Hekurudha Shqiptare ka lidhur kontratë për 200 m² sipërfaqe të brendshme dhe 5 m² sip.funksionale. Kjo bie në kundërshtim me Vendimin nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, pika 5) “Përfshihen nga konkurrimi: a) dhënia me qira e sipërfaqeve deri në 200 m², të cilat jepen me afat deri në 1 vit;” dhe pika 6. Të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë dhe të përcaktimit të afateve të dhënies me qira e kanë: i) objekte që ka në administrim, me sipërfaqe deri në 200 m² (ku të jetë përfshirë dhe sipërfaqja funksionale);”.

Njësia e dhënies me qira ka dhënë një sipërfaqe prej 205 m², duke përjashtuar nga konkurrimi subjektin qiramarrës.

Përsa më sipër mban përgjegjësi drejtoria e biznes menaxhimit infrastrukturës të Hekurudha Shqiptare.

Gjatë vitit 2017 rezultoi se:

-Kontratë qiraja pa numër, datë 21.02.2017, lidhur me personin fizik V.Sh me nr NIPT-i L44317401L. Mungon genplani i objektit, në 6 (gjashtë) kopje origjinale, të hartuar nga eksperti topograf i licencuar dhe të konfirmuar nga drejtuesi i institucionit shtetëror. Mungon kërkesa drejtuar institucionit, kopja e kartës së identitetit të qiramarrësit si dhe data e lidhjes së kontratës. Në akt dorëzimit e kësaj kontrate nga shoqëria të qiramarrësi mungon data e marrjes në dorëzim të objektit dhe propozimi për veprimtarinë që mund të ushtrohet në këtë pasuri.

-Kontratë qiraja pa numër, datë 28.12.2017, lidhur me personin fizik M.D me nr NIPT-i L32504204F. Shkresat janë pa nr rendor. Hekurudha Shqiptare ka lidhur kontratë për 200 m² sipërfaqe të brendshme dhe 5 m² sip.funksionale. Kjo bie në kundërshtim me Vendimin nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, pika 5) “Përfshihen nga konkurrimi: a) dhënia me qira e sipërfaqeve deri në 200 m², të cilat jepen me afat deri në 1 vit;” dhe pika 6. Të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë dhe të përcaktimit të afateve të dhënies me qira e kanë: i) objekte që ka në administrim, me sipërfaqe deri në 200 m² (ku të jetë përfshirë dhe sipërfaqja funksionale);”.

Njësia e dhënies me qira ka dhënë një sipërfaqe prej 205 m², duke përjashtuar nga konkurrimi subjektin qiramarrës.

Përsa më sipër mban përgjegjësi drejtoria e biznes menaxhimit infrastrukturës të Hekurudha Shqiptare.

-Nga auditimi i procedurave për arkëtimin e kontratave të qirasë për periudhën objekt auditimi rezultoi se: Hekurudhës Shqiptare SHA nga mos arkëtim i detyrimeve të kontratave të qirave, i kanë shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik në vlerën prej **vlerë 1,295,943 lekë**.

-Nga mos llogaritja dhe faturimi i kamatëvonesave të likuidimit të detyrimeve sipas kushteve të kontratës, buxhetit të Shtetit, ju ka shkaktuar një dëm ekonomik në **vlerën 2,976,739 lekë** në kundërshtim me pikën 6.3 të nenit 6 të Kontratës së Qirasë ku thuhet: **“Qiramarrësi” Detyrohet të paguaj detyrimin mujorë të qirasë brenda afatit të përcaktuar në këtë kontratë. Për çdo ditë vonesë do të paguaj një kamatë ditore prej 1 % të vlerës së qirasë mujore.**

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:



-Nga auditimi i procedurave për arkëtimin e kontratave të qirasë për periudhën objekt auditimi rezultoi se: Hekurudhës Shqiptare SHA nga mos arkëtim i kontratave të qirave në fund të vitit 2016 ka një debi prej **730,287.00** lekë, ndërsa në fund të vitit 2017 kjo debi rezulton në **139,969.00** lekë. Gjithashtu nga auditimi i mandat pagesave të kontratave të qirasë. Rezultojë se në shumicën e rasteve jenë kryer me vonesë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

z. E.D, në cilësinë e Ish-Drejtori Njesisë Biznes Menaxhimit Infrastrukturës Hekurudhore

z. P.P, në cilësinë e Nëndrejtorit të Njesisë Biznes Menaxhimit Infrastrukturës Hekurudhore

z. L.S, në cilësinë e Inxhinierit të Njesisë Biznes Menaxhimit Infrastrukturës Hekurudhore

IV. 10. Përdorimi i subvencioneve shtetërore.

“Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës, është subvencionuar nga Buxheti i Shtetit për ndihmë shtetërore për transportin e udhëtarëve në vitin 2015 në vlerën 440,000,000 lekë, në vitin 2016 në vlerën 440,000,000 lekë dhe në vitin 2017 në vlerën 440,000,000 lekë. Pra në total në vlerën 1,320,000,000 lekë.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u krye auditim me zgjedhje dhe konkretisht u auditua përdorimi i subvencionit të akorduar Ministria e Transporti dhe Infrastrukturës për vitin 2017.

Nga auditimi u konstatua se;

-Subvencioni i akorduar nga buxheti i shtetit, nuk është përdorur për ndihmë shtetërore për transportin e udhëtarëve, ***në kundërshtim me destinacionin e përcaktuar***. Ky fond ka kaluar për aktivitete të tjera të kësaj shoqërie dhe kryesisht për paga, sigurime shoqërore.

-Ministria e Transporti dhe Infrastrukturës, Ministria e Financës, nuk kanë përcaktuar strukturën e shpenzimeve që do të mbulohen nga subvencioni. Njëkohësisht drejtoria e përgjithshme e hekurudhave, nuk ka të përcaktuar strukturën e shpenzimeve të subvencionit në Këshillin Mbikëqyrës, ***çka ka krijuar mundësinë që drejtoria e hekurudhës të përcaktojë, vetë shpenzimin që mbulohet me subvencion***. Konkretisht për paga, sigurime shoqërore, materiale, lëndë djegëse, kosto të biletave, udhëtim dhe dieta, shpenzime telefonike, amortizimi, shpenzime riparimi, taksa e përdorimit të infrastrukturës (taksë e vendosur nga vetë drejtoria, që detyron njësinë e shërbimit të mjeteve lëvizëse, njësinë e biznesit të mallit dhe njësinë e biznesit të udhëtarëve, ***ti paguajnë njësisë së biznesit dhe menaxhimit të infrastrukturës***, taksë për përdorimin e magjistrave kryesore dhe dytësore të rrjetit hekurudhor, ***pra taksë e brendshme për të rritur shpenzimet me qëllim për të përfituar sa më shumë subvencion***).

Shpenzimet e subvencionit kanë kaluar nëpërmjet sistemit të thesarit. Ky subvencion është kryer çdo muaj me urdhër shpenzim të plotësuar dhe nënshkruar urdhëruesi (administratori i përgjithshëm i shoqërisë), përgjegjësi i financës dhe nëpunësi i thesarit.

Ky shpenzim ka kaluar për llogari të njësisë së biznesit të udhëtari, si shpenzim i programuar si diferencë midis të ardhurave dhe shpenzimeve dhe jo si diferencë midis çmimit të miratuar të biletës së udhëtarit të miratuar me VKM nr. 66, datë 07.02.2007 dhe koston për çdo biletë.

Nga auditimi u konstatua se, i gjithë subvencioni është përdorur për mbulimin e fondit të pagave dhe sigurimet shoqërore për shoqërinë Hekurudha Shqiptare SHA (drejtorinë e përgjithshme të hekurudhës, njësia e biznesit të mallit, njësia e menaxhimit të infrastrukturës, njësia e biznesit të mjeteve lëvizëse), ***duke ndryshuar në këtë mënyrë destinacionin e këtij shpenzimi të dhënë nga buxheti i shtetit***.



Për pasojë vlera 1,230,000,000 lekë përbën shkelje të disiplinës buxhetore dhe shpenzime jo në përputhje me ligjin po në të njëjtën vlerë.

Për vitin 2015 dhe 2016 dhe 2017 janë lidhur kontratë ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës me Hekurudhën Shqiptare.

Për vitin 2015, është hartuar kontrata nr. 486 prot., datë 16.04.2015 dhe nënshkruar kontrata për mbështetje financiare shtetërore nga administratori i shoqërisë G.A dhe dërguar me shkresën nr. 486 prot., datë 16.04.2015 për nënshkrim në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, kontratë e cila në nenin 7 të saj ka të përcaktuar "*Subvencioni shtetëror i miratuar të përdoret vetëm nga Njësia e Biznesit të Transportit të Udhëtarëve, sipas skemës së miratuar nga vendimet e komisionit të ndihmës shtetërore "Për skemën ekzistuese të subvencionit të hekurudhave"* dhe destinacionit të përcaktuar në ligjin nr. 160/2014 datë 27.11.2014 "Për buxhetin e shtetit 2015" dhe sipas kostos së llogaritur nga Hekurudha Shqiptare.

Kontratë e cila është e pa nënshkruar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës edhe pse nga ana e administratorit të shoqërisë është dërguar shkresa nr. 486/1 prot. datë 15.07.2015 për kujtesë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.

Për vitin 2016, është hartuar kontrata dhe nënshkruar kontrata për mbështetje financiare shtetërore dhe dërguar me shkresën nr. 687 prot, datë 26.08.2016 për nënshkrim në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, kontratë e cila në nenin 7 të saj ka të përcaktuar "*Subvencioni shtetëror i miratuar të përdoret vetëm nga Njësia e Biznesit të Transportit të Udhëtarëve, sipas skemës së miratuar nga vendimet e komisionit të ndihmës shtetërore "Për skemën ekzistuese të subvencionit të hekurudhave"* dhe destinacionit të përcaktuar në ligjin nr. 147 datë 17.12.2015 "Për buxhetin e shtetit 2016" dhe sipas kostos së llogaritur nga Hekurudha Shqiptare. Kontratë e cila është e pa nënshkruar nga ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.

Për vitin 2017, është hartuar kontrata dhe nënshkruar nga administratori i shoqërisë kontrata për mbështetje financiare shtetërore dhe dërguar me shkresën nr. 330 prot., datë 28.04.2017 për nënshkrim në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, kontratë e cila në nenin 7 të saj ka të përcaktuar "*Subvencioni shtetëror i miratuar të përdoret vetëm nga Njësia e Biznesit të Transportit të Udhëtarëve, sipas skemës së miratuar nga vendimet e komisionit të ndihmës shtetërore "Për skemën ekzistuese të subvencionit të hekurudhave"* dhe destinacionit të përcaktuar në ligjin nr. 130 datë 15.12.2016 "Për buxhetin e shtetit 2017" dhe sipas kostos së llogaritur nga Hekurudha Shqiptare.

Kontratë e cila është e pa nënshkruar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës por është dërguar shkresa nr. 2586/1 prot., datë 09.06.2016 me objekt "Mbi kontratën e mbështetjes financiare shtetërore".

Me shkresën nr. 330, datë 28/4/2017, keni dërguar "Kontratën e Mbështetjes Financiare shtetërore"

Nga shqyrtimi i saj prej Sektorit të Politikave të Transportit Hekurudhor, Drejtorisë së Financës, dhe Drejtorisë së Shërbimeve Juridike konstatojmë se ky material ka nevojë për rregullime si me poshtë:

- 1- Hekurudha Shqiptare SHA, merr fonde për subvencion nga buxheti i shtetit, kjo marrëveshje duhet të ishte hartuar në momentin e miratimit nga parlamenti, të ligjit Nr. 130, datë 15.12.2016 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017", në shumën prej 400 milion leke. Aktualisht për periudhën Janar - Maj 2017, nga ky fond është financuar shuma 166 milion leke ose 41 % e totalit të subvencionit. Hartimi dhe vlefshmëria e një marrëveshje të re, mbi subvencionin e Hekurudhës Shqiptare, duhet të fillojë nga data 1 qershor - 31



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

dhjetor 2017, për shumën e mbetur te subvencionit prej 234 milion lekë, duke ndryshuar nenin 4, pika 4.1 te përcaktuar.

- 2- Ne nenin 2 te shtohen te plota citimet e ligjeve ndryshuese.
- 3- Po ne baze te ligjit duhet te quhet Marrëveshje dhe jo Kontrate
- 4- Ne nenin 1, pika 1.1, në fund te fjalisë, te shtohet nga buxheti i shtetit.
- 5- Neni 3, pika 3,1, te korrigohet viti, duhet 2017.
- 6- Neni 6, pika 6.3, mendojmë nga pikëpamja buxhetore, miratimi i programit financiarë të vitit 2018 për Hekurudhën Shqiptare, të bëhet Brenda muajit dhjetorë 2017.

Nisur nga kjo shkresë është hartuar kontrata nr. 330/2 datë 22.06.2017 dhe nënshkruar nga administratori i shoqërisë kontrata për mbështetje financiare shtetërore dhe dërguar me shkresën nr. 330/2 prot., datë 22.06.2017 për nënshkrim në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9374, datë 21.02.2005 “Për ndihmën shtetërore”, Ligjin nr. 185/2013, datë 02.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, Ligjin nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005 “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, Vendimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 8, datë 02.02.2007 i ndryshuar me Vendimin nr. 15, datë 15.03.2007.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendur më sipër ngarkon përgjegjësi I.D me detyrë ish-Administrator i shoqërisë, A.P me detyrë ish-drejtor ekonomik i DPH për periudhën objekt auditimi, Avdi Hallulli me detyrë shef i sektorit të financës DPH për periudhën objekt auditimi, E.D me detyrë drejtor i njësisë së infrastrukturës për periudhën objekt auditimi, Artjon Keçi me detyrë drejtor i njësisë së shërbimit të mjeteve lëvizëse, S.Sh me detyrë ish-drejtor i njësisë së mallrave, Petrit Tabaku me detyrë drejtuesi i njësisë së biznesit të udhëtarit.

Për pasojë vlera 1,230,000,000 lekë përbën shkelje të disiplinës buxhetore dhe shpenzime jo në përputhje me ligjin po në të njëjtën vlerë.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Urdhër Shpenzimi, i firmosur nga Administratori dhe Përgjegjësi i Financës së Hekurudha Shqiptare, si dhe nëpunësi i thesarit, shoqëruar me preventivin e shpenzimeve dhe të ardhurave i cili firmoset vetëm nga Administratori dhe Nëpunësi i Thesarit, dërgohet në Thesar për çdo muaj. Në këto urdhër-shpenzime është përcaktuar gjithashtu dhe përfituesi (që është Njësia e Biznesit të Udhëtarit) dhe numri i llogarisë ku do xhirohen fondet. Shpenzimet e subvencionit kanë kaluar nëpërmjet sistemit të thesarit. Ky subvencion është kryer çdo muaj me urdhër shpenzim të plotësuar dhe nënshkruar urdhëruesi (administratori i përgjithshëm i shoqërisë), përgjegjësi i financës dhe nëpunësi i thesarit.

Ndërsa për periudhën 01.01.2017-31.12.2017, janë në total 10 Urdhër Shpenzime, si më poshtë:

1. Urdhër-shpenzimi nr. 1, datë 18.01.2017, me vlerë 33,000,000 lekë
2. Urdhër-shpenzimi nr. 4, datë 03.02.2017, me vlerë 33,000,000 lekë
3. Urdhër-shpenzimi nr. 9, datë 07.03.2017, me vlerë 34,000,000 lekë
4. Urdhër-shpenzimi nr. 10, datë 11.04.2017, me vlerë 33,000,000 lekë
5. Urdhër-shpenzimi nr. 15, datë 09.05.2014, me vlerë 33,000,000 lekë
6. Urdhër-shpenzimi nr. 16, datë 06.06.2017, me vlerë 34,000,000 lekë
7. Urdhër-shpenzimi nr. 19, datë 10.07.2017, me vlerë 33,000,000 lekë
8. Urdhër-shpenzimi nr. 23, datë 04.08.2017, me vlerë 33,000,000 lekë
9. Urdhër-shpenzimi nr. 25, datë 06.09.2017, me vlerë 34,000,000 lekë
10. Urdhër-shpenzimi nr. 27, datë 05.10.2017, me vlerë 33,000,000 lekë



11. Urdhër-shpenzimi nr. 28, datë 07.11.2017, me vlerë 33,000,000 lekë

Në bazë të Vendimit të Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 8, datë 02.02.2007, detyrohet *Ministria e Transportit dhe Hekurudha Shqiptare SHA, të lidhin kontratën për subvencionin, si dhe të kryejnë llogaritjen e saktë të vlerës që Hekurudha Shqiptare mund të përfitojë për të ofruar këtë shërbim publik. Në këtë vendime përcaktohet gjithashtu se në rast se nuk do të kompensohet e gjithë shuma e nevojshme për ofrimin e shërbimit publik të transportit të udhëtarëve, atëherë të lejohet Hekurudha Shqiptare të përshtatë tarifën për vlerën e pambuluar nga subvencionin.*

Më pas Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me Vendimin nr. 15, datë 15.03.2007, e lë në fuqi Vendimin nr. 8, datë 02.02.2007 dhe gjithashtu përcakton se në rast moszbatimi të këtij vendimi nga *Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Hekurudha Shqiptare SHA, Komisioni i Ndhmës Shtetërore është i detyruar të fillojë procedurat për ndihmën e paligjshme dhe Hekurudha Shqiptare SHA detyrohet të kthejë të gjithë vlerën e subvencionit të marrë, së bashku me interesat.*

Në bazë të vendimeve të Komisionit të Ndhmës Shtetërore, Hekurudha Shqiptare SHA, duhet të lidhte kontratë për përfitimin e subvencionit me Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës (ish-Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit). Kontrata të hartuara dhe nënshkruara vetëm nga Administratori i Hekurudha Shqiptare SHA

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financës dhe Hekurudha Shqiptare SHA, nuk kanë përcaktuar strukturën e shpenzimeve që do të mbulohen nga subvencionin. Njëkohësisht drejtoria e përgjithshme e hekurudhave, nuk ka të përcaktuar strukturën e shpenzimeve të subvencionit në Këshillin Mbikëqyrës, çka ka krijuar mundësinë që drejtoria e hekurudhës të përcaktojë, vetë shpenzimin që mbulohet me subvencion. Konkretisht për paga, sigurime shoqërore.

Ky shpenzim ka kaluar për llogari të njësisë së biznesit të udhëtarit, si shpenzim i programuar, si diferencë ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve dhe jo si diferencë ndërmjet çmimit të miratuar të biletës së udhëtarit të miratuar me VKM dhe kostos për çdo biletë.

Nga auditimi u konstatua se në fakt ky subvencion përdoret, jo vetëm si diferencë ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të Njësisë së Udhëtarit, por është përdorur dhe për mbulimin e shpenzimeve të ndryshme të njësisë të tjera (si drejtoria e përgjithshme e hekurudhës, njësia e biznesit të mallit, njësia e biznesit të infrastrukturës, njësisë e biznesit të mjeteve lëvizëse), **duke ndryshuar në këtë mënyrë destinacionin e këtij shpenzimi të dhënë nga buxheti i shtetit.**

Konkretisht:

Nga 440,000,000 lekë të subvencionuar nga Buxheti i Shtetit për vitin 2017, e gjithë vlera është përdorur për shpenzime të tjera të drejtorisë së përgjithshme, njësisë së biznesit të mallit, njësisë së infrastrukturës, njësisë mbështetëse dhe njësisë së shërbimeve të mjeteve lëvizëse, për shpenzime page dhe sigurime shoqërore, pra është ndryshuar destinacionin e dhënë nga Buxheti i Shtetit për subvencionin e biletë së udhëtarit.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9374, datë 21.02.2005 “Për ndihmën shtetërore”, Ligjin nr. 185/2013, datë 02.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, Ligjin nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005 “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit””, Vendimin e Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 8, datë 02.02.2007 i ndryshuar me Vendimin nr. 15, datë 15.03.2007.



Për pasojë vlera 440,000,000 lekë përbën shkelje të disiplinës buxhetore dhe shpenzime jo në përputhje me ligjin po në të njëjtën vlerë.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendur më sipër ngarkon përgjegjësi Administratorin e shoqërisë z. I.D, A.P me detyrë drejtor ekonomik i DPH për periudhën objekt auditimi, A.H me detyrë shef i sektorit të financës DPH për periudhën objekt auditimi, E.D me detyrë drejtuesi i njësisë së infrastrukturës për periudhën objekt auditimi, A.K me detyrë drejtuesi i njësisë së shërbimit të mjeteve lëvizëse për periudhën objekt auditimi, S.Sh me detyrë drejtuesi i njësisë së mallrave për periudhën 23.01.2014 e në vazhdim, Petrit Tabaku me detyrë drejtuesi i njësisë së biznesit të udhëtarit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

z. A.P, në cilësinë e Drejtori Ekonomik

z. I.D me detyrë ish-Administrator i Shoqërisë

z. A.H me detyrë përgjegjës i sektorit financiarë

z. S.Sh me detyrë ish-drejtues i njësisë

z. E.D me detyrë ish-drejtues njësie

IV. 11. Hartimi, miratimi i tarifave në transportin e mallrave dhe udhëtarëve, lidhja e kontratave dhe zbatimi i tyre.

Për periudhën objekt auditimi transporti ndërkombëtar është i organizuar në dy forma:

-Nëpërmjet spedicionereve hekurudhore (Pansped-Serbi dhe 16 Februar-Mali Zi) me te cilët HSH ka lidhur kontratat përkatëse, ku këta spedicionerë kanë marrë përsipër likuidimin e detyrimeve të transportit për llogari të pritësit të mallit për destinacionin Stacioni kufitar Bajze – stacioni hekurudhor pritës.

-Si dhe nëpërmjet vet subjekteve të ndryshme, të cilët paguajnë detyrimet e transportit për relacionin Stacioni Bajze – stacioni pritës.

Për vitin 2016: “K. I.”, “O.” sh.p.k, “A. C.” sh.a, “R.” sh.p.k, “E.” sh.p.k, “D.20-G. sh.p.k, “Gj.” sh.p.k, “B. Ti.” sh.a, “A.” sh.p.k, “S.&C.” sh.p.k, “A. D.D.”, “P.” sh.p.k.

Për vitin 2017: “K. I.”, “O.” sh.p.k, “A.C.” sh.a, “C.” sh.p.k, “D. 20-G. sh.p.k, “M. A.” sh.p.k, “NN’ZK Sh.” sh.p.k, “S.&C.” sh.p.k, “A. M.” sh.p.k, “D.” sh.p.k.

Nga auditimi u konstatuan problemet si më poshtë:

-Mos likuidimi në kohe i detyrimeve për kohe qëndrimin e vagonëve te huaj, i cili është bere një problem shqetësues dhe me pasoja për HSH. Detyrimet që Hekurudha Shqiptare ka ndaj hekurudha të tjera “Për orë qëndrimet e vagonëve në territorin e Hekurudhës Shqiptare”, deri më datën 31.12.2017 është në **vlerën 1,667,790 euro.**

Në këtë vlerë nuk janë përfshirë penalitetet për mos likuidim në kohë të detyrimeve që Hekurudha Shqiptare ka ndaj hekurudhave të tjera, për përdorimin e vagonëve , penalitete të cilat si rrjedhojë e mos llogaritjes nuk janë kontabilizuar, por është kontabilizuar vetëm principiali. Principiali është kontabilizuar mbi bazën e urdhrave të çdo muaji nga drejtori i njësisë. Çka do të thotë që vlera totale ndaj hekurudha të tjera është më e madhe.

Për sa më sipër;



a. Hekurudhat e huaja kane filluar te paraqesin dhe detyrimin për kamate vonesat ne likuidimin e detyrimeve.

b. Mjaftë hekurudha të huaja, kane filluar te refuzojnë nisjen e mallrave nga importi me origjine nga vendet e tyre me vagonët e tyre, si hekurudhat Bullgare apo Polake.

c. Mos likuidimi për një kohe te gjate, ka ndikuar dhe ne performancën e Hekurudhës Shqiptare ndaj Hekurudhave te Huaja, problem ky i cili mund te ngrihet dhe ne forumet ndërkombëtare hekurudhore.

-Nuk është bërë përkthimi në gjuhen shqipe i marrëveshjes RIV (Rregullore mbi shkëmbimin reciprok te vagonëve), lidhur me dokumentacionin shoqërues të vagonëve për transportin e mallrave dhe aplikimin e kamatëvonesave për orë qëndrimi të vagonëve të huaj, duke ndikuar direkt në rezultatin financiar, pasi kjo krijon vështirësi në përcaktimin e detyrimeve financiare ndërmjet HSH-së ndaj hekurudhave të huaja, sipas procedurave të parashikuara në RIV.

-Nuk kryhet asnjë veprim financiar dhe kontabël në lidhje me detyrimet financiare që rezultojnë nga kamatëvonesat për orë qëndrimet e vagonëve të huaj, ndaj hekurudhave të huaja. Ky mosveprim nga ana e HSH, nuk krijon besueshmëri për raportimin saktë dhe të besueshëm të detyrimeve dhe rezultateve financiare, për shkak se kamatëvonesat e dërguara nga hekurudhat e huaja pranohen të mirëqena, pa bërë përlllogaritjen e penalteteve dhe përfshirjen e tyre në raportimet e pasqyrave financiare.

-Nuk janë kryer rakordime ndërmjet HSH, dhe Hekurudha ve të huaja, në lidhje me dokumentacionin e hyrje-daljeve të vagonëve të huaj.

-Në dokumentacionin e transportit të mallrave, në përgjithësi mungon lista e vagonëve bashkangjitur faturës dhe fletë ngarkesës përkatëse, duke krijuar në këtë mënyrë një mos evidentim të saktë të vagonëve të hyrë e të dalë nga territori shqiptar, si dhe orë qëndrimet përkatëse për secilin vagon. Kjo ndikon drejtpërdrejt në përkeqësim të gjendjes ekonomike të HSH, pasi sipas kapitullit 3.3 të RIV, pika 71.1.2, për vagonët e një rëndësie të ulët komerciale aplikohet një tarifë e rritur me 15% nga ora e 241 e qëndrimit për vagonët në territorin shqiptar, e cila rritet me 100% nga ora e 721 e qëndrimit. Ndërsa për vagonët e cilësisë së lartë komerciale aplikohet një tarifë e rritur me 30% nga ora e 241 e qëndrimit për vagonët në territorin shqiptar, e cila rritet me 100% nga ora e 721 e qëndrimit.

-Faturave tatimore të transportit të mallrave, nuk u bashkëngjiten fletëngarkesat e transportit të mallrave. Ky veprim përbën risk në zbatimin korrekt të tarifave, duke i krijuar mundësi aplikuesit dhe përfituesit për shkelje financiare në dëm të HSH-së. Ky veprim është në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 4, datë 03.02.2014, kapitulli II, pika 1.4.a.

-Nuk ka marrëveshje me administratën doganore me qëllim lehtësimin e kontrollit dhe rregullshmërisë doganore të mallrave siç është parashikuar në nenin 7 të Ligjit nr. 9167, datë 22.01.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare “Për lehtësimin e kalimeve kufitare për mallrat e transportuara me hekurudhë”.

-Faturave tatimore të lëshuara nga NJBM, për efekte parapagimi të mallrave që do të importohen sipas kërkesave verbale të shoqërisë Pansped, nuk i bashkëngjiten dokumentet bankare, që të vërtetojnë arkëtimet e sakta dhe në kohë të parapagimeve. Faturat tatimore të lëshuara për efekt parapagimi hartohen dhe nënshkruhen nga sektori i marketingut bazuar në e-mail që dërgon shoqëria Pansped.

-Zbritjet në fatura për rastet e parapagimeve apo të uljeve komerciale janë përgjithësisht pa referenca. Edhe në rastet kur ka referenca, kjo e fundit nuk i përgjigjet numrit të faturës së parapaguar.



-Në kontratat e lidhura ndërmjet transportuesit HSH dhe klientëve, për transportin e mallrave të ndryshme, nuk janë përcaktuar penalitetet për mosrealizim të kontratës në sasi, si dhe për likuidimet e vonuara të faturave nga klientët.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Njësia e Biznesit të Mallit (NjBM) ka si objekt kryesor të aktivitetit të saj transportin e mallrave në rrjetin hekurudhor shqiptar me operatorë vendas dhe të huaj sipas kontratave në përputhje me programet e miratuara. NjBM funksionon në bazë të Rregullores së brendshme (neni 23-30), miratuar me vendimin e Drejtorisë së D.P.H-së nr 40/24, datë 31.12.2009, rregullore e cila nuk është azhurnuar në përputhje me ndryshimet strukturore të njësisë, miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë, me vendimin nr 3, datë 14.06.2013.

Hekurudha shqiptare operon me 14 hekurudha të huaja, konkretisht me Hekurudhën Sllovaqe, Sllovene, Bullgare, Rumune, Polake, Gjermane, Austriake, Hungareze, Gysev, Çeke, Kroate, Serbe, Bosnje Hercegovinë dhe të Malit të Zi.

Hekurudha Shqiptare është anëtare e UIC-it (Unioni Ndërkombëtar Hekurudhor) e për pasojë zbaton të gjitha rregulloret hekurudhore ndërkombëtare të cilat rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet rrjeteve hekurudhore Evropiane në aspektet kryesore të veprimtarisë së tyre, siç janë:

AIM – Marrëveshje mbi transportin ndërkombëtar të mallrave me hekurudhë.

CIM – Rregulla uniforme të marrëveshjes së transportit ndërkombëtar të mallrave me hekurudhë.

PIM – Rregullat mbi transportin ndërkombëtar të mallrave

RID – Rregullorja mbi transportin ndërkombëtar të mallrave të rrezikshëm

RIV – Marrëveshja mbi shkëmbimin dhe shfrytëzimin e vagonëve të mallrave ndërmjet ndërmarrjeve hekurudhore

Aneksi II RIV – Rregullat mbi ngarkimin e vagonëve të mallit, si dhe mjaft fisha të UIC-it me rregulla më të detajuara për probleme të ndryshme të rregulloreve të mësipërme.

Transporti ndërkombëtar i mallrave të ndryshëm si skrap, qymyr (koks), sheqer, grurë etj, bëhet mbi bazën e kontratave që lidhen me klientë të ndryshëm duke respektuar tarifat e transportit kombëtar dhe ndërkombëtar, të miratuara çdo vit me vendim të bordit drejtues të Shoqërisë HSH Sh.a Durrës.

Ndjekja dhe realizimi i transportit ndërkombëtar bëhet në dy forma:

-Nëpërmjet spedicionerëve hekurudhor (Pansped-Serbi dhe 16 Februar-Mali Zi) me të cilët HSH ka lidhur kontratat përkatëse, ku këta spedicionerë kanë marrë përsipër likuidimin e detyrimeve të transportit për llogari të pritësit të mallit për destinacionin Stacioni kufitar Bajzë – stacioni hekurudhor pritës.

-Nëpërmjet vetë subjekteve të ndryshme, të cilët paguajnë detyrimet e transportit për relacionin Stacioni Bajzë.

Transporti bëhet duke përdorur vagonët e hekurudhave të huaja nëpërmjet vijës hekurudhore kufitare Bajzë-Tuz, e cila është vija e kalimit kufitar Shqipëri-Mal i Zi. Në zbatim të VKM Nr. 426, datë 28.06.2006 *”Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Malit të Zi, për organizimin e trafikut të kufitar hekurudhor ndërmjet të dy vendeve”*, dorëzimi dhe marrja në ngarkim e vagonëve të mallrave, mallrave, dokumenteve, kontenierëve, paletave dhe pajisjeve të ngarkimit bëhet në stacionin e ndërrimit midis personelit të shërbimit hekurudhor të stacionit të ndërrimit, sipas dispozitave ndërkombëtare që rregullojnë këtë çështje: *“Konventa mbi Transportin Hekurudhor*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

Ndërkombëtar (COTIF)“ dhe “Marrëveshja mbi Shkëmbimin dhe Shfrytëzimin e Vagonëve të Mallrave ndërmjet Ndërmarrjeve Hekurudhore (RIV)”. Në përgjithësi likuidimi i faturave të transportit të mallrave nga klientët bëhet i sipas kushteve të kontratës, me përjashtim të firmës Pansped që merret me transportin ndërkombëtar, i cili nuk i bën në kohën e përcaktuar në kontratë.

Në fund të çdo muaji, Stacioni Hekurudhor Bajzë depoziton pranë NjBM evidencën e hyrje-daljeve të vagonëve të huaj duke regjistruar nr e vagonëve, llojin e mallrave, datën dhe orën e hyrjes, datën dhe orën e daljes së vagonëve. Të dhënat regjistrohen mbi bazën elistë-kalimit të vagonëve që përpilohet nga personeli komercial, respektivisht i stacioneve Bajzë dhe Tuz, që nënshkruhet nga të dyja palët. Ky veprim fakton dokumentimin e hyrje-daljeve të vagonëve që bëjnë transportin e mallit në territorin shqiptar. Evidenca e hyrje daljes të vagonëve kontrollohet në fund të çdo muaji nga dega e kontrollit të trafikut dhe marketingut.

HSH nuk ka shlyer detyrimet e prapambetura për përdorimin e vagonëve në pronësi të hekurudhave të huaja. Mos likuidimi ndaj hekurudhave të huaja ka shkaktuar penalitete në dëm të HSH-së, duke bërë që detyrimet të rriten vazhdimisht, pasi hekurudhat e huaja, në zbatim të kapitullit 3.5, pika 91.3 të RIV, kanë aplikuar kamatëvonesa për shkak të mos likuidimit të detyrimeve financiare. Nga hekurudhat e huaja vijnë vazhdimisht fatura në lidhje me dëmshpërblimin për kamatëvonesat që rezultojnë nga mos likuidimi i detyrimeve të prapambetura të HSH-së. Mosshlyerja e këtyre detyrimeve përbën një problem kryesor të aktivitetit të HSH-së.

Detyrimet e HSh-së ndaj hekurudhave të huaja “Për orë qëndrimet e vagonëve në territorin shqiptar” paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Detyrim viti 2009-2014	Detyrim viti 2015	Detyrim viti 2016	Detyrim viti 12/2017	Totali
Hekurudha serbe	625,105	11,174	495	58,139	694,913
Hekurudha austriake	170,106	16,686	7,276	1,889	195,958
Hekurudha Hungareze	166,321	15,011	18,321	15,536	215,190
Hekurudha Bosnje Herceg	91,070	24,506	18,030	15,393	148,999
Hekurudha Kroate	93,129	2,000	7,770	1,534	104,432
Hekurudha Mali I zi	68,393	9,531	5,391	4,039	87,354
Hekurudha Bullgare	55,376				55,376
Hekurudha Sllovaqe	29,346	2,778	3,663	52,950	88,736
Hekurudha Sllovene	14,360	1,534	1,889	905	18,688
Hekurudha Rumune	13,606				13,606
Hekurudha ceke	9,977			444	10,422
Hekurudha Gysev (hungari)	7,779	248	244	2,715	10,986
Hekurudha Gjermane	-	222			222
Hekurudha Polake	-			8,162	8,162
Hekurudha serbe Detyrim per demtim vago	-				14,745
Total	1,344,568	83,692	63,079	161,706	1,667,790

Burimi i të dhënave drejtoria e financës Hekurudha Shqiptare



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

Këshilli Mbikëqyrës me vendim nr 4, datë 23.02.2014, ka miratuar tarifrat e transportit kombëtar dhe ndërkombëtar të mallrave të përcaktuara në “Librin Tarifor”, të cilat për periudhën objekt auditimi janë ndryshuar me vendimin nr. 8 datë 01.07.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë të cilat reflektohen në 6 mujorin e dytë të vitit 2016 duke ulur tarifrat me 5 % për transportin e brendshëm dhe 10 % për transportin e jashtëm, për ti krijuar më ambient më lehtësues klientëve ekzistues dhe atyre të rinj. Sipas Librit Tarifor të transportit të mallrave, llogaritja e shpenzimeve për transportin kryhet mbi bazën e llojit të mallit (klasës tarifore), sasisë së dërgesës, llojit të vagonëve (vagonë në pronësi të hekurudhave të huaja, vagonë privat apo të marrë me qira), si dhe distancave të transportit. Tarifrat e transportit të mallrave janë përcaktuar dhe në kontratat e lidhura midis NjBM-së dhe klientëve. Deklarimet tatimore të TVSH në librin e shitjeve mujore bëhen mbi bazën e faturave tatimore të lëshuara për efekt parapagimi.

Në transportin ndërkombëtar të mallrave, zbatohet parapagimi i detyrimeve që rrjedhin. Me arkëtimin e parapagimeve, të cilat bëhen sipas kërkesës së klientëve me e-mail, në periudha të ndryshme, lëshohen fatura tatimore për parapagim transport malli, për sasi të e volumeve të mallrave që pritet të realizohen. Në momentin që ngarkesat hekurudhore hyjnë në territorin shqiptar, hartohet një faturë e dytë tatimore për ngarkesën faktike për çdo dërgesë. Në faturën e dytë tatimore që lëshohet për klientin, për çdo rast kur është kryer parapagimi, zbriten vlerat e faturave tatimore sipas numrit të faturës të parapaguar. Faturat tatimore, të lëshuara për të dytën herë për çdo ngarkesë, raportohen me vlerën zero në librin e shitjeve mujore, për shkak se është raportuar në faturën tatimore parapagim të lëshuar më parë.

Nga auditimi u konstatuan problemet si më poshtë:

-Mos likuidimi në kohe i detyrimeve për kohe qëndrimin e vagonëve të huaj, i cili është bërë një problem shqetësues dhe me pasoja për HSH. Detyrimet që Hekurudha Shqiptare ka ndaj hekurudha të tjera “Për orë qëndrimet e vagonëve në territorin e Hekurudhës Shqiptare”, për periudhën objekt auditimi ky detyrimin është shtuar **me 308,476 euro** duke e rënduar akoma më shumë situatën financiare të “Hekurudhës Shqiptare” SHA deri më datën 31.12.2017 është në **vlerën 1,667,790 euro**.

Në këtë vlerë nuk janë përfshirë penalitetet për mos likuidim në kohë të detyrimeve që Hekurudha Shqiptare ka ndaj hekurudhave të tjera, për përdorimin e vagonëve, penalitete të cilat si rrjedhojë e mos llogaritjes nuk janë kontabilizuar, por është kontabilizuar vetëm principliali. Principliali është kontabilizuar mbi bazën e urdhrave të çdo muaji nga drejtori i njësisë. Çka do të thotë që vlera totale ndaj hekurudha të tjera është më e madhe.

Për sa më sipër;

a. Hekurudhat e huaja kanë filluar të paraqesin dhe detyrimin për kamate vonesat në likuidimin e detyrimeve.

b. Mjaftë hekurudha të huaja, kanë filluar të refuzojnë nisjen e mallrave nga importi me origjinë nga vendet e tyre me vagonët e tyre, si hekurudhat Bullgare apo Polake.

c. Mos likuidimi për një kohe të gjatë, ka ndikuar dhe në performancën e Hekurudhës Shqiptare ndaj Hekurudhave të Huaja, problem ky i cili mund të ngrihet dhe në forumet ndërkombëtare hekurudhore.

-Nuk është bërë përkthimi në gjuhën shqipe i marrëveshjes RIV (Rregullore mbi shkëmbimin reciprok të vagonëve), lidhur me dokumentacionin shoqëruar të vagonëve për transportin e mallrave dhe aplikimin e kamatëvonesave për orë qëndrimi të vagonëve të huaj, duke ndikuar direkt në rezultatin financiar, pasi kjo krijon vështirësi në përcaktimin e detyrimeve financiare ndërmjet HSH-së ndaj hekurudhave të huaja, sipas procedurave të parashikuara në RIV.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

- Nuk kryhet asnjë veprim financiar dhe kontabël në lidhje me detyrimet financiare që rezultojnë nga kamatëvonesat për orë qëndrimet e vagonëve të huaj, ndaj hekurudhave të huaja. Ky mosveprim nga ana e HSH-së, nuk krijon besueshmëri për raportimin saktë dhe të besueshëm të detyrimeve dhe rezultateve financiare, për shkak se kamatëvonesat e dërguara nga hekurudhat e huaja pranohen të mirëqena, pa bërë përlllogaritjen e penalteteve dhe përfshirjen e tyre në raportimet e pasqyrave financiare.
- Nga ana e hekurudhës shqiptare nuk është bërë ndarja e vagonëve të cilësisë së ulët apo të lartë komerciale, duke mos bërë evidentimin e saktë në lidhje me detyrimet financiare që rezultojnë për kamatëvonesave për orë qëndrimet e vagonëve të huaj.
- Nuk janë kryer rakordime ndërmjet HSH, dhe Hekurudhave të huaja, në lidhje me dokumentacionin e hyrje-daljeve të vagonëve të huaj, si dhe nuk plotësohen të gjitha pikat e formatit D të përcaktuara në kapitullin 3.5, pika 91 të marrëveshjes RIV, për këtë qëllim.
- Në dokumentacionin e transportit të mallrave, në përgjithësi mungon lista e vagonëve bashkangjitur faturës dhe fletë ngarkesës përkatëse, duke krijuar në këtë mënyrë një mos evidentim të saktë të vagonëve të hyrë e të dalë nga territori shqiptar, si dhe orë qëndrimet përkatëse për secilin vagon. Kjo ndikon drejtpërdrejt në përkeqësim të gjendjes ekonomike të HSH, pasi sipas kapitullit 3.3 të RIV, pika 71.1.2, për vagonët e një rëndësie të ulët komerciale aplikohet një tarifë e rritur me 15% nga ora e 241 e qëndrimit për vagonët në territorin shqiptar, e cila rritet me 100% nga ora e 721 e qëndrimit. Ndërsa për vagonët e cilësisë së lartë komerciale aplikohet një tarifë e rritur me 30% nga ora e 241 e qëndrimit për vagonët në territorin shqiptar, e cila rritet me 100% nga ora e 721 e qëndrimit.
- Faturave tatimore të transportit të mallrave, nuk u bashkëngjiten fletëngarkesat e transportit të mallrave. Ky veprim përbën risk në zbatimin korrekt të tarifave, duke i krijuar mundësi aplikuesit dhe përfituesit për shkelje financiare në dëm të HSH-së. Ky veprim është në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 4, datë 03.02.2014, kapitulli II, pika 1.4.a.
- Në të gjitha rastet e transportit ndërkombëtar të mallrave, HSH, nuk disponon deklaratën doganore, si dhe nuk ka marrëveshje me administratën doganore me qëllim lehtësimin e kontrollit dhe rregullshmërisë doganore të mallrave siç është parashikuar në nenin 7 të Ligjit nr. 9167, datë 22.01.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare “Për lehtësimin e kalimeve kufitare për mallrat e transportuara me hekurudhë”.
- Faturave tatimore të lëshuara nga NJBM, për efekte parapagimi të mallrave që do të importohen sipas kërkesave verbale të shoqërisë Pansped, nuk i bashkëngjiten dokumentet bankare, që të vërtetojnë arkëtimet e sakta dhe në kohë të parapagimeve. Faturat tatimore të lëshuara për efekt parapagimi hartohen dhe nënshkruhen nga sektori i marketingut bazuar në e-mail që dërgon shoqëria P.
- Zbritjet në fatura për rastet e parapagimeve apo të uljeve komerciale janë përgjithësisht pa referenca. Edhe në rastet kur ka referenca, kjo e fundit nuk i përgjigjet numrit të faturës së parapaguar.
- Për vitin 2014, nuk janë lidhur kontrata me klientët P.D. dhe B.T., veprim i parregullt dhe me pasoja financiare, në kundërshtim të vendimit nr. 4, datë 03.02.2014 të Këshillit Mbikëqyrës, kapitulli për “Uljet Komerciale”, pikat 1,2,3.
- Në kontratat e lidhura ndërmjet transportuesit HSH dhe klientëve, për transportin e mallrave të ndryshme, nuk janë përcaktuar penaltetet për mosrealizim të kontratës në sasi, si dhe për likuidimet e vonuara të faturave nga klientët me qëllim nxitjen e rritjes së transportit dhe arkëtimin e të ardhurave në kohë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

Për sa trajtuar më sipër mbajnë përgjegjësi I.D, S.Sh me detyrë ish-drejtor i Njesisë së biznesit të mallit, A.H shefe finance, B.Gj Kryetar i degës marketingut, Eduar Hoxhaj shef rajonal Bajzë, Kudus Shahinaj me detyrë Drejtues i njësisë së biznesit të mallit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

z. S.Sh, në cilësinë e ish drejtuesit të Njesisë së biznesit të mallit

znj. A.H, në cilësinë e shefes së financës

z. I.D me detyrë ish-Administrator i Shoqërisë

z.B.Gj në kryetari i degës marketingut

z.E.H me detyrë shef rajonal Bajzë

z. K.Sh, detyrë drejtuesit të Njesisë së biznesit të mallit

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Hekurudha Shqiptare SHA, Durrës nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim, me kërkesat minimale që duhet të përmbajë ky regjistër si datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia ” veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i unifikuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 35-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1-Rekomandimi:- Nga ana e shoqërisë të marrë masa për përmbushjen e kërkesave të regjistrin të aktiveve të shoqërisë, duke plotësuar të gjitha elementët përbërës të tij, si një pjesë e rëndësishme e menaxhimit dhe kontrollit.

Deri më datë 31.08.2018

2. Gjetje nga auditimi: Hekurudha Shqiptare SHA, në sistemin kontabël që përdor për përcaktimin, marrjen në llogari, matjen, klasifikimin dhe paraqitjen e të dhënave financiare të veprimtarive të njësive ekonomike nuk përdor bartësit informatik duke shfaqur rritje të rriskut të gabimeve si dhe të vështirësive për monitorim të sistemit, mungesën e të dhënave financiare në kohë reale për t’u reflektuar në vendim-marrjen e organeve drejtuese të shoqërisë (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 35-59 Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1-Rekomandimi:- Nga ana e shoqërisë të merren masa që në sistemin e saj kontabël, evidencën mbështetëse, dokumentet bazë, dokumentet plotësues dhe regjistrat kontabël, të implementojë bartësit informatikë që janë autorizuar nga organet përkatëse, të shkruar në mjete kompjuterike, sipas programeve informatike të pa-manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë.

Brenda vitit 2018



3. Gjetje nga auditimi: Hekurudha Shqiptare SHA, Durrës ka në llogarinë e inventarit vlerën totale prej 251,716,383 lekë, që përbëhet nga lëndët e para me vlerë 196,051,555 lekë, inventari i imët në vlerën 6,471,892 lekë, prodhim në proces në vlerën 7,252,678 lekë, e produkte të gatshme në vlerën 41,940,258 lekë, për të cilin shoqëria nuk ka kryer ndonjë vlerësim për të evidentuar ndonjë diferencë të mundshme në vlerën e inventarit, gjatë periudhës ushtrimore 2014, në kundërshtim Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 4, “inventarët” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 35-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1-Rekomandimi: - Shoqëria të marrë masa për kryerjen e zhvlerësimit të inventarit në zbatim të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit.

Brenda vitit 2018

4. Gjetje nga auditimi: Shoqëria ka kryer rivlerësimin e aktiveve afatgjata materiale me gjendjen e datës 31.12.2013, miratuar nga MZHETS me shkresë nr. 8504/3 datë 17.02.2015, në zbatim të së cilës janë kryer veprimet në kontabilitet në periudhën ushtrimore 2014 me urdhër të administratorit të shoqërisë nr. 220/1 datë 24.03.2015. Shoqëria nuk ka njohur tatime të shtyra për këto aktive materiale të rivlerësuara, duke mos-zbatuar Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 11, pika, 19, diferencat e përkohshme (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 35-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1-Rekomandimi: - Shoqëria duhet të marrë masa për njohjen e tatimeve të shtyra për aktivet afatgjata materiale të rivlerësuara, sipas kërkesës së Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 11, pika, 19, diferencat e përkohshme.

Brenda vitit 2018

5. Gjetje nga auditimi: Detyrimi që Hekurudha Shqiptare SHA ka ndaj shoqërive të huaja të hekurudhave (të periudhës deri në vitet 1990-1992) është në vlerën 841,179,000 lekë. Nga ana e këtyre hekurudhave “sidomos ato ish Jugosllave” është kërkuar disa herë likuidimi i detyrimeve, duke përfshirë dhe interesat. Nga ana e shoqërisë shqiptare të hekurudhave nuk janë llogaritur interesat ndër vite për këto detyrime afatgjata, duke mos-zbatuar Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 3, të përmirësuar, Instrumentet financiare, pika 14 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 35-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1-Rekomandimi: - Nga ana e shoqërisë të merren masa për shqyrtimin e situatës të detyrimeve ndaj shoqërive të huaja të hekurudhave, të vlerësohen marrëveshjet përkatëse të periudhës, vlefshmëria e tyre ligjore, korrespondenca e mbajtur duke nxjerrë penalitetet e interesat që janë krijuar si rezultat i mos-pagesave. Shoqëria të krijojë provizionet përkatëse duke i përfshirë në pasqyrat financiare.

Brenda vitit 2018

6. Gjetje nga auditimi: Në zërin e inventarëve në periudhën ushtrimore 2016, shoqëria ka klasifikuar lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme në vlerën 215,545,720 lekë, prodhime në proces dhe gjysmë produkte përkatësisht 5,599,507 lekë dhe 5,850,012 lekë si dhe produkte të gatshme në vlerën 52,478,637 lekë. Pjesa e produkteve të gatshëm janë pjesë këmbimi që



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

prodhohen për mjetet lokomotiva e vagonë por jo për tu shitur tek të tretët. Ky klasifikim është në kundërshtim me SKK nr. 4, pika 7, ku përcaktohet se inventarët e njëjve prodhuese përbëhen nga lëndët e para dhe materialet për konsum, puna në proces dhe produktet e përfunduara gati për shitje, mallrat e blera dhe të mbajtura për rishitje me pak ose aspak nevojë për ndryshim, që janë inventarë tipike për njësitë tregtare (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 35-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1-Rekomandimi:- Departamenti ekonomik i shoqërisë në përgatitjen e pasqyrave financiare të shoqërisë, për paraqitjen e inventarit ekonomik, duhet ti përmbahet Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.4, ku përcaktohet saktë se cilat zëra kontabël janë pjesë përbërëse e tij.

Brenda datës 30.08.2018

7. Gjetje nga auditimi: Detyrimet e kontabilizuara me vlerë 92,473,000 lekë përfaqësojnë debitorë prej viteve 2008-2014, ku mundësia e arkëtimit të kësaj vlere, me përbërje 47 subjekte është e ulët. Vlera prej 21,836,000 lekë e paraqitur në pasqyrat financiare nga Njësia e Mjeteve dhe e Infrastrukturës, përbëhet nga vlerat e dëmtimeve, vjedhjeve në objektet e shoqërisë të shkaktuara nga persona të pa-identifikuar nga viti 2006-2015, për të cilat janë kryer denoncimet në organet përkatëse, por që janë kontabilizuar si detyrime të arkëtueshme. Nga shoqëria nuk janë analizuar llogaria e kërkesave të arkëtueshme. Në zërin e kërkesave për arkëtim përfshihen kërkesa për TVSH të zbritshme në shumën 174,748,000 lekë. Në këtë shumë përfshihet TVSH e konsideruar si e pa zbritshme nga ana e kontrolleve tatimore për shumën 63,083,000 lekë e cila i përket periudhave 2014 dhe 2015. Nga kontrollet tatimore të ushtruara nga dega tatimeve në vitet 2010, 2012 dhe 2015 shoqërisë i janë ngarkuar penaltete në vlerën 81,955,000 lekë për të paguar. Shoqëria është në procesin e zhvillimit të procedurave gjyqësore për çështjet e mësipërme.

Për sa më sipër shoqëria nuk ka krijuar zhvlerësim për shumën e TVSh-së së zbritshme të panjohur për rimbursim në vlerën 63,083,000 lekë si dhe nuk ka krijuar provizione për shpenzimet për gjoba në shumën 81,955,000 lekë, duke mos zbatuar Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 3, Instrumentet financiare, pika 22 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 35-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1-Rekomandimi:- Nga ana e shoqërisë të merren masa për shqyrtimin e llogarive të arkëtueshme që i përkasin periudhave ushtrimore të mëparshme, vlerave monetare që përfaqësojnë dëme të shkaktuara shoqërisë nga palë të paidentifikuara dhe tvsh-në e konsideruar si e pazbritshme nga organet tatimore. Nga vlerësimi i arsyeshëm i këtyre llogarive të krijohen provizionet përkatëse duke pasqyruar me vërtetësi e besueshmëri pozicionin financiar të shoqërisë.

Brenda vitit 2018

8. Gjetje nga auditimi: Shoqëria ka paraqitur në klasën grante dhe të ardhura të shtyra afatshkurtra në vlerën 567,375,000 lekë, të cilat lidhen me grante të marra për aktive afatgjata. Këto veprime janë bërë në kundërshtim me standardin kombëtar të kontabilitetit nr. 10, Grantet dhe format e tjera të ndihmës.

-Llogaritja e të ardhurave nga grantet është bërë jo konformë me SKK nr. 10 “Grantet dhe format e tjera të ndihmës”. Zëri kontabël i granteve për rimarrjen e të ardhurave është amortizuar me



10% jo duke i specifikuar amortizimin dhe konsumin respektiv të aktiveve të cilat i përkasin këto grante. Këto veprime janë bërë në kundërshtim me standardin kombëtar të kontabilitetit nr. 10, Grantet dhe format e tjera të ndihmës duke bartur deformime në rezultatin financiar të periudhave ushtrimore (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 35-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1-Rekomandimi:- Departamenti ekonomik i shoqërisë në përgatitjen e pasqyrave financiare të shoqërisë, për paraqitjen e granteve si dhe të ardhurave nga to, duhet t'i përmbahet Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 10, ku përcaktohet njohja dhe paraqitja në pasqyrën e pozicionit financiar dhe në pasqyrën e performancës.

Vazhdimisht

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i programit ekonomik-financiar për vitet 2015-2017 është konstatuar se:

-Ka pasur vonesa në hartimin dhe miratimin e programit ekonomik nga Shoqëria Hekurudha Shqiptare dhe Këshilli Mbikëqyrës përkatësisht 3 muaj vonesë për vitet 2015-2016 dhe 1 muaj vonesë për vitin 2017 në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 394, datë 21.8.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror” kreu III pika 2, I cili përcakton: *“Drejtoritë e shoqërive, ku shteti ka mbi 50% të aksioneve, hartojnë projekt programet dhe dërgojnë kopje të tyre, me relacion shpjegues pranë këshillave mbikëqyrës, brenda datës 1 nëntor të çdo viti”*

-Programi ekonomik, nuk është përgatitur bazuar në rezultatet e arritura në vitin paraardhës, në nivelin ekonomik financiar të shoqërisë për të realizuar investimet e parashikuara, si dhe nuk kryhet bashkërendimi i punës së degëve e specialistëve brenda stafit të shoqërisë.

-Programi ekonomik dhe financiar i shoqërisë, nuk ka pasqyruar tregues të mirë harmonizuar midis tyre.

Në disa zëra të llogarive për shpenzimet operative dhe të ardhurat për mallra dhe shërbime konstatohet angazhim më i madh gjatë vitit në krahasim me planifikimin fillestar ndërsa në disa zëra të tjerë konstatohet angazhim më i ulët gjatë vitit në krahasim me planifikimin fillestar si pasojë e tjetërsimit të destinacionit të fondit ekonomik. Në të dyja rastet, situata tregon një planifikim jo të saktë në fillim të vitit dhe shpenzimin më të madh për disa llogari në krahasim me llogari të tjera pavarësisht ruajtjes në total të limitit për angazhim fondi.

-Ndryshimet në programin ekonomik-financiar për vitin 2016 miratuar me shkresën nr. 852 prot. Datë 07.11.2016 nuk është miratuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 318, datë 08.04.2009, Kreu IV, “Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës”, pika 5 ku përcaktohet: *“Këshilli Mbikëqyrës i propozon Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës lidhur me këto çështje: a) Përcaktimin dhe ndryshimin e programit të veprimtarisë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë të shoqërisë”*.

-Në hartimin e programit ekonomik-financiar nga ana e shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” sha Durrës vlera e përllogaritur si shpenzim amortizimi nuk paraqet vlerën reale të amortizimit të aseteve, duke sjellë një shtrembërim të programit ekonomik. Amortizimi është llogaritur dhe pasqyruar gabim si dhe aplikimi i normave të amortizimit nuk është kryer i saktë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Pika 3.7 Amortizimi (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 16-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).



9.1 -Rekomandimi:- Shoqëria dhe Sektori i Financës të marrë masa për rakordimin dhe unifikimin e vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare me vlerat e paraqitura në programin ekonomiko-financiar.

9.2.-Nga ana e shoqërisë të hartohet programimi ekonomiko-financiar duke pasur parasysh nevojat reale gjatë vitit të pritshëm dhe sipas treguesve reale të viteve të mëparshme duke shmangur programimet të cilat rrisin bazën në një përqindje të caktuar. Gjatë vitit të angazhohen vetëm ato shpenzime të cilat janë planifikuar sipas llojit dhe të mos ndryshohet destinacioni i përdorimit të këtyre fondeve brenda zërave të artikujve të programuar.

9.3-Nga Hekurudha Shqiptare të merren masa që strukturat/struktura që do të ndjekin programimin dhe planifikimin ekonomiko-financiar, të eliminojnë planifikimet formale, dhe të kryejnë parashikime të besueshme, duke kryer analiza të hollësishme të të gjithë treguesve të programit referuar udhëzimeve përkatëse për këtë qëllim, me qëllim eliminimin e ndryshimeve të konsiderueshme në program gjatë vitit ushtrimor.

9.4-Nga sektori i financës, të merren masa që të bëhet identifikimi, vlerësimi dhe raportimi i saktë i detyrimeve dhe shpenzimeve të krijuara sipas standardeve kombëtare kontabël dhe në përputhje me politikën kontabël të miratuara nga vetë institucioni.

Vazhdimisht

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të strukturës organizative, marrëdhënieve të punës dhe pagave është konstatuar se:

-Hekurudha Shqiptare Sha ka tejkalim të numrit të punonjësve të miratuar në strukturën e pagave në vitet 2015-2016 pa kryer një studim të detajuar për domosdoshmërinë e rritjes së numrit të punonjësve në shoqëri ose për lëvizje të shumta të punonjësve në pozicione të ndryshme

-Këshilli Mbikëqyrës nuk ka marrë parasysh relacionet e pagave të hartuara nga grupet përkatëse të punës të ngritura nga Administratori, të cilat kanë kryer studimin e lëvizjeve të stafit brenda institucionit

-Gjithashtu janë vënë re diferenca dhe pasaktësi midis fondit të pagave të raportuara në listë pagesa dhe fondit të pagave të raportuara si shpenzime vjetore në realizimin e programit ekonomik në vlerën 6,053,128 lekë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 16-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1-Rekomandimi:- Nga Administratori i Shoqërisë të hartohet dhe nga Këshilli Mbikëqyrës të miratohet rregullorja e përcaktimit të kriterëve të punësimit, sipas pozicionit të vendeve të punës dhe të merren masa për zbatimin korrekt në rekrutimin apo lëvizjen e punonjësve.

Vazhdimisht

11. Gjetje nga auditimi -Hekurudha Shqiptare” Sha Durrës nuk ka zbatuar shkronjën “b” të nenit 1 të ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë” dhe VKM nr. 392, datë 12.08.1999 “Për administrimin e fondit të veçantë monetar, të krijuar sipas ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë” derdhur në Institutin e Integritit të ish-të Përndjekurve Politikë për të arkëtuar për llogari të Institutit të Integritit të ish-të Përndjekurve Politikë shumën 1 % të fondit të pagave për vitin 2015-2017 në shumën totale



10,732,000 lekë (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 16-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1-Rekomandimi -Nga Administratori i Hekurudha Shqiptare të merren masa çdo fillim viti “Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë” dhe të kryhet raportimi i saktë në pasqyrat financiare, në përputhje me standardet dhe politikat kontabël të miratuara nga vetë institucioni.

11.2-Nga Administratori i Hekurudha Shqiptare dhe sektori i financës të merren masa që shuma e identifikuar të mund të paguhet me këste sipas një skeduli të detajuar për llogari të Institutit të Integritit të ish-të Përndjekurve Politikë.

Vazhdimisht

12. Gjetje nga auditimi: Mos likuidimi në afat i detyrimeve për kohë qëndrimin e vagonëve të huaj, i cili është bere një problem shqetësues dhe me pasoja për Hekurudha Shqiptare. Detyrimet që HSH ka ndaj hekurudha të tjera “Për orë qëndrimet e vagonëve në territorin e Hekurudhës Shqiptare”, për periudhën objekt auditimi janë shtuar **me 308,476 euro** duke e rënduar akoma më shumë situatën financiarë të saj, e cila deri më datën 31.12.2017 është në **vlerën 1,667,790 euro**.

Në këtë vlerë nuk janë përfshirë penaltitet për mos likuidim në kohë të detyrimeve që HSH ka ndaj hekurudhave të tjera, për përdorimin e vagonëve, penaltitete të cilat si rrjedhojë e mos llogaritjes nuk janë kontabilizuar, por është kontabilizuar vetëm principli. Principli është kontabilizuar mbi bazën e urdhrave të çdo muaji nga drejtori i njësisë, çka do të thotë që vlera totale ndaj hekurudhave të tjera është më e madhe.

-Nuk kryhet asnjë veprim financiar dhe kontabël në lidhje me detyrimet financiare që rezultojnë nga kamatëvonesat për orë qëndrimet e vagonëve të huaj, ndaj hekurudhave të huaja. Ky mosveprim nga ana e HSH-së, nuk krijon besueshmëri për raportimin saktë dhe të besueshëm të detyrimeve dhe rezultateve financiare, për shkak se kamatëvonesat e dërguara nga hekurudhat e huaja pranohen të mirëqena, pa bërë përllogaritjen e penaltiteteve dhe përfshirjen e tyre në raportimet e pasqyrave financiare (Më hollësisht trajtuar në pikën 11 faqe 101-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1-Rekomandimi:- Nga Administratori i Përgjithshëm dhe Drejtoria Ekonomike, të merren masa për hartimin një plani afatgjatë, lidhur me shlyerjen e detyrimeve ndaj hekurudhave të huaja në vlerën 1,667,790 euro, vënien nën kontroll të shpenzimeve, si dhe uljen e tyre për orë qëndrimet e vagonëve të hekurudhave të huaja.

12.2-Administratori i Përgjithshëm të shqyrtojë dhe të analizojë shkaqet, dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për vonesat në përpunimin e vagonëve të huaj, pasi detyrimi i DPH-së ndaj atyre homologe, për periudhën 2015-2017 është 308,476 euro.

12.3-Nga Administratori i Përgjithshëm, Drejtoria Ekonomike dhe Sektori i Marketingut, të merren masa për të bërë evidentimin dhe regjistrimin e penaltiteteve të shkaktuara nga mos likuidimi i kamatëvonesave për orë qëndrimet e vagonëve të Hekurudhave të Huaja, konform udhëzimeve të kodeve UIC 304 dhe 311, duke bërë në këtë mënyrë raportim të saktë dhe të besueshëm të detyrimeve financiare, si dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare.

Deri me datë 31.08.2018



13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje aksesore dhe pajisje hekurudhore” me fond limit prej 6,666,667 lekë, nga ana e Njesisë së Prokurimit në shtojcën 8 të DST, Pika 2.1 Kapaciteti ligjore i operatorit ekonomik, janë bërë ndryshime të këtij kriteri duke cilësuar “Kontrata të ngjashme në një vlerë jo më të madhe se 40 % të fondit limit” në kundërshtim me nenet 1,2 dhe 3 të Ligjit të prokurimit Publik nr. 9643 datë 20.11.2006 duke ulur besueshmërinë e operatorit ekonomik fitues (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 60-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1-Rekomandimi:- Autoriteti Kontraktor të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim, që të sigurojë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve civile, për të arritur rezultate të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve. Ky rekomandim mbështetet në frymën e ligjit për prokurimin publik si dhe në rregullat e prokurimit publik.

Vazhdimisht

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Sigurimi i shërbimit me SHRSF për stacionin e mallit dhe udhëtarit Vlorë”, shpallja fitues i operatorit ekonomik “Semani” SHPK është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime neni 78 pika 6, e cila përcakton: “...Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa...”

Komisioni i ngritur për shqyrtimin e ankesës ka vepruar dukshëm në kundërshtim me ligjin, pasi jo vetëm që ka dhënë një orientim të gabuar për titullarin e autoritetit kontraktor por edhe ka urdhëruar KVO për rivlerësimin e ofertës së këtij operatori duke vepruar në tejkalim të kompetencave dhe tagrit ligjore të këtij komisioni (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 60-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1-Rekomandimi:-Nga shoqëria t’i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ i operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, me qëllim shmangien e vlerësimeve e shqyrtimeve jo korrekte.

Komisioni i vlerësimit të ofertave të vlerësojë drejtë kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të miratuara në dokumentet e tenderit, duke u mbështetur në dokumente zyrtare të lëshuara nga organet kompetente.

Vazhdimisht

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i mëparshëm janë dhënë 63 (gjashtëdhjetë e tre) rekomandime për masa organizative, shpërblim demi dhe disiplinore. Nga 25 masa organizative të rekomanduara gjithsej, janë zbatuar plotësisht 20 dhe nuk janë zbatuar 5 masa. Nga 10 masa për shpërblim demi të rekomanduara gjithsej janë zbatuar plotësisht 4, janë zbatuar pjesërisht 5 dhe nuk është zbatuar 1 masë. Nga 28 masa disiplinore të rekomanduara gjithsej janë zbatuar plotësisht 23 dhe nuk janë zbatuar 5 masa (*Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqe 91-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).



15.1-Rekomandimi:- Shoqëria marrë masa për zbatimin e të gjitha rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm. Konkretisht janë lënë pa zbatuar 11 masa të ndryshme administrative, organizative e shpërblim dëmi.

Brenda vitit

16. Gjetje nga auditimi: Kontratat e lidhura me subjektet private për vitet 2015-2017, nuk kanë Stemën e Hekurudhës, intestimin “Republika e Shqipërisë”, emërtimin e organit shtetëror dhe strukturës përkatëse, në kundërshtim me “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, kapitulli II-B, “Përpilimi, shtypja, shumëfishimi dhe evidencimi i dokumenteve”, neni 12, dalë në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqe 91-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

16.1-Rekomandimi:- Nga ana e shoqërisë të marren masa për plotësimin e dokumentacioneve kontraktore me normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: -Njësia e Infrastrukturës ka nënshkruar kontrata dhënie me qira me subjekte private për vitet 2015-2017, me sipërfaqe mbi 200 m² për afat kohor 1 vjeçar, duke i përjashtuar nga konkurrimi, në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqe 91-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

17.1-Rekomandimi:- Shoqëria duhet të marrë masa që çdo kontratë qiraje e lidhur ndërmjet saj dhe kompanive private mos i kalojë 200 m² (Në këtë sipërfaqe të përfshihet dhe sipërfaqja e përbashkët referuar genplanit të objektit).

Menjëherë

18. Rekomandim: Shoqëria Hekurudha Shqiptare SHA të njoftojë Kontrollin e Lartë të Shtetit për të gjitha rastet që zbatimi i rekomandimeve të dhëna kalon në procese gjyqësore, në cilësinë e palës së tretë që ka dijeni për çështjen.

Vazhdimisht

B.1 MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar Në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, shkronja “b”, shoqëria “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës, të kontabilizojë dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim për shpërblimin e dëmit me vlerën **30,305,800 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Me urdhrin nr. 46/30, datë 05.05.2015, ish-administratori i shoqërisë z. G.A, ka urdhëruar kalimin e fondit prej 5,000,000 lekë për likuidimet ndaj shoqërisë “Th.”



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

SHRSF, për faturën nr. 36, datë 28.12.2012 me vlerë 806,900 lekë, faturën nr. 45, datë 31.01.2013 me vlerë 806,880 lekë, faturën nr. 14, datë 28.02.2013 me vlerë 806,880 lekë, faturën nr. 19, datë 31.03.2013 me vlerë 806,880 lekë, faturën nr. 26, datë 30.04.2013 me vlerë 806,880 lekë, faturën nr. 32, datë 31.05.2013 me vlerë 806,800 lekë. Në 6 faturat e mësipërme, dy nga të cilat ishin kopje, mungonte firma e blerësit, nuk është përcaktuar vendi i kryerjes së shërbimit, si dhe nuk janë shoqëruar me proces-verbalet e kryerjes së shërbimit.

Ish-administratori i shoqërisë z. I.D, me urdhrin nr. 36/20, datë 22.09.2017, ka urdhëruar kalimin e fondit prej 3,873,570 lekë për likuidimet ndaj shoqërisë “H., (Th.)” SHRSF, për faturën nr. 34 datë 29.09.2015 me vlerë 557,484 lekë, faturën nr. 32, datë 31.08.2015 me vlerë 557,484, faturën nr. 31, datë 31.07.2015 me vlerë 557,484 lekë, faturën nr. 30, datë 30.06.2015 me vlerë 557,484 lekë, faturën nr. 29, datë 29.05.2015 me vlerë 557,484 lekë, faturën nr. 28, datë 30.04.2015 me vlerë 557,484 lekë dhe faturën nr. 26, datë 31.03.2015 me vlerë 557,484 lekë.

Likuidimi është kryer në kushtet kur faturat tatimore nuk janë firmosur nga asnjë përfaqësues i HSH, si dhe nuk ka proces verbal nga përgjegjësit e stacioneve për kryerjen e shërbimit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 36. **Vlera 8,743,608 lekë përbën dëm ekonomik për shoqërinë** (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 27-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1-Rekomandimi:- Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **8,743,608 lekë**, nga “Th. (H. A.) SHRSF, për mungesën e dokumentacionit të nevojshëm për justifikimin e kryerjes së shërbimit.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në pagesat e kryera nga shoqëria gjatë viteve 2015, 2016, 2017 u konstatuan likuidime kryer për faturat e shërbimit të ruajtjes së stacionit hekurudhor Përrenjas nga shoqëria “M.” SHRSF. Në zërin shërbime ruajtje objektësh në vitin 2015 janë kontabilizuar faturat nr. 11,18,23,24,25 me vlerë totale 5,349,564 lekë, të cilat i përkasin shërbimeve të kryera në vitet 2013 e 2014. Në faturat e mësipërme nuk është përshkruar data në të cilën furnizimi i shërbimit është kryer dhe se ku është kryer. Në lidhje me kontratat e lidhura me shoqërinë për kryerjen e shërbimit u konstatua se është proceduar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi nga viti 2008 janë lidhur kontrata shtesë furnizimi për shërbimin e “Ruajtjes me SHRSF të stacionit hekurudhor, Përrenjas”. Këto veprime janë bërë në kundërshtim me ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” Nr. 9920, datë 19.5.2008 neni 51, dhe me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 36. **Vlera 5,349,564 lekë përbën dëm ekonomik për shoqërinë Hekurudha Shqiptare SHA** (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 27-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.2-Rekomandimi:-Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **5,349,564 lekë**, nga Shoqëria “M. SHRSF”, për mungesën e dokumentacionit të nevojshëm për justifikimin e kryerjes së shërbimit.

Menjëherë



3. Gjetje nga auditimi: Kontrata e furnizimit “Blerje traversa druri, për vitin 2016”, është nënshkruar me datë 12.07.2016, me Kontraktorin “Sh. Al” Sh.p.k, me vlerë 44,470,200 lekë. Afati i realizimit të furnizimit është përcaktuar 120 ditë dhe furnizimi duhet të përfundonte me datë 12.11.2016.

Kontratës i është bërë amendamenti nr. 1 me (pa numër), datë 07.10.2016, sipas të cilit është shtyrë afati i furnizimit deri më datë 23.11.2016. Ky amendament është bërë me arsyetimin se për shkak të remontit të fabrikës së prodhuesit nuk mund të bëhet furnizimi në kohë.

Kontraktori nuk ka paraqitur asnjë dokument në mbështetje të pretendimeve të tij.

Kontratës i është bërë amendamenti nr. 2, me nr. 954/3, datë 07.11.2016. Ky amendament është bërë me arsyetimin se në vendin e prodhuesit ka patur përmbytje dhe për këtë arsye furnizimi nuk mund të kryhet në afat. Sipas kësaj shtese afati i furnizimit është shtyrë deri me datë 20.12.2016. Sa më sipër sqarojmë se remonti i fabrikës së prodhuesit nuk përbën ngjarje të paparashikueshme dhe nuk ka lidhje me autoritetin kontraktor, por me marrëdhëniet kontraktore mes furnizuesit dhe prodhuesit. Po ashtu, argumenti i përmbytjeve në Rumani nuk arsyeton vonesa në furnizim pasi kontraktori ka kryer furnizime të rregullta dhe konkretisht datë 03.10.2016, datat 02, 07, 08 dhe 21.11.2016.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 6, 12 dhe 15 të kontratës. Pra, shtesat e kontratës mbështetur në argumente jo reale konsiderohen të pa vlefshme.

Duke marrë në konsideratë faktin se furnizimi është kryer me 38 ditë vonesë, si dhe vlerën e pa realizuar të furnizimit deri më datë 12.11.2016 është në vlerën 27,696,540 lekë, bazuar në nenin 5, pika 1, të kontratës, Kontraktori “Sh. Al” Sh.p.k duhet të penalizohej për vonesa të furnizimit me vlerë **4,209,874 lekë** [27,696,540 lekë (vlera e pa realizuar) x 4/1000 për ditë vonesë x 38 ditë] (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 60-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Rekomandimi:- Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 4,209,874 lekë**, nga Kontraktori “Sh. AL” Sh.p.k, vlerë e cila përfaqëson penaltitë të pambajtur për mos realizimin sipas afateve kontraktore të furnizimit sipas kontratës “Blerje traversa druri, për vitin 2016”.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Komisioni i përlllogaritjes së fondit limit për kontratën “Blerje traversa druri hekurudhore normale dhe speciale” për vitin 2016”, përbëhet nga znj. M.K, z. M.B dhe z. Xh.B.

Në dokumentin e mbajtur nga komisioni për llogaritjen e fondit limit përcaktohet:

-“Çmime të publikuara nga entet shtetërore për “Blerje traversa druri hekurudhore normale dhe speciale të reja, **nuk ka**”.

-“Autoriteti kontraktor për vetë specifikën e këtij tenderi “Blerje traversa druri hekurudhore normale dhe speciale të reja) **për përcaktimin e fondit limit i është referuar eksperiencës së një viti më parë të realizuar me sukses nga vetë autoriteti kontraktor**”. Theksojmë se nga i njëjti komision si në procedurën e realizuar në vitin 2015, janë përdorur dy standarde. Në vitin 2015 i referohet studimit të tregut duke rritur fondin limit, në vitin 2016 i referohet kontratave të ngjashme, por duke marrë si referencë kontratën me çmime më të larta.

Për përcaktimin e fondit limit është aplikuar çmimi për traversa normale 66,100 lekë/m³ dhe për traversa speciale 66,400 lekë/m³.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

Autoriteti kontraktor duhet t'i referohej kontratave të mëparshme dhe jo vetëm kontratës së një viti më parë e cila rezultoi me çmim më të lartë se kontrata e realizuar në vitin 2014, apo 2013. Theksojmë se për traversat normale janë blerë në vitin 2013 me çmim 60,000 lekë/m³ dhe në vitin 2014 me çmim 56,900 lekë. Në këtë rast komisioni përkatës duhet t'i referohej çmimit më ekonomik të kontratave të realizuara. Është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2. b, ku përcaktohet se qëllimi i ligjit është sigurimi i mirë përdorimit të fondeve publike dhe ulja e shpenzimeve procedurale. **Sqarojmë se, sipas përcaktimit të fondit limit për këtë procedurë (referenca tek kontrata të mëparshme të realizuara me sukses nga autoriteti kontraktor), duhet të veprimej edhe në procedurën e blerjes së traversave për vitin 2015.**

Fondi limit është përcaktuar me vlerë 37,584,740.

Bazuar në kontratën e realizuar në vitin 2014, fondi limit duhet të ishte me vlerë 32,931,460 lekë, si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë faktin se kontrata është nënshkruar me vlerë 37,058,500 lekë (pa TVSH), diferenca me vlerë 4,127,040 lekë (37,058,500 lekë - 32,931,460 lekë) përbën dëm ekonomik. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2. B (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 60-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

-Rekomandimi:- Të kërkohej në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, ***arkëtimi i vlerës 4,127,040 lekë, nga Komisioni i Përlllogaritjes së Fondit Limit i përbërë nga znj. M.K, z. M.B dhe z. Xh.B, shkaktuar nga përlllogaritja e gabuar e fondit limit për procedurën e prokurimit “Blerje traversa druri hekurudhore normale dhe speciale, për vitin 2016”.***

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Urdhri i brendshëm për ngritjen e komisionit të përlllogaritjes së fondit limit të kontratës “Blerje traversa druri hekurudhore normale dhe speciale për vitin 2015” me nr. 185/1, datë 29.01.2015, është nënshkruar nga z. E.D (Drejtues i NjMIH). Komisioni përkatës përbëhet nga znj. M.K, z. M.B dhe z. Xh.B.

Përlllogaritja e fondit limit është bërë duke i'u referuar studimit të tregut, pa marrë në konsideratë faktin se para tre muajsh është përfunduar një kontratë e ngjashme (blerje traversa hekurudhore normale), nga kjo shoqëri. Është marrë ofertë nga 3 Operatorë ekonomikë (OE), ndër të cilët edhe OE “Z.” Sh.p.k, i cili ka paraqitur çmimin 72,500 lekë/m³ për traversa druri normale dhe 85,000 lekë/m³ për traversa speciale. Theksojmë se, bazuar në sistemin elektronik dhe dokumentacionin në dispozicion, ky OE me datën 23.07.2014, ka nënshkruar kontratë me “Hekurudhën Shqiptare” SHA për furnizim me traversa normale me çmim 56,900 lekë/m³, për realizim kontrate me afat 3 muajor, pra për përfundim të furnizimit me datë 23.10.2014.

Sipas procedurës së mësipërme, fondi limit është përcaktuar me vlerë 25,000,000 lekë për blerje të 416.7 m³ traversa normale, pra me çmim 60,000 lekë për m³.

Fondi limit për procedurën blerje traversa për vitin 2015 është llogaritur me vlerë 35,000,000 lekë (pa TVSH). Nga ana e komisionit të përlllogaritjes së fondit limit është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59, pika 2.

Fondi limit duhet të përcaktohej me vlerë 28,326,700 lekë.



Duke marrë në konsideratë faktin se kontrata është nënshkruar me vlerë 31,938,300 lekë (pa TVSH), diferenca me vlerë 3,611,600 lekë (31,938,300 lekë - 28,326,700 lekë) përbën dëm ekonomik (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 60-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Rekomandimi:- Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 3,611,600 lekë**, nga Komisioni i Përlllogaritjes së Fondit Limit i përbërë nga znj. M.K, z. M.B dhe z. Xh.B, shkaktuar nga përlllogaritja e gabuar e fondit limit për procedurën e prokurimit “Blerje traversa druri hekurudhore normale dhe speciale”.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në nenin 4 të kontratës “Rikonstruksion i linjës hekurudhore Librazhd-Përrenjas (Lot I, Perigoni Librazhd-Xhyrë, km 99+400 deri km 111+800)”, është përcaktuar se punimet duhet të përfundojnë me datë 31.12.2016, në fund të vitit buxhetor. Me datë 05.01.2017, 5 ditë pas përfundimit të afatit të kontratës, kontratës bazë i është bërë shtesë që ka të bëjë me shtyrjen e afatit të punimeve deri me datë 24.01.2017, me argumentimin se kanë lindur vështirësi si pasojë e mos kalimit të trenit me të cilin është parashikuar transporti i materialeve. Nga verifikimi i dokumentacionit, rezulton se zhavorri është transportuar me tren, duke vërtetuar faktin se argumentimi i shtesës së afatit nuk qëndron, pra kemi të bëjmë me shtyrje të afatit të kontratës për argumente të cilat nuk kanë rezultuar në të vërtetë, duke e bërë këtë shtesë të pavlefshme.

Duke qenë se deri në afatin e përfundimit të punimeve rezultojnë të pa situacionuara punime me vlerë 6,909,391 lekë dhe se punimet janë realizuar me 24 ditë me vonesë, për përfundim të punimeve jashtë afateve kontraktore, bazuar në nenin 7 të kontratës, kontraktori duhet të penalizohet me **vlerë 663,298 lekë** (6,909,391 lekë x 4/1000 x 24 ditë).

Me datë 06.02.2018 dhe datë 21.03.2018, u verifikuan disa zëra punimesh në objekt, për distancën nga kilometër 101+800 deri në kilometër 107, nga ku rezultoi se:

-Pllakat shtruese kineze, nuk janë vendosur të reja por të përdorura, e vërtetuar nga amortizimi i lartë i tyre si dhe deformime. Po ashtu edhe gozhdët hekurudhore janë të amortizuara me ndryshk të theksuar, ndryshk i cili nuk mund të krijohet për një periudhë rreth 1 vit, referuar përfundimit të kontratës. Është likuiduar vlera 110,000 lekë për pllaka shtruese dhe vlera 260,000 lekë për gozhdë hekurudhore.

Vlera e 432,000 lekë [(100,000 lekë + 260,000 lekë) + TVSH], është përfituar padrejtësisht nga kontraktori “B.” Sh.p.k dhe përbën dëm ekonomik.

- Bazuar në librezën e masave, janë gërmuar dhera me ekskavator në sasinë 2560 m³ dhe gërmim me krah për pastrim në sasinë 760 m³ (në total 3320 m³). Bazuar në situacionin përfundimtar dhe të fondit rezervë është përshkruar gërmim me ekskavator në sasinë 2500 m³ dhe gërmim me krah në sasinë 720 m³ (gërmim në total 3220 m³). Sipas zërit “Transport dheu me auto deri 6 km”, është certifikuar sasia 3590 m³. Në këto kushte është likuiduar më shumë transport me auto në sasinë 270 m³. **Vlera 123,120 lekë** (270 m³ x 380 lekë/m³ +TVSH), është përfituar padrejtësisht nga kontraktori “B.” Sh.p.k dhe përbën dëm ekonomik.

- Nga verifikimi i shtresës së zhavorrit për distancën (km 101+800 deri 102+200) rezulton se është shtruar distanca 100 ml, ndërkohë që në librezën e masave është përshkruar gjatësia 400 ml. Nga përlllogaritjet rezulton se sasia e përshkruar më tepër është në masën 120 m³ (300 ml x 0.4 m²). Nga përlllogaritjet rezulton se është përfshirë më tepër sasia 80 m³ (400 ml x 0.2 m²).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë "Hekurudha Shqiptare" SHA Durrës

Vlera 192,000 lekë [(120 m³+ 80 m³) x 800 lekë/m³ +TVSH], është përfituar padrejtësisht nga kontraktori "B." Sh.p.k dhe përbën dëm ekonomik.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar neni 7 (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 60-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Rekomandimi:- Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 1,410,418 lekë**, nga Kontraktori "B." Sh.p.k, vlerë e cila përfaqëson shumën 747,120 lekë punime të likuiduara por të pa realizuara dhe shumën 663,298 lekë penalitet të pambajtur për përfundim të punimeve përtej afatit kontraktor.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Gjatë zbatimit të procedurës "Riaftësim linje km 64.5 deri 66.5, Lezhë, për vitin 2015", nga ana e KVO janë skualifikuar 4 OE, nga të cilët edhe OE "Sh. M" sh.p.k me vlerë oferte 6,223,746 lekë. Skualifikimi është bërë me argumentimin se këtij OE i mungon diploma e inxhinierit topograf, i mungojnë mandat pagesat për taksat vjetore të 6 mekanizmave dhe automjeteve. Në ankesën që OE "Sh. M" Sh.p.k ka paraqitur sqaron se për marrjen e licencës së drejtuesit teknik pranë autoritetit përkatës dorëzohet kopja e diplomës që vërteton profesionin e drejtuesit teknik, kështu është vepruar edhe me drejtuesin teknik z. Sh.D dhe mbi këtë bazë ka dalë licenca personale dhe është bërë kategorizimi në licencën e shoqërisë.

Nga verifikimi në sistemin elektronik rezulton se, z. Sh.D zotëron licencë profesionale me nr. TZ 0658, lëshuar me datë 29.05.2007 me pikat: Rilevime topografike, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike dhe punime speciale gjeodezike, rrjeta mbështetëse, qëndrueshmëri terrenesh. Po ashtu në këtë licencë është përcaktuar se është diplomuar në vitin 1967 në degën inxhinieri maksheider.

Në lidhje me mandatpagesat nga ana e OE është sqaruar se në sistemin elektronik janë paraqitur certifikatat e kontrollit teknik, të cilat nuk mund të lëshohen pa likuiduar më parë detyrimet për taksat vjetore. Po ashtu polica e sigurimit e paraqitur në sistemin elektronik nuk mund të lëshohet pa bërë pagesën përkatëse. Skualifikimi i OE si më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, neni 53 pika 4.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE shpallur fitues "B." Sh.p.k rezulton se ka mangësi në lidhje me dokumentacionin e paraqitur që ka të bëjë me:

Siguracioni për kamionin me targë AA 275 BR, ka skaduar me datë 26.05.2015.

Siguracioni për kamionin me targë AA 427 CF, ka skaduar me datë 07.05.2015.

Automjetit me targë AA 143 GV, i ka përfunduar kontrolli teknik me datë 27.05.2015.

- Ky OE ka paraqitur evidenca që provon se ka të punësuar 9 punonjës krahu, ndërkohë që në dokumentet e tenderit kërkohen 12.

Pavarësisht mangësive të mësipërme, ky OE është kualifikuar dhe është shpallur fitues.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, neni 46 pika 1.b.

Si pasojë e veprimeve të mësipërme, për arsye të skualifikimit të OE me ofertë më të vogël, për devijime të cilat nuk ndryshojnë në thelb ofertën, si dhe për shkak të kualifikimit të një OE i cili ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur, **është shkaktuar dëm ekonomik me vlerë 1,340,536**



lekë [7,564,282 lekë (oferta fituese) – 6,223,746 lekë (oferta e OE Sh. M)] ((Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 60-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Rekomandimi:- Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 1,340,536 lekë**, nga KVO e përbërë z. S.Sh, znj. P.N dhe znj. N.P, shkaktuar nga skualifikimi i padrejtë i një OE dhe skualifikimi i një OE më ofertë më të ulët, gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit "Riaftësim linje km 64.5 deri 66.5, Lezhë, për vitin 2015".

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Kontrata e punimeve civile "Riaftësim traseje hekurudhore Lezhë, 2016", është nënshkruar me datë 11.11.2016, ndërmjet Hekurudhës Shqiptare dhe Kontraktorit "Gj." Sh.p.k, me vlerë 3,009,372 lekë.

Me datë 07.03.2018, u bë verifikimi i disa zërave të punimeve të realizuara në objekt, kryesisht sa i takon shtresës së ballastit të vendosur në hekurudhë. U bënë sondazhe në segmentin 59+400 deri 59+700 dhe 62+500 deri 63+200. Nga gërmimet e kësaj shtrese në disa vende, mjaftueshëm për të arritur një konkluzion të saktë, rezultoi se shtresa e ballastit është ndërtuar në bazamentin e shtrirjes së traversave deri në lartësinë 16 cm, ndërkohë që kjo trashësi duhet të ishte 35 cm. Bazuar në librezën e masave sasia e ballastit të hedhur është në masën 1140 m³. Duke marrë në konsideratë gjerësinë e trupit të hekurudhës në nivelin e sipërm të traversave 3.4 m dhe gjerësinë në planin e vendosjes së traversave 3.8 m, nga përllogaritjet rezulton se është situacionuar më shumë sasia 684 m³ [(3.4 +3.8)/2 x 0.19 m x 1000 ml].

Sa me sipër, **vlera 779,760 lekë** (684 m³ x 950 lekë/m³ + TVSH), është përfituar padrejtësisht nga kontraktori "GJ." Sh.p.k dhe përbën dëm ekonomik.

Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar neni 7 (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 60-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Rekomandimi:- Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 779,760 lekë**, nga Kontraktori "Gj." Sh.p.k, vlerë e cila përfaqëson punime të likuiduara por të pa realizuara për kontratën "Riaftësim traseje hekurudhore Lezhë, 2016".

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit "Riaftësimi i trasesë hekurudhore Milot-Lezhë" në dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik "B." shpk për blerjen e traversave, dokumentacioni i cili është noterizuar me nr. 1512/1 kol., datë 22.11.2014. Dokumenti doganor i përket datës 14.11.2014. Traversat janë blerë nga subjekti "M. BB Z. 2." C. G. Në këtë dokument doganor përcaktohet se kanë hyrë në doganë lëndë drusore, **traversa hekurudhore të përdorura**, të pa paketuara (rifuxho). Edhe në Urdhrin e çlirimit faturë nr. 2014, M, 320, është përcaktuar traversa hekurudhore të përdorura. Pranimit dhe vendosja e traversave të përdorura është në kundërshtim me specifikimet teknike të kontratës dhe preventivin e punimeve. Bazuar në situacionin përfundimtar, për zërin "F.V traversa druri të reja normale", është likuiduar sasia 136 copë, me çmim 4,500 lekë/copë, me vlerë 612,000 lekë. **Sa më sipër, nga ana e Kontraktorit "B." Sh.p.k, është përfituar padrejtësisht vlera 733,400 lekë**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

(612,000 lekë + TVSH), vlerë e cila përbën dëm ekonomik (Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 60-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Rekomandimi:- Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyimit, **arkëtimi i vlerës 733,400 lekë**, nga Kontraktori “B.” Sh.p.k, vlerë e cila përfaqëson materiale jo në përputhje me standardet e kërkuara sipas kontratës “Riaftësimi i trasesë hekurudhore Milot-Lezhë”.

Menjëherë

B. 2 MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

Është konstatuar përdorim i fondeve jashtë destinacioni dhe efekt negativ financiar me vlerë 1,463,789,349 lekë, detajuar si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” SHA, nuk janë zbatuar plotësisht procedurat ligjore për përdorimin e subvencionit të akorduar për transportin e udhëtarëve për periudhën objekt auditimi, duke ndryshuar destinacionin e këtij subvencioni në vlerën **1,230,000,000 lekë** e cila përbën shkelje të disiplinës buxhetore dhe shpenzime jo në përputhje me ligjin po në të njëjtën vlerë. Konkretisht i gjithë subvencioni është përdorur për mbulimin e fondit të pagave dhe sigurimet shoqërore për shoqërinë Hekurudha Shqiptare SHA (Drejtorinë e Përgjithshme të Hekurudhës, Njësia e Biznesit të Mallit, Njësia e Menaxhimit të Infrastrukturës, Njësia e Biznesit të Mjeteve Lëvizëse), duke ndryshuar në këtë mënyrë destinacionin e këtij shpenzimi të dhënë nga buxheti i shtetit, në kundërshtim me Ligjin nr. 9374, datë 21.02.2005 “Për ndihmën shtetërore”, Ligjin nr. 185/2013, datë 02.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, Ligjin nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005 “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, Vendimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 8, datë 02.02.2007 i ndryshuar me Vendimin nr. 15, datë 15.03.2007 (Më hollësisht trajtuar në pikën 11 faqe 101-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Rekomandimi:- Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës të shqyrtojë përdorimin e subvencionit për vitet 2015-2017 në vlerën **1,230,000,000 lekë**, i përdorur jashtë destinacionit të përcaktuar duke evidentuar përgjegjësitë dhe duke marrë vendimet përkatëse.

-Ndihma shtetërore për kompensimin e kostove të ofrimit të shërbimeve publike, në veçanti për mbulimin e shpenzimeve operative të shërbimit të transportit të udhëtarëve, të alokohet në funksion të realizimit të treguesve të programuar, mbështetur në kriteret e vendosura nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore.

Deri me datë 31.07.2018

2. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me kredinë italiane shoqëria dispononte planin e amortizimit të kredisë si dhe ka marrë njoftime periodike nga BKT që funksionon si bankë ndërmjetëse në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

lidhje me detyrimet, por megjithëse nuk ka paguar këstet e principalit dhe interesat duhet të krijonte një llogari provizioni për këto këste dhe interesa të cilat janë paguar nga llogaria e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Vlera e cila llogaritet deri në fund të periudhës ushtrimore 2017 është 1,746,915 Euro ose në vlerën 232,252,349 lekë.

Situata e vështirë ekonomike e shoqërisë është thelluar akoma më shumë në vitet e fundit duke e bërë të pamundur kthimin e detyrimit duke lënë këtë barrë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Këto veprime janë bërë në kundërshtim me standardin kombëtar të kontabilitetit nr. 3, të përmirësuar, Instrumentet financiare, pika 14, duke sjellë rritje të riskut për mosparaqitjen e saktë të pasqyrave financiare dhe **vlera 1,746,915 Euro e paguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë është efekt negativ për Buxhetin e Shtetit** (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 35-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Rekomandimi:- Shoqëria duhet të marrë masa për llogaritjen e interesave dhe principaleve për detyrimet afatgjata dhe t'i paraqesë në llogaritë përkatëse në pasqyrat financiare si dhe të marrë masat për pagesën e tyre.

Vazhdimisht

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi në zbatimin e strukturës organizative, në marrëdhëniet e punës dhe në dhënien e pagave dhe shpërblimeve është konstatuar se punonjësit e larguar nga puna kanë hapur procese gjyqësore ligjore për të cilat janë marrë 18 vendime të formës së prerë në vitet 2015-2017 me vlerë të **efektit negativ financiar në shumën 11,481,144 lekë**, nga të cilët 12 nga këto vendime janë në proces. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 20-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Rekomandimi:- Shoqëria duhet të marrë masa për shqyrtimin e efektit financiar në vlerën totale **11,481,144 lekë**, të ardhur si pasojë e mos-ndjekjes së procedurave ligjore në largimin e punonjësve nga puna, për evidentimin e përgjegjësive, si dhe nga Sektori Juridik të merren masa për ndjekjen e të gjitha çështjeve gjyqësore, në të gjitha shkallët e gjykimit për shmangien e kostove shtese nga proceset gjyqësore në proces të cilat mbartin risk të lartë për efekt negative financiar në të ardhmen.

-Shoqëria duhet të marrë masa të analizojë në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara përmbarimore, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

Deri me datë 31.07.2018

4. Gjetje nga auditimi: Shoqëria ka urdhër për vënien e sekuestros konservative për vlerën 2,086,183 lekë, për llogari të kreditorit z. B.H, Librazhd. Detyrimi ka ardhur nga kontrata e lidhur mes palëve më datë 05.01.2011 për dhënien me qira të një sipërfaqe tokë prej 200 m², në Librazhd, Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudhave për montimin e pajisjeve të radiondërlidhjes që i shërbejnë hekurudhës shqiptare të përfituara si grant nga kompania GE H.H. Për 3 muajt e parë qiraja prej 40,000 lekë është paguar nga HSH dhe më pas nuk është paguar më. Pas kërkesave të shumta nga z. B.H, çështja është gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila ka vendosur më 02.06.2016 pagesën e prapambetur deri me 01.02.2016 si dhe shumën prej 25,000 lekë në muaj deri në lirimin e tokës nga HSH. Efekti negativ financiar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

i shkaktuar shoqërisë nga veprimet ose mosveprimet e administratorëve të shoqërisë deri më 31.12.2017, është në vlerën 450,000 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10,296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 5. ***Vlera 450,000 lekë përbën efekt negativ financiar për shoqërinë*** (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 27-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Rekomandimi:- Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë të shqyrtojë vlerën 450,000 lekë nga mosveprimet e drejtimit të shoqërisë dhe të nxjerrë përgjegjësitë lidhur me këtë vlerë.

Deri me datë 31.08.2018



IV. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Ne kemi përfunduar auditimin e veprimtarisë ekonomiko financiare të Hekurudha Shqiptare Sha në tërësi për periudhën 2015-2017, si dhe të pasqyrave financiare të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar të institucionit, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të parasë, burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet, pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet në aktivet e qëndrueshme si dhe amortizimin e tyre, pasqyra e lëvizjes së fondeve dhe shënimet shpjeguese.

Opinioni i pakualifikuar i Grupit të Auditimit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Hekurudha Shqiptare Sha me kuadrin ligjor dhe rregullator.

Në opinionin tonë, përveç çështjeve të trajtuara në bazën për opinionin e pakualifikuar, pasqyrat financiare të audituara paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për periudhën e audituar në përputhje me standardet kombëtare të kontabilitetit të përmiruara në Shqipëri (SKK).

Baza për opinionin e pakualifikuar.

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik **ISSAI 4100 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta dhe ISSAI 4200 - Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet lidhur me auditimin e pasqyrave financiare.**

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Theksim të çështjes

Ne duam të tërheqim vëmendjen e përdoruesve për disa çështje të cilat ndikojnë në cilësinë e informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare duke përfshirë dobësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe anomalitë e identifikuara në raportimin e pasqyrave financiare. Konkretisht:

- Dëmet ekonomike të konstatuara janë në vlerën 30,435,762 lekë të cilat kanë ardhur si pasojë e keqmenaxhimit në procedurat e prokurimit si dhe në likuidimin e shërbimit të rojeve private
- Efekte negative financiare në vlerën 11,931,144 lekë të cilat kanë ardhur si pasojë largimeve të padrejta nga puna dhe mos lirim në kohë i hapësirës private për vendosjen e instrumentave menaxhues dhe funksionues të sistemit hekurudhor
- Vlera e subvencionuar prej 1,230,000,000 lekë e destinuar për rimbursimin e shpenzimeve të biletave të udhëtarëve është përdorur për dhënien e pagave dhe sigurimeve shoqërore përbën



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti përfundimtar për auditimin e ushtruar në shoqërinë “Hekurudha Shqiptare” SHA Durrës

shkelje të disiplinës buxhetore dhe shpenzime jo në përputhje me ligjin po në të njëjtën vlerë. -Sistemet e kontrollit të brendshëm të implementuara nga institucioni nuk kanë rezultuar në përputhje me kërkesat e kriterëve të përcaktuara për vlerësimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për shkak të mungesës së kuptimit të këtyre kriterëve, mosplotësimit të kërkesave për dorëzimin e deklaratave për cilësinë e kontrolleve të brendshme, mosplotësimit dhe mosdorëzimit pyetësorëve të vetëvlerësimit, regjistrin të risqeve, rregullores pa mbështetje në strukturën organizative, veprimeve rregulluese të kryera nga jashtë, mbajtjes së regjistrimit manual të transaksioneve në ditarë, raporteve të pa plota të audituesit të brendshëm, procedurave të pa implementuara për delegimin e detyrave dhe përgjegjësisve dhe mungesës së objektivave e planeve të punës për arritjen e tyre.

V. ANEKSE

1. Shkurtime

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
KMb	Këshilli Mbikëqyrës
SHA	Shoqëri aksionare
HSH	Hekurudha Shqiptare
Sh.p.k	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
AQT	Aktivitet e Qëndrueshme të Trupëzuara
DEK	Departamenti Ekonomik
QKR	Qendra Kombëtare e Regjistrimit
TAP	Tatimi i të ardhurave nga punësimi
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
NJP	Njësia e Prokurimit
AK	Autoriteti Kontraktor
DT	Dokumentet e Tenderit

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT